



www.qbz.gov.al

FLETORJA ZYRTARE E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË



Viti: 2018 – Numri: 55

Botim i Qendrës së Botimeve Zyrtare

Tiranë – E enjte, 19 prill 2018

PËRMBAJTJA

	Faqe
Dekret i Presidentit nr. 10753, datë 3.4.2018	Për lejin e lënies së shtetësisë shqiptare..... 3235
Dekret i Presidentit nr. 10754, datë 3.4.2018	Për lejin e lënies së shtetësisë shqiptare..... 3235
Dekret i Presidentit nr. 10756, datë 3.4.2018	Për lejin e lënies së shtetësisë shqiptare..... 3236
Dekret i Presidentit nr. 10758, datë 10.4.2018	Për dhënie të shtetësisë shqiptare..... 3236
Udhëzim i përbashkët i ministrit të Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural dhe i ministrit të Financave dhe Ekonomisë nr. 2, datë 23.3.2018	Për disa shtesa dhe ndryshime në udhëzimin nr. 1, datë 19.2.2018, “Për kriteret, procedurat dhe mënyrën e administrimit të fondit të programit për bujqësinë dhe zhvillimin rural”..... 3236
Urdhër i ministrit të Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural nr. 125, datë 23.3.2018	Për një shtesë në aneksin II, “Mish i freskët”, pjesa 1, të urdhrat të ministrit nr. 328, datë 22.11.2011, “Për miratimin e rregullores “Mbi përcaktimin e kriterëve dhe kërkesave për certifikimin veterinar të disa lloje kafshësh dhe mishit të freskët të tyre, të cilat hyjnë në Republikën e Shqipërisë nga shtete të caktuara, si dhe nga territore të tjera në administrim të këtyre shteteve””, të ndryshuar.... 3237
Vendim i Komitetit për Zhvillimin e Rajoneve nr. 1, datë 10.4.2018	Për miratimin e programit operacional “Zhvillimi rajonal 2018– 2019”, të granteve të Fondit për Zhvillimin e Rajoneve..... 3238

Vendim i Komitetit për Zhvillimin e Rajoneve nr. 3, datë 10.4.2018	Për disa ndryshime në vendimin nr. 8, datë 13.2.2017, të Komitetit për Zhvillimin e Rajoneve, “Për shpërndarjen e financimit për projekte, thirrja e katërt për vitin 2016, të grantit “Infrastruktura vendore dhe rajonale”, Programi i Zhvillimit të Infrastrukturës Vendore dhe Rajonale, shtylla I”.....	3242
Vendim i Komitetit për Zhvillimin e Rajoneve nr. 4, datë 10.4.2018	Për disa ndryshime në vendimin nr. 12, datë 21.3.2017, të Komitetit për Zhvillimin e Rajoneve, “Për shpërndarjen e financimit për projekte të grantit “Infrastruktura vendore dhe rajonale”, Programi i Zhvillimit të Infrastrukturës Vendore dhe Rajonale, shtylla I”.....	3243
Vendim i Komitetit për Zhvillimin e Rajoneve nr. 5, datë 10.4.2018	Për disa ndryshime në vendimin nr. 16, datë 12.4.2017, të Komitetit për Zhvillimin e Rajoneve që ndryshon vendimin nr. 37, datë 13.7.2016, të Komitetit për Zhvillimin e Rajoneve, “Për shpërndarjen e financimit për projekte të grantit “Arsimi”, thirrja e dytë, Programi i Zhvillimit të Infrastrukturës Vendore dhe Rajonale, shtylla I, për vitin 2016”.....	3244
Vendim i Komitetit për Zhvillimin e Rajoneve nr. 6, datë 10.4.2018	Për shpalljen e thirrjes së parë, për financimin e projekteve nga grantet “Arsimi”, pjesë e Fondit për Zhvillimin e Rajoneve, për vitin 2018.....	3245
Vendim i Bankës së Shqipërisë nr. 31, datë 4.4.2018	Për miratimin e rregullores “Për planet e ndërhyrjes së jashtëzakonshme”.....	3249
Vendim i Entit Rregullator të Energjisë nr. 15, datë 10.1.2018	Mbi miratimin e kushteve të përgjithshme të Kontratës së Shërbimit Universal të Furnizimit me Energji Elektrike për Klientët Fundorë.....	3259
Vendim i Komisionit të Ndhmës Shtetërore nr. 79, datë 3.4.2018	Autorizim i ndihmës shtetërore për projektin “Linja e transmetimit 400 kV Shqipëri–Maqedoni (Fier–Elbasan–Qafëthanë)”, i miratuar me ligjin nr. 101, datë 9.11.2017.....	3268
Vendim i Komisionit të Deklasifikimit dhe të Zhvlerësimit të Drejtorisë së Përgjithshme të Arkivave nr. 4, datë 23.3.2018	Për deklasifikimin plotësisht të informacioneve (dosjeve) të klasifikuara “Sekret shtetëror”.....	3279
Kërkesë e Ministrisë së Arsimit, Sportit dhe Rinisë nr. 3656/1, datë 6.4.2018	Për shpronësim, për interes publik, të pasurive të paluajtshme, pronë private, që preken nga “Ndërtim i ri i shkollës Tip 2 + Tip 4 në Njësinë Administrative nr. 11, Sheshi 11/1”, Tiranë.....	3283
	Vendim për shpalljen të vdekur të shtetasit Afrim Sinan Buçeza.....	3284

**DEKRET****Nr. 10753, datë 3.4.2018****PËR LEJIMIN E LËNIES SË
SHTETËSISË SHQIPTARE**

Në mbështetje të nenit 92, pika “c” dhe nenit 93 të Kushtetutës, si dhe të neneve 15 e 20 të ligjit nr. 8389, datë 5.8.1998, “Për shtetësinë shqiptare”, të ndryshuar, bazuar edhe në propozimin e Ministrisë së Brendshme,

DEKRETOJ:**Neni 1**

U lejohet lënia e shtetësisë shqiptare, me kërkesë të tyre, personave të mëposhtëm:

1. Bledar Halit Mihola
2. Ilija (Ilir) Slobodan Đukić (Kodraj)
3. Dragana (Manjola) Vukashin Matanović (Mino/Mimo)
4. Athanasios Kristo (Hristos) Zhidro (Zhidros)
5. Marsela Besim Blana
6. Orges Vango Toçe
7. Olsi Paskal Petraj
8. Piro Andrea Shtrepi
9. Inva Uzri Halili (Kuhn)
10. Dave Islam Sommer (Hysa)
11. Dejan Branko Vuçiq (Jugu)
12. Mirela Qani Helfrich-Kodra (Helfrich/Rakipi)
13. Albi Musa Kodra
14. Valmir Velo Kontiq
15. Natasha Llazar Davidović (Banushi)
16. Alba Ivanov Metaj
17. Napolon Selim Sulaj
18. Erjola Virxhil Eilzer (Mullisi)
19. Loreta Agim Bakiu
20. Ayoub Hamid Chebaki
21. Nouh Hamid Chebaki
22. Besmir Elmaz Markaj
23. Selvi Dilaver Çarçani (Çeloaliaj)
24. Klara Arben Mamli
25. Avni Idriz Sturies (Buçpapaj)

Neni 2

Ky dekret hyn në fuqi menjëherë.

**PRESIDENTI I REPUBLIKËS SË
SHQIPËRISË
Ilir Meta**

DEKRET**Nr. 10754, datë 3.4.2018****PËR LEJIMIN E LËNIES SË
SHTETËSISË SHQIPTARE**

Në mbështetje të nenit 92, pika “c” dhe nenit 93 të Kushtetutës, si dhe të neneve 15 e 20 të ligjit nr. 8389, datë 5.8.1998, “Për shtetësinë shqiptare”, të ndryshuar, bazuar edhe në propozimin e Ministrisë së Brendshme,

DEKRETOJ:**Neni 1**

U lejohet lënia e shtetësisë shqiptare, me kërkesë të tyre, personave të mëposhtëm:

1. Dorjan Kujtim Sulaj
2. Etleva Ndue Nikolli
3. Alketa Mihal Dani (Gjini)
4. Dorina Ilir Dani
5. Tomorr Ilir Dani
6. Lola Mino Gjini
7. Dušan (Dushan) Mirko Matanović (Veri/Matanović)
8. Dushica Bllago Matanović (Matanović/Neshoja)
9. Altin Ali Tepelija
10. Edoin Marko Pone
11. Avni Ali Karakushi
12. Melisa Avni Karakushi
13. Leona Avni Karakushi
14. Eglantina Shpetim Karakushi (Ademaj)
15. Jorian Zenel Muça
16. Harri Bernard Pambuku
17. Sara Vladimir Radusinović (Radusinović)
18. Mirela Nuro Schlauß (Schlauss/Hasanaj)
19. Zdravko (Edrit) Slobodan Matanović
20. Dejan Pavlo Sekulij (Ashkja)
21. Boban Pavlo Sekulij
22. Rudina Gligo Krstović (Popović)
23. Vladimir Gligo Matanović (Pjetri)
24. Kleodjana Luan Çekrezi (Çelikja)
25. Rigels Kujtim Kateshi
26. Bler Kujtim Vokshi
27. Arled Myslim Kërçiku
28. Florian Arben Bajrami
29. Lina Florian Bajrami
30. Emilia Florian Bajrami
31. Jennifer Ilir Leka



Neni 2

Ky dekret hyn në fuqi menjëherë.

PRESIDENTI I REPUBLIKËS
SË SHQIPËRISË

Ilir Meta

DEKRET**Nr. 10756, datë 3.4.2018**

**PËR LEJIMIN E LËNIES SË
SHTETËSISË SHQIPTARE**

Në mbështetje të nenit 92, pika “c” dhe nenit 93 të Kushtetutës, si dhe të neneve 15 e 20 të ligjit nr. 8389, datë 5.8.1998, “Për shtetësinë shqiptare”, të ndryshuar, bazuar edhe në propozimin e Ministrisë së Brendshme,

DEKRETOJ:

Neni 1

U lejohet lënia e shtetësisë shqiptare, me kërkesë të tyre, personave të mëposhtëm:

1. Artenis Etëhem Islamaj
2. Uliks (Lulzim) Stanko Ajković (Hajkoja)
3. Nada Vaso Ajković (Nikolla)
4. Milijana (Mila) Rade Ajković (Pambuku)
5. Krsto (Kastriot) Leko Matanović (Savoja)
6. Milijana Millan Matanović (Musoja)
7. Miron Kostandin Tarushi
8. Sokol Hasaf Nuri
9. Olsi Gjergji Dhami
10. Elgeta Nazër Sulejmani
11. Erlin Hysen Nina
12. Ylli Sabri Xhelilaj
13. Mimoza Minella Xhelilaj (T'zelilai/
Merkuri)
14. Ines Agim Balla
15. Alexander Edion Cenko
16. Lea Edion Cenko
17. Denisa Luan Guri
18. Aida Shefqet Pengili-Grotkowsky (Pengili)
19. Valbona Martin Kuka (Malçi/Malci)
20. Jenny Arben Kuka

Neni 2

Ky dekret hyn në fuqi menjëherë.

PRESIDENTI I REPUBLIKËS SË
SHQIPËRISË

Ilir Meta

DEKRET**Nr. 10758, datë 10.4.2018**

**PËR DHËNIE TË SHTETËSISË
SHQIPTARE**

Në mbështetje të nenit 92, pika “c” dhe nenit 93 të Kushtetutës, si dhe nenit 9, e nenit 20 të ligjit nr. 8389, datë 5.8.1998 “Për shtetësinë shqiptare”, të ndryshuar, bazuar edhe në propozimin e Ministrisë së Brendshme,

DEKRETOJ:

Neni 1

U jepet shtetësia shqiptare me kërkesë të tyre personave të mëposhtëm:

1. Leotrim Asmon Qevani
2. Ismet Avdi Hiseni
3. Shpend Pajazit Jashari
4. Ardiana Esat Berisha
5. Suzana Kemajl Brovina Kica (Brovina)
6. Shkurtë Feim Spaho (Mazreku)
7. Arlinda Sahit Balaj
8. Demir Kadri Lima
9. Endrit Mujë Shala
10. Fazli Shefshet Gjyliqi

Neni 2

Ky dekret hyn në fuqi menjëherë.

PRESIDENTI I REPUBLIKËS SË
SHQIPËRISË

Ilir Meta

UDHËZIM**Nr. 2, datë 23.3.2018**

**PËR DISA SHITESA DHE NDRYSHIME
NË UDHËZIMIN NR. 1, DATË 19.2.2018,
“PËR KRITERET, PROCEDURAT DHE
MËNYRËN E ADMINISTRIMIT TË
FONDIT TË PROGRAMIT PËR
BUJQËSINË DHE ZHVILLIMIN RURAL”**

Në mbështetje të nenit 102, pika 4, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, të nenit 6, pika 3, të ligjit nr. 9817, datë 22.10.2007, “Për bujqësinë dhe zhvillimin rural”, të ndryshuar, të nenit 18, të ligjit nr. 64/2012, “Për peshkimin”, të VKM-së nr. 701, datë 12.10.2016, “Për miratimin e Strategjisë Kombëtare të peshkimit për



periudhën 2016-2021”, ligjit nr. 109, datë 30.12.2017, “Për buxhetin e vitit 2018”; të pikës 4, të VKM-së nr. 72, datë 7.2.2018, “Për përcaktimin e kriterëve bazë, të sektorëve që do të mbështeten dhe të masës së përfitimit nga fondi i programit për bujqësinë dhe zhvillimin rural për vitin 2018”, të VKM-së nr. 21, datë 12.1.2018, “Për disa shtesa në vendimin 709, datë 29.10.2014, të Këshillit të Ministrave, “Për miratimin e Strategjisë Ndërsektoriale për Zhvillimin Rural dhe Bujqësor 2014-2020”, VKM-së nr. 22, datë 12.1.2018, “Për miratimin e kriterëve për certifikimin e veprimtarisë së agroturizmit”, të udhëzimit të Ministrisë së Financave, nr. 19, datë 3.11.2014, “Për zbatimin e regjimit të veçantë të masës së kompensimit të prodhimeve bujqësore, për qëllime të tatimit mbi vlerën e shtuar”,

UDHËZOJMË:

Në udhëzimin nr. 1, datë 19.2.2018, “Për kriteret, procedurat dhe mënyrën e administrimit të fondit të programit për bujqësinë dhe zhvillimin rural”, bëhen shtesat dhe ndryshimet si më poshtë vijon:

1. Në kreun IV, paragrafi i dytë, në fund të fjalisë “Aplikimet do të bëhen nga data 28.2.2018 deri më 28.3.2018”, shtohet “ndërsa për masat mbështetëse të investimeve me nr. 12, 20-24, 32-36, 40 dhe 44-52, afati i aplikimit do të jetë deri në 27.4.2018”.

2. Në kreun VI, pika 2 (i), shkronja “P”, në fund të fjalisë: “Të realizojnë mbjelljet brenda 6-mujorit të parë të vitit 2018”, shtohet: “me përjashtim të mbjelljeve të luleshtrydhes në serra dhe/ose tunele, që realizohen edhe në periudhën gusht-tetor”.

3. Në kreun IX, pika 2, Masa 45, “i”, shkronja “a” dhe “iii”, shkronja “c”, shfuqizohen.

4. Në aneksin 2, grup-masat III, shtohet “Ambiente grumbullimi dhe ruajtëse frigoriferike për prodhime peshkore (përfshirë dhe akuakulturën), masa 20”.

Ky udhëzim hyn në fuqi menjëherë.

MINISTRI I BUJQËSISË
DHE ZHVILLIMIT RURAL
Niko Peleshi
MINISTRI I FINANCIVE
DHE EKONOMISË
Arben Ahmetaj

URDHËR

Nr. 125, datë 23.3.2018

**PËR NJË SHITESË NË ANEKSIN II,
“MISH I FRESKËT”, PJESA 1, TË
URDHRIT TË MINISTRIT NR. 328,
DATË 22.11.2011, PËR MIRATIMIN E
RREGULLORES “MBI PËRCAKTIMIN E
KRITEREVE DHE KËRKESAVE PËR
CERTIFIKIMIN VETERINAR TË DISA
LLOJE KAFSHËSH DHE MISHIT TË
FRESKËT TË TYRE, TË CILAT HYJNË
NË REPUBLIKËN E SHQIPËRISË NGA
SHTETE TË CAKTUARA, SI DHE NGA
TERRITORE TË TJERA NË
ADMINISTRIM TË KËTYRE
SHTETEVE”, TË NDRYSHUAR**

Në mbështetje të nenit 102, pika 4 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, nenit 55 të ligjit nr. 10 465, datë 29.9.2011, “Për shërbimin veterinar në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, nenit 18 të ligjit nr. 9863, datë 28.1.2008, “Për ushqimin”, të ndryshuar,

URDHËROJ

1. Në urdhrin e ministrit nr. 328, datë 22.11.2011, “Për miratimin e rregullores “Mbi përcaktimin e kriterëve dhe kërkesave për certifikimin veterinar të disa lloje kafshësh dhe mishit të freskët të tyre, të cilat hyjnë në Republikën e Shqipërisë nga shtete të caktuara, si dhe nga territore të tjera në administrim të këtyre shteteve”, të ndryshuar, në aneksin II, “Mish i freskët”, pjesa 1, në pikën 2, “Lista e vendeve jashtë Bashkimit Europian, territoreve dhe pjesëve të tyre”, rreshti RS – Serbi, kolona 4, pas fjalës “EQU” shtohet fjala “POR”.

2. Për zbatimin e këtij urdhri ngarkohen Drejtoria e Derregullimit, Lejeve, Licencave dhe Monitorimit dhe Autoriteti Kombëtar i Ushqimit.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

MINISTRI I BUJQËSISË
DHE ZHVILLIMIT RURAL
Niko Peleshi



programeve operacionale mbi bazën e rajoneve të zhvillimit, siç është rasti i projektdokumentit të programit të rajonit nr. 2, si dhe i zhvillimit të mjeteve të tjera të lidhur me zhvillimin rajonal. Kontribut në këtë drejtim po japin edhe Agjencitë për Zhvillimin Rajonal dhe Agjencia Kombëtare për Zhvillimin Ekonomik Rajonal, me aktivitetin e tyre.

Në kuadër të progresit në procesin e çeljes së negociatave dhe të përgatitjes për integrimin në Bashkimin Evropian të vendit, veç kuadrit strategjik të politikës, orientimet kryesore të politikës dhe drejtimit prioritar të saj kanë ndikim orientues edhe nga politika për zhvillim rajonal e BE-së.

Konteksti i politikës rajonale të BE-së për zhvillimin rajonal

Fondi Evropian i Zhvillimit të Rajoneve² (FEZHR) për periudhën 2014–2020, i fokuson ndërhyrjet dhe investimet në disa akse prioritare, të njohura si “përqendrime tematike”, përkatësisht:

- Inovacioni dhe hulumtimi;
- Agjenda digjitale;
- Mbështetje për ndërmarrjet e vogla dhe të mesme (SME);
- Ekonomia e ulët e karbonit.

FEZHR-ja, gjithashtu, u kushton vëmendje të veçantë karakteristikave specifike territoriale. Masat e FEZHR-së janë projektuar për të reduktuar problemet ekonomike, mjedisore dhe sociale në zonat urbane, me fokus të veçantë në zhvillimin e qëndrueshëm urban.

Të paktën 5% e burimeve të FEZHR-së janë të vendosura përmes “veprimeve të integruara”, të menaxhuara nga qytetet.

Zonat e pafavorizuara nga një këndvështrim gjeografik (zonat e largëta malore ose zonat me popullsi të ulët) përfitojnë nga trajtimi i veçantë. Së fundi, zonat larg qendrës, gjithashtu, përfitojnë nga ndihma specifike e FEZHR-së, për të trajtuar dizavantazhet e mundshme për shkak të largësisë së tyre.

Kuadri ligjor për zhvillimin rajonal

Ligji vjetor i buxhetit³ përbën bazën kryesore ligjore të lidhur me funksionimin e Fondit për

Zhvillimin e Rajoneve (FZHR), si instrument zhvillimor dhe një mekanizëm financiar konkurrues, që mbështet politikën kombëtare të zhvillimit rajonal dhe lokal, e cila si u përmend më lart derivon nga kuadri strategjik i politikës.

Sipas tij, qëllimi i FZHR-së është sigurimi i zbatimit të objektivave të politikës së kohezionit territorial, për të pasur rajone me zhvillim të balancuar, konkurruese dhe me zhvillim të qëndrueshëm ekonomik, social e mjedisor. FZHR-ja, për vitin 2018 përbëhet dhe financohet nga 6 grante konkurruese.

Vështrim në vitin pararendës (cikli 2017–2018)

Për vitin 2017, Fondi për Zhvillimin e Rajoneve u orientua për financimin e projekteve të reja, që mbështesin ndërhyrjet e nisura dhe fuqizimin e impaktit të tyre, duke synuar rritjen e efektivitetit dhe të efikasitetit të politikave të zhvillimit rajonal.

Përgjatë vitit 2017, drejtimit prioritar të Fondit për Zhvillimin e Rajoneve kanë qenë, ndër të tjera:

- Rivitalizimi i poliçendrave urbane dhe ekonomive lokale;
- Kohezioni territorial dhe zhvillimi rajonal;
- Stimulimi i zonave dhe i poleve potenciale, *cluster* të zhvillimit;
- Qytetet moderne, digjitalizimi dhe modernizimi i qyteteve - *Smart City*.

Programi i infrastrukturës vendore dhe rajonale, së pari, përmes grantit të infrastrukturës vendore dhe rajonale, ka qenë i fokusuar në rikualifikimin urban të hapësirave dhe të infrastrukturës publike, duke synuar rivitalizimin e qytetit dhe të fshatit, zonave urbane dhe të lidhjes me ato rurale dhe, konkretisht ka orientuar ndërhyrje në sheshe dhe “qendra” urbane e rurale etj. Investimet e projektuara nga aplikuesit në këto hapësira, qartësisht kanë përmirësuar jo vetëm infrastrukturën, por edhe kanë kontribuar në rritjen dhe fuqizimin e ekonomive lokale, si edhe në rritjen e vlerës në zonat e investuara dhe përreth.

Në vitin 2017 janë vënë në realizim 66 projekte të reja, veç atyre në vazhdim, miratuar në vitin 2017 nga Fondi për Zhvillimin e Rajoneve. Në përmbledhje ato janë:

- i) 15 projekte të ndërlidhjes së zonave rurale (nevojat për ndërhyrje, prodhim-tregje ose lidhjes

² http://ec.europa.eu/regional_policy/en/funding/erdf/

³ Ligji nr. 109/2017, datë 30.11.2017, “Për buxhetin e vitit 2018”.



me shërbimet), rrugësh rurale, p.sh., rikonstruksion i rrugës fshati Zaharishtë - Has, rikonstruksioni i rrugës Xhami – Golem në Kavajë, rikonstruksion i rrugës Gostim - Tregan në Elbasan, rikonstruksion i rrugës Pishporo – Bregdet - Fier, rikonstruksion i rrugës Kthesa e Pilurit - Himarë etj.;

ii) 30 projekte të ndërlidhjes së zonave urbane (nevojat për ndërhyrje dhe forcimi i lidhjeve rajonale ose ndërqytetase, si dhe i lëvizjes në qytete), rrugësh urbane, si p.sh., ndërtimi i *By Pass*-it Klos, unaza lindore në Kavajë, unaza e Pogonit në Dropull, zgjatim i unazës së Rrëshenit, rikonstruksioni i rrjetit rrugor Shijak etj.;

iii) 11 projekte të rivitalizimit të jetës komunitare dhe të mbështetjes së zhvillimit të potencialit të ekonomisë lokale dhe të potencialit për zona të përmirësuara biznesi në qytete, si sheshet dhe qendrat urbane, si p.sh., rikualifikimi i sheshit “Livadhja” - Finiq, i qendrës së Leskovikut, sheshi urban Zaranika - Elbasan, sheshi “Mustafa Merlika”, Krujë, qendra e qytetit Bulqizë etj.;

iv) 10 projekte të përmirësimit të cilësisë së infrastrukturës së qyteteve (blloqeve dhe lagjeve të banimit), si p.sh., ndërhyrje dhe rehabilitim i fasadave: Vau i Dejës, Bajram Curri, në shëtitoren “Miqësia” në Polican, në qendrën e Belshit, në bulevardin “Republika” në Berat etj.

Granti i arsimit, ka mundësuar mbështetje në rehabilitimin e rreth 29 objekteve arsimore dhe terreneve sportive, si p.sh., shkolla “Saba Sinani”, Pukë; shkolla “Gjocaj”, Peqin; shkolla artistike “Jakov Xoxa”, Fier; shkolla “Papa Kristo Negovani”, Ersekë; shkolla “14 Nëntori”, Durrës etj., si dhe p.sh., palestra sportive “Ismail Qemali”, Vlorë; terrenet sportive të shkollës “Gaqi Karakashi” dhe “28 Nëntori”, Kuçovë; rikonstruksion i ambienteve sportive shkolla “Gjin Pjetri”, Kurbin etj.

Granti për rehabilitim mjedisor, gjelbërim dhe pyllëzim ka mbështetur 2 projekte nga Fondi për Zhvillimin e Rajoneve për vitin 2017, atë të gjelbërimit dhe pyllëzimit të ambienteve përreth qyteteve Përrenjas dhe Vau i Dejës.

Programi “Shqipëria digjitale”, ka pasur si synim të mbështesë inovacionin në ofrimin e shërbimeve dhe informimin e qytetarëve, përmes objektivit “Qytete të zgjuara” (*Smart Cities*), si

dhe sistemet të administrimit publik dhe të shërbimeve të njëjësive të qeverisjes vendore apo infrastrukturën e ndërlidhjes digjitale. Granti “Shqipëria digjitale” ka mundësuar financimin e 5 projekteve nga Fondi për Zhvillimin e Rajoneve për vitin 2017, më konkretisht:

v) Projekte (sisteme infrastrukture) “*Virtual Smart City*”, si p.sh., modeli 3D i qytetit Gjirokastrë, sistemi multifunksional “*Smart City*”, Lungomare;

vi) Sisteme *Wi-Fi* dhe ndërtim i infrastrukturës përkatëse, si p.sh., sistemi për shkollat në Malësinë e Madhe dhe infrastrukturë komunikimi për Bashkinë Elbasan;

vii) Sistem i qendërzuar për monitorimin e detyrimeve të prapambetura Bashkia Tiranë.

Programi operacional 2018–2019

Për vitin 2018, Fondi për Zhvillimin e Rajoneve përbëhet nga 6 grante, me financim nga buxheti i ministrive dhe Fondi Shqiptar i Zhvillimit.

Ligji parashikon që portofoli i fondit për vitin 2018, për projekte të reja, të ketë si kontribut edhe bashkëfinancimin nga njësitë e qeverisjes vendore dhe aplikuesit. Vlera e këtij bashkëfinancimi, sipas ligjit të buxhetit 2018, përcaktohet me vendim të Komitetit për Zhvillimin e Rajoneve.

Për vitin 2018, për së pari, Fondi, përmes programeve buxhetore të granteve në ministrinë përkatëse dhe Fondit Shqiptar të Zhvillimit, mbështet financimin dhe përfundimin e punimeve të objekteve në vazhdim, të cilat parashikohen sipas legjislacionit financiar në fuqi dhe udhëzimeve përkatëse të Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë.

Për vitin 2018 nuk parashikohen fonde për investime/projekte të reja, për:

1. Granti për infrastrukturë vendore dhe rajonale;

2. Granti për shëndetësinë (shërbimet e kujdesit shëndetësor parësor);

3. Granti për artin dhe kulturën;

4. Granti për ujësjellës-kanalizimet;

5. Granti për rehabilitimin mjedisor, gjelbërimin dhe pyllëzimin.

Për grantet “Arsimi” ku parashikohen fonde për investime/projekte të reja për vitin 2018–2019, si orientim/fokus të jetë “zgjerimi i ndërhyrjeve rehabilituese dhe të përmirësimit të



kushteve në objektet arsimore, me qëllim rritjen e aksesit në shkolla dhe përmirësimin e kushteve dhe infrastrukturës shkollore dhe të mjediseve të tjera sportive dhe të shkollës qendër komunitare”.

Drejtimit e thirrjes, për çdo thirrje për projekte të reja, në grantet e fondit, miratohen më konkretisht rast pas rasti, me vendim të Komitetit për Zhvillimin e Rajoneve.

Mekanizmat institucionalë dhe instrumentet financiare

Në bazë të aneksit 3, të ligjit nr. 109/2017, “Për buxhetin e vitit 2018”, instrumenti i financimit, i cili adreson praktikisht disa aspekte dhe çështje të zhvillimit rajonal, është Fondi për Zhvillimin e Rajoneve. Fondi për Zhvillimin e Rajoneve përfaqëson një instrument zhvillimor dhe një mekanizëm financiar konkurrues që mbështet politikën kombëtare të zhvillimit rajonal e vendor, për të siguruar zbatimin e objektivave të politikës së kohezionit territorial, për të pasur rajone me zhvillim të balancuar, konkurruese dhe me zhvillim të qëndrueshëm ekonomik, social e mjedisor.

Fondi për Zhvillimin e Rajoneve përbëhet nga 6 grante konkurruese:

1. Granti për infrastrukturën vendore dhe rajonale;
2. Grantet për arsimin;
3. Granti për shëndetësinë;
4. Granti për artin dhe kulturën;
5. Granti për ujësjellës-kanalizimet;
6. Granti për rehabilitim mjedisor, gjelbërim dhe pyllëzim.

Subjektet aplikuese dhe zbatuese (autoritetet kontraktore), përfituese të programeve, ndjekin rregullat, si më poshtë:

a) Aplikimi për financimin e projekteve nga fondet për infrastrukturën vendore bëhet nga njësitë e vetëqeverisjes vendore, subjekte të kompetencave të përbashkëta të tyre, shoqëritë e ujësjellës-kanalizimeve, Agjencia Kombëtare për Zhvillim Rajonal, agjencitë për zhvillim rajonal nr. 1, nr. 2, nr. 3 dhe nr. 4, partneritetet ndërvendore dhe rajonale, agjentët zhvillimorë në nivel lokal dhe/ose rajonal. Njësitë e vetëqeverisjes vendore, të cilat do të aplikojnë, duhet të sigurojnë kontributin nga buxheti i tyre si bashkëfinancim. Komiteti për Zhvillimin e Rajoneve (KZHR) vendos vlerën e bashkëfinancimit për çdo projekt.

b) Në rastet e projekteve me disa përfitues në skemat e partneritetit ndërvendor dhe rajonal ose në raste të tjera të veçanta, marrëveshja e partneritetit midis përfituesve cakton autoritetin kontraktor që i propozohet Komitetit për Zhvillimin e Rajoneve për miratim. Komiteti miraton me vendim autoritetin kontraktor për zbatimin e projektit, i cili mund të jetë njëri prej përfituesve dhe/ose Agjencia Kombëtare për Zhvillim Rajonal, dhe/ose Agjencia për Zhvillim Rajonal, dhe/ose Fondi Shqiptar i Zhvillimit, dhe/ose agjenti zhvillimor në nivel lokal dhe/ose rajonal, përfaqësues i partneritetit ndërvendor dhe rajonal.

c) Zbatimi i projekteve të miratuara me vendim të Komitetit për Zhvillimin e Rajoneve është përgjegjësi parësore e autoriteteve kontraktuese, në bashkëpunim me përfituesit përkatës për çdo projekt, të cilët zbatojnë projektet sipas rregullave dhe akteve ligjore e nënligjore përkatëse.

ç) Rregulla të hollësishme lidhur me raportimin e autoriteteve kontraktuese miratohen me vendim të Komitetit për Zhvillimin e Rajoneve.

Sekretariatet teknike të programeve të zhvillimit të infrastrukturës vendore ngrihen në ministrinë përkatëse të linjës dhe pranë Fondit Shqiptar të Zhvillimit, si më poshtë:

i) Sekretariati teknik i grantit për infrastrukturën vendore dhe rajonale ngrihet pranë Fondit Shqiptar të Zhvillimit;

ii) Sekretariati teknik i grantit për arsimin ngrihet pranë Ministrisë së Arsimit, Sportit dhe Rinisë;

iii) Sekretariati teknik i grantit për shëndetësinë ngrihet pranë Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale;

iv) Sekretariati teknik i grantit për artin dhe kulturën ngrihet pranë Ministrisë së Kulturës;

v) Sekretariati teknik i grantit për ujësjellës-kanalizimet ngrihet pranë Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë;

vi) Sekretariati teknik i grantit për rehabilitimin mjedisor, gjelbërimin dhe pyllëzim ngrihet pranë Ministrisë së Turizmit dhe Mjedisit.



Kalendari i thirrjeve për projekte të reja 2018

Kalendari i thirrjeve për projekte të reja parashikohet sipas ciklit të zbatimit të buxhetit për vitin 2018 dhe hartimit të buxhetit për vitin 2019 etj., në përputhje me aktet dhe udhëzimet për këtë qëllim.

Thirrjet për projektet e reja, për ato grante ku parashikohen fonde për projekte të reja, zhvillohen gjatë periudhës prill–maj 2018, ndërsa për të parapërgatitur vitin buxhetor 2019, sipas parashikimit në aneksin 3, të ligjit të buxhetit 2018, thirrjet për vitin pasardhës mund të zhvillohen që në muajin nëntor të vitit paraardhës, pra në nëntor të vitit 2018.

VENDIM

Nr. 3, datë 10.4.2018

PËR DISA NDRYSHIME NË VENDIMIN NR. 8, DATË 13.2.2017, TË KOMITETIT PËR ZHVILLIMIN E RAJONEVE, “PËR SHPËRNDARJEN E FINANCIMIT PËR PROJEKTE, THIRRJA E KATËRT PËR VITIN 2016, TË GRANTIT “INFRASTRUKTURA VENDORE DHE RAJONALE”, PROGRAMI I ZHVILLIMIT TË INFRASTRUKTURËS VENDORE DHE RAJONALE, SHTYLLA I”

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të nenit 16 dhe të aneksit 3, të ligjit nr. 109, datë 30.11.2017, “Për buxhetin e vitit 2018”, me propozim të Fondit Shqiptar të Zhvillimit, Komiteti për Zhvillimin e Rajoneve

VENDOSI:

1. Në tabelën nr. 1/1 që i bashkëlidhet vendimit nr. 8, datë 13.2.2017, të Komitetit për

Zhvillimin e Rajoneve, “Për shpërndarjen e financimit për projekte, thirrja e katërt për vitin 2016, të grantit “Infrastrukturë vendore dhe rajonale”, Programi i Zhvillimit të Infrastrukturës Vendore dhe Rajonale, shtylla I, për vitin 2016”, bëhen ndryshimet sipas tabelës 1/1 bashkëlidhur këtij vendimi.

2. Ngarkohen ministri i Financave dhe Ekonomisë dhe Fondi Shqiptar i Zhvillimit për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDËSKRYETARI
Senida Mesi

Zëvendëskryeministri	zëvendëskryetar;
Ministri i Financave dhe Ekonomisë	anëtar;
Ministri i Infrastrukturës dhe Energjisë	anëtar;
Ministri i Arsimit, Sportit dhe Rinisë	anëtar;
Ministri i Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural	anëtar;
Ministri i Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale	anëtar;
Ministri i Kulturës	anëtar;
Ministri i Turizmit dhe Mjedisit	anëtar;
Ministri i Brendshëm	anëtar;
Ministri i Shtetit për Mbrojtjen e Sipërmarrjes	anëtar;
Kryetari i Shoqatës së Bashkive të Shqipërisë	anëtar;
Kryetari i Shoqatës për Autonomi Vendore	anëtar;
Kryetari i Shoqatës së Qarqeve të Shqipërisë	anëtar;
Përfaqësuesi i Fondit Shqiptar të Zhvillimit	anëtar.

Në tabelën 1/1 që i bashkëlidhet vendimit nr. 8, datë 13.2.2017, të Komitetit për Zhvillimin e Rajoneve, “Për shpërndarjen e financimit për projekte, thirrja e katërt për vitin 2016, të grantit “Infrastrukturë vendore dhe rajonale”, Programi i Zhvillimit të Infrastrukturës Vendore dhe Rajonale, shtylla I, për vitin 2016”, bëhen ndryshimet, si më poshtë vijon:

Tabela 1/1. Lista e disa projekteve të reja, thirrja e katërt për vitin 2016, me cikël zbatimi 2017–2018

Nr.	Autoriteti kontraktues	Emërtimi i projektit	Vlera e plotë e projektit (në lekë)	Vlera e financimit për vitin 2018 (në lekë)
5	Bashkia Tiranë	Rikualifikim urban i bllokut që kufizohet nga: Rruga e Elbasanit – “Stavri Vinjaku” – “Pjetër Budi” – “Ali Visha”, NJA 2	141,426,758	70,713,379



Shënim:

1. “Vlera e projektit” përfaqëson vlerën e financimit të projektit, miratuar me vendim të Komitetit për Zhvillimin e Rajoneve.

2. “Vlera e financimit për vitin 2018” është financimi që jepet për vitin 2018, me burim fondin për projekte në vazhdim, të programit buxhetor “Infrastrukturë vendore dhe rajonale” të Fondit Shqiptar të Zhvillimit për vitin 2018.

3. Likuidimi financiar për vlerën e projektit (ose për vlerën e kontratës pas prokurimit publik) në vitet në vazhdim do të kryhet nga Fondi Shqiptar i Zhvillimit, duke u bazuar edhe në ecurinë e zbatimit dhe të realizimit të projekteve, programuar në buxhet, me shtrirje në 2 vite.

VENDIM

Nr. 4, datë 10.4.2018

PËR DISA NDRYSHIME NË VENDIMIN NR. 12, DATË 21.3.2017, TË KOMITETIT PËR ZHVILLIMIN E RAJONEVE “PËR SHPËRNDARJEN E FINANCIMIT PËR PROJEKTE TË GRANTIT “INFRASTRUKTURA VENDORE DHE RAJONALE”, PROGRAMI I ZHVILLIMIT TË INFRASTRUKTURËS VENDORE DHE RAJONALE, SHTYLLA I”

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të nenit 16 dhe të aneksit 3, të ligjit nr. 109 datë 30.11.2017, “Për buxhetin e vitit 2018”, me propozim të Fondit Shqiptar të Zhvillimit, Komiteti për Zhvillimin e Rajoneve

VENDOSI:

1. Në tabelën 1 që i bashkëlidhet vendimit nr. 12, datë 21.3.2017, të Komitetit për Zhvillimin e Rajoneve, “Për shpërndarjen e financimit për

projekte të reja, thirrja e parë për vitin 2017, të grantit “Infrastrukturë vendore dhe rajonale”, Programi i Zhvillimit të Infrastrukturës Vendore dhe Rajonale, shtylla I”, bëhen ndryshimet sipas tabelës 1 bashkëlidhur këtij vendimi.

2. Ngarkohen ministri i Financave dhe Ekonomisë dhe Fondi Shqiptar i Zhvillimit për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDËSKRYETARI

Senida Mesi

Zëvendëskryeministri	zëvendëskryetar;
Ministri i Financave dhe Ekonomisë	anëtar;
Ministri i Infrastrukturës dhe Energjisë	anëtar;
Ministri i Arsimit, Sportit dhe Rinisë	anëtar;
Ministri i Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural	anëtar;
Ministri i Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale	anëtar;
Ministri i Kulturës	anëtar;
Ministri i Turizmit dhe Mjedisit	anëtar;
Ministri i Brendshëm	anëtar;
Ministri i Shtetit për Mbrojtjen e Sipërmarrjes	anëtar;
Kryetari i Shoqatës së Bashkive të Shqipërisë	anëtar;
Kryetari i Shoqatës për Autonomi Vendore	anëtar;
Kryetari i Shoqatës së Qarqeve të Shqipërisë	anëtar;
Përfaqësuesi i Fondit Shqiptar të Zhvillimit	anëtar.

Në tabelën 1 që i bashkëlidhet vendimit nr. 12, datë 21.3.2017, të Komitetit për Zhvillimin e Rajoneve, “Për shpërndarjen e financimit për projekte të reja, thirrja e parë për vitin 2017, të grantit “Infrastrukturë vendore dhe rajonale”, Programi i Zhvillimit të Infrastrukturës Vendore dhe Rajonale, shtylla I, bëhen ndryshimet, si më poshtë vijon:

Tabela 1. Lista e projekteve të reja, thirrja I për vitin 2017, për grantin “Infrastruktura vendore dhe rajonale”, Programi i Zhvillimit të Infrastrukturës Vendore dhe Rajonale, me cikël zbatimi 2017–2018

Nr.	Autoriteti kontraktues	Emërtimi i projektit	Vlera e plotë e projektit (në lekë)	Vlera e financimit për vitin 2018 (në lekë)
30	Bashkia Libohovë	Rikonstruksion i rrugës “Kthesë e Nepravishtës” – “Fushë Nepravishtë”	17,908,818	17,908,818

Shënim:

1. “Vlera e projektit” përfaqëson vlerën e financimit të projektit, miratuar me vendim të Komitetit për Zhvillimin e Rajoneve.

2. “Vlera e financimit për vitin 2018” është financimi që jepet për vitin 2018, me burim fondin për projekte në vazhdim, të programit buxhetor “Infrastrukturë vendore dhe rajonale” të Fondit Shqiptar të Zhvillimit për vitin 2018.

**VENDIM****Nr. 5, datë 10.4.2018**

**PËR DISA NDRYSHIME NË VENDIMIN
NR. 16, DATË 12.4.2017, TË KOMITETIT
PËR ZHVILLIMIN E RAJONEVE
QË NDRYSHON VENDIMIN
NR. 37, DATË 13.7.2016,
TË KOMITETIT PËR ZHVILLIMIN E
RAJONEVE, “PËR SHPËRNDARJEN E
FINANCIMIT PËR PROJEKTE TË
GRANTIT “ARSIMI”, THIRRJA E DYTË,
PROGRAMI I ZHVILLIMIT TË
INFRASTRUKTURËS VENDORE DHE
RAJONALE, SHTYLLA I,
PËR VITIN 2016”**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të nenit 16 dhe të aneksit 3, të ligjit nr. 109, datë 30.11.2017, “Për buxhetin e vitit 2018”, me propozim të ministrit të Arsimit, Sportit dhe Rinisë, Komiteti për Zhvillimin e Rajoneve

VENDOSI:

1. Në tabelën 1, që i bashkëlidhet vendimit nr. 16, datë 12.4.2017, të Komitetit për Zhvillimin e Rajoneve që ndryshon vendimin nr. 37, datë 13.7.2016, të Komitetit për Zhvillimin e Rajoneve, “Për shpërndarjen e financimit për projekte të grantit “Arsimi”, thirrja e dytë, Programi i Zhvillimit të Infrastrukturës Vendore dhe Rajonale, shtylla I, për vitin 2016”, bëhen ndryshimet sipas tabelës 1, bashkëlidhur këtij vendimi.

2. Ngarkohen ministri i Financave dhe Ekonomisë dhe ministri i Arsimit, Sportit dhe Rinisë për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

**ZËVENDESKRYETARI
Senida Mesi**

Zëvendëskryeministri	zëvendëskryetar;
Ministri i Financave dhe Ekonomisë	anëtar;
Ministri i Infrastrukturës dhe Energjisë	anëtar;
Ministri i Arsimit, Sportit dhe Rinisë	anëtar;
Ministri i Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural	anëtar;
Ministri i Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale	anëtar;
Ministri i Kulturës	anëtar;
Ministri i Turizmit dhe Mjedisit	anëtar;
Ministri i Brendshëm	anëtar;
Ministri i Shtetit për Mbrojtjen e Sipërmarrjes	anëtar;
Kryetari i Shoqatës së Bashkive të Shqipërisë	anëtar;
Kryetari i Shoqatës për Autonomi Vendore	anëtar;
Kryetari i Shoqatës së Qarqeve të Shqipërisë	anëtar;
Përfaqësuesi i Fondit Shqiptar të Zhvillimit	anëtar.

Në tabelën 1 që i bashkëlidhet vendimit nr. 16, datë 12.4.2017, të Komitetit për Zhvillimin e Rajoneve, që ndryshon vendimin nr. 37, datë 13.7.2016, “Për shpërndarjen e financimit për projekte të grantit “Arsimi”, thirrja e dytë, Programi i Zhvillimit të Infrastrukturës Vendore dhe Rajonale, shtylla I, për vitin 2016”, bëhen ndryshimet, si më poshtë vijon:

Tabela 1. Lista e projekteve të reja për financim, thirrja e dytë, përmes grantit “Arsimi”, Programi i Zhvillimit të Infrastrukturës Vendore dhe Rajonale, shtylla I, për vitin 2016

Nr.	Autoriteti kontraktues	Emërtimi i projektit	Vlera e plotë e projektit (në lekë)	Vlera e financimit për vitin 2018 (në lekë)
1	Bashkia Gramsh	Rikonstrukcion i shkollës 9-vjeçare “Asllan Shahini”, Bashkia Gramsh	55,024,983	27,000,000

Shënim:

1. “Vlera e projektit” përfaqëson vlerën e financimit të projektit, miratuar me vendim të Komitetit për Zhvillimin e Rajoneve.

2. “Vlera e financimit për vitin 2018” është financimi që jepet për vitin 2018, me burim fondin për projekte në vazhdim, të programit buxhetor “Arsimi bazë” të Ministrisë së Arsimit dhe Sportit, për vitin 2018.

3. Likuidimi financiar për vlerën e projektit (ose për vlerën e kontratës pas prokurimit publik) në vitet në vazhdim do të kryhet nga Ministria e Arsimit dhe Sportit, duke u bazuar edhe në ecurinë e zbatimit dhe të realizimit të projekteve, programuar në buxhet, me shtrirje në 2 vite.

**VENDIM****Nr. 6, datë 10.4.2018**

**PËR SHPALLJEN E THIRRJES SË PARË,
PËR FINANCIMIN E PROJEKTEVE
NGA GRANTET “ARSIMI”, PJESË E
FONDIT PËR ZHVILLIMIN E
RAJONEVE, PËR VITIN 2018**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të nenit 16 dhe të aneksit 3, të ligjit nr. 109, datë 30.11.2017, “Për buxhetin e vitit 2018”, me propozim të ministrit të Arsimit, Sportit dhe Rinisë, Komiteti për Zhvillimin e Rajoneve

VENDOSI:

1. Shpalljen e thirrjes së parë për financimin e projekteve të reja nga Fondi për Zhvillimin e Rajoneve për vitin 2018, sipas granteve të financimit, si më poshtë vijon:

1.1 Grantet për “Arsimin” (a) granti për arsimin bazë; b) granti për arsimin e mesëm të përgjithshëm, c) granti për arsimin e lartë dhe d) granti për sportin).

1.2 Drejtimit e thirrjes për financim janë:

a) Rehabilitim dhe zgjerim kapacitetesh të objekteve arsimore ekzistuese në arsimin bazë, me qëllim reduktimin/eliminimin e mësimit me turne dhe ose për të bërë të mundur ndarjen e ambienteve në shkollat e bashkuara (ndarjen e mjediseve të nxënësve/fëmijëve që mësojnë në shkolla 9-vjeçare nga nxënësit që mësojnë në shkolla të arsimit të mesëm të përgjithshëm), si dhe të atyre që kanë nevojë emergjente për ndërhyrje apo kanë të domosdoshme ndërhyrjet në infrastrukturën fizike;

b) Rehabilitim dhe/ose zgjerim kapacitetesh të objekteve arsimore ekzistuese në arsimin e mesëm të përgjithshëm, të cilat paraqesin rrezik shembjeje dhe/ose kanë nevojë emergjente për ndërhyrje dhe/ose kanë të domosdoshme ndërhyrjet në infrastrukturën fizike;

c) Rehabilitim dhe/ose zgjerim kapacitetesh të objekteve arsimore ekzistuese në arsimin e lartë, me qëllim përmirësimin e standartit infrastrukturor (raporti student/m²) dhe/ose përmirësimi i kushteve në ambientet dhe infrastrukturën e godinave të IAL-ve publike;

d) Risetim të terreneve sportive të shkollave dhe/ose shkollës, si qendër komunitare në mjediset e tjera sportive, në shërbim të komunitetit.

2. Për grante sipas pikës 1.1 dhe drejtimit sipas shkronjave “a”, “b”, “c” dhe “d”, të pikës 1.2 të këtij vendimi, vlera e financimit të thirrjes së parë për vitin 2018 është 1.500.000.000 lekë (një miliard e pesëqind milionë) lekë.

3. Vlera e bashkëfinancimit nga aplikuesi për çdo projekt sipas granteve është sipas shtojcës I bashkëlidhur këtij vendimi.

4. Aplikimi për financimin e projekteve të përmendura në shkronjat “a”, “b”, dhe “d”, të pikës 1.2 të këtij vendimi, bëhet nga njësitë e qeverisjes vendore, si dhe nga njësitë e qeverisjes vendore të cilat kanë marrëveshje partneriteti me Fondin Shqiptar të Zhvillimit, sipas shtojcave II dhe III, bashkëlidhur këtij vendimi.

5. Aplikimi për financimin e projekteve të përmendura në shkronjat “c”, të pikës 1.2 të këtij vendimi, bëhet nga institucionet e arsimit të lartë, sipas shtojcave II dhe III bashkëlidhur këtij vendimi.

6. Procedura e vlerësimit të projekteve të aplikuara kryhet nga sekretariati teknik, në Ministrinë e Arsimit, Sportit dhe Rinisë, sipas kriterëve të dhëna në shtojcën IV bashkëlidhur këtij vendimi.

7. Ngarkohet ministri i Arsimit, Sportit dhe Rinisë dhe ministri i Brendshëm për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDESKRYETARI
Senida Mesi

Zëvendëskryeministri	zëvendëskryetar;
Ministri i Financave dhe Ekonomisë	anëtar;
Ministri i Infrastrukturës dhe Energjisë	anëtar;
Ministri i Arsimit, Sportit dhe Rinisë	anëtar;
Ministri i Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural	anëtar;
Ministri i Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale	anëtar;
Ministri i Kulturës	anëtar;
Ministri i Turizmit dhe Mjedisit	anëtar;
Ministri i Brendshëm	anëtar;
Ministri i Shtetit për Mbrojtjen e Sipërmarrjes	anëtar;
Kryetari i Shoqatës së Bashkive të Shqipërisë	anëtar;
Kryetari i Shoqatës për Autonomi Vendore	anëtar;
Kryetari i Shoqatës së Qarqeve të Shqipërisë	anëtar;
Përfaqësuesi i Fondit Shqiptar të Zhvillimit	anëtar.



SHTOJCË I

VLERA E BASHKËFINANCIMIT PËR ÇDO PROJEKT

Vlera e bashkëfinancimit për çdo projekt të jetë, si më poshtë vijon:

a) Për njësitë e qeverisjes vendore me popullsi nën 50 000 (pesëdhjetë mijë) banorë, vlera dysHEME e bashkëfinancimit nga ana e njësisë së qeverisjes vendore të jetë në masën 10% të vlerës së plotë të projektit, alokuar për vitin 2018 ose 2019 (nëse projekti zbatohet në dy vite). Edhe në rastet kur njësia e qeverisjes vendore ka nënshkruar marrëveshje partneriteti me Fondin Shqiptar të Zhvillimit, masa e bashkëfinancimit do të përballohet nga njësia e qeverisjes vendore.

b) Për njësitë e qeverisjes vendore me popullsi mbi 50 000 (pesëdhjetë mijë) banorë, vlera dysHEME e bashkëfinancimit nga ana e njësisë së qeverisjes vendore, të jetë në masën 30% të vlerës së plotë të projektit, nga të cilat të alokuara 15% për vitin 2018 dhe 15% për vitin 2019 (nëse projekti zbatohet në dy vite). Edhe në rastet kur

njësia e qeverisjes vendore lidh marrëveshje partneriteti me Fondin Shqiptar të Zhvillimit, masa e bashkëfinancimit do të përballohet nga njësia e qeverisjes vendore.

c) Për IAL-të, vlera dysHEME e bashkëfinancimit nga ana e IAL-ve, të jetë në masën 30% të vlerës së plotë të projekti, nga të cilat të alokuara 15% për vitin 2018 dhe 15% për vitin 2019 (nëse projekti zbatohet në dy vite).

Diferenca mes vlerës së projektit me vlerën e kontratës (nëse ka një të tillë pas prokurimit publik dhe mbas nënshkrimit të saj), do t'i zbritet financimit me burim grantin “Arsimi”, pjesë e buxhetit të Ministrisë së Arsimit, Sportit dhe Rinisë, Fondi për Zhvillimin e Rajoneve.

Shënim:

Ministria e Brendshme dërgon listën e njësive të qeverisjes vendore me mbi dhe nën 50.000 (pesëdhjetë mijë) banorë, pranë Sekretariatit Teknik në Ministrinë e Arsimit, Sportit dhe Rinisë.

SHTOJCË II

KALENDARI ME AFATET E APLIKIMIT DHE VLERËSIMIT TË PROJEKTEVE

Afati	Institucioni përgjegjës	Aktiviteti
Botimi në Fletoren Zyrtare	Komiteti për Zhvillimin e Rajoneve	Hapja e thirrjes për projekte të reja sipas drejtimeve të thirrjes së grantit, sipas pikës 1 të këtij vendimi.
12 ditë kalendarike nga botimi në Fletoren Zyrtare	Aplikuesit sipas pikës 3 të këtij vendimi	Dërgimi i aplikimeve nga aplikuesit, si më poshtë vijon: 1. Aplikimi <i>online</i> në faqen elektronike të <i>e-Albania</i> : Shërbimi. Aplikimi <i>online</i> për FZHR-në: https://e-albania.al/sherbimi.aspx?kodi=7203 ; ose 2. Aplikimi me shkresë zyrtare (postë ose protokollim dorazi), ku dosja e plotë e aplikimit (në CD) dërgohet pranë Sekretariatit Teknik në Ministrinë e Arsimit, Sportit dhe Rinisë. Pranë Sekretariatit të Përgjithshëm të Komitetit për Zhvillimin e Rajoneve (në Kryeministri), <u>nuk dorëzohen dosjet e aplikimit, por ato dorëzohen vetëm pranë Sekretariatit Teknik në ministri.</u>
5 ditë kalendarike nga mbyllja e aplikimit	Sekretariati teknik përkatës	Vlerësimi i projekteve të aplikuara sipas shtojcës III të këtij vendimi.
	Sekretariati teknik përkatës	Sekretariati teknik paraqet zyrtarisht pranë Sekretariatit të Përgjithshëm listën e projekteve që propozohen për financim, si dhe projektvendimin që i propozohet Komitetit për Zhvillimin e Rajoneve.



SHTOJCË III FORMATI I APLIKIMIT PËR PROJEKTET

Ky format plotësohet për të gjitha projektet.

Aplikuesi (*)	Përcaktohet automatikisht nga sistemi.
Data e aplikimit (*)	Përcaktohet automatikisht nga sistemi.
Titulli i projektit (*)	Titulli i projektit të jetë i njëjtë me titullin që specifikohet në kërkesën e depozituar pranë sekretariatit teknik.
Programi i projektit (*)	Të përcaktohet për cilën shtyllë aplikohet (sipas aneksit 3, të ligjit nr. 109/2017, “Për buxhetin e vitit 2018”).
Nënprogrami i projektit (*)	Të përcaktohet për cilin program aplikohet (sipas aneksit 3, të ligjit nr. 109/2017, “Për buxhetin e vitit 2018”).
Data e fillimit të projektit (*)	Të paraqitet grafiku i prokurimit dhe grafiku i zbatimit të punimeve të projektit, për të qartësuar shtrirjen kohore të tij.
Data e mbarimit të projektit (*)	
Përshkrimi i projektit (*)	Të bëhet përshkrim i detajuar i projektit të propozuar, duke përmblajtur informacionin e mëposhtëm, por jo vetëm: - Vendndodhja e objektit të investimit; specifikuar në hartë ku është sqaruar qartë kufiri i ndërhyrjes; - Përshkrimi i kushteve të objektit ekzistues (nëse ka) dhe terrenit, si dhe nevojës për këtë projekt; - Përshkrimi i detajuar i punimeve/i ndërhyrjeve që do të kryhen; - Grafiku i prokurimit dhe grafiku i zbatimit të punimeve; - Cilat janë problemet që adreson ky projekt dhe shkalla e ndikimit të tij; - Risqet për zbatimin e tij; - Informacion i qartë në lidhje me pronësinë e tokës (nëse aplikohet), si edhe dokumentacioni përkatës (harta përkatëse kadastrale etj.).
Qëllimi dhe objektivat (*)	Të paraqitet qëllimi i përgjithshëm i projektit, si dhe objektivat specifike të tij.
Numri i përfituesve (*)	Të jepet numri i popullsisë (nxënës/mësues/komunitet) që përfitojnë drejtpërdrejt dhe tërthorazi nga zbatimi i projektit. Vlera e dhënë të shoqërohet me shpjegim për secilën kategori përfituesish.
Sipërfaqe e trajtuar (*)	Të specifikohet sa është sipërfaqja e përgjithshme në të cilën ndërhyrja projektit dhe nëse zhvillohet me faza apo lote.
Rendi prioritar (*)	Në rastet e aplikimit të më shumë se 1 (një) projekti për të njëjtin program, renditini projektet sipas prioritetit/nevojës për ndërhyrje/lidhjes me drejtimit e thirrjes (numri 1 për shumë prioritar, numri 2 për më pak prioritar e kështu me radhë).
Qëndrueshmëria e projektit (*)	Të përshkruhet në mënyrë analitike nëse aplikuesi do të ketë nga ky projekt: - Kosto për mirëmbajtjen e projektit, pas zbatimit të tij; - Nëse po, specifikoni sa parashikohen, si do të sigurohen etj.; - Të specifikohet periudha në vite për kostot e mirëmbajtjes.
Fondet e kërkuara nga Fondi për Zhvillimin e Rajoneve (*)	Në rast se projekti nuk ka financim nga donatorë, kostoja/fondi që kërkohet është e barabartë me koston totale të projektit (në çdo rast, vlera të jetë me TVSH) minus vlerën dysheme të detyrueshme të bashkëfinancimit nga njësia e qeverisjes vendore/IAL, sipas shtojcës I të këtij vendimi.
Kontributi i detyrueshëm në bashkëfinancimin nga njësia e qeverisjes vendore (*)	Aplikuesi e shoqëron aplikimin me një shkresë zyrtare, të nënshkruar nga kryetari i bashkisë, drejtuesi i IAL-së, ku merr përsipër së paku vlerën dysheme të bashkëfinancimit, të përcaktuar në shtojcën I të këtij vendimi. Aplikuesi mund të bashkëfinancojë një vlerë me të madhe sesa vlera dysheme, nëse e shikon të mundur. Marrja përsipër e bashkëfinancimit nga aplikuesi, në, minimumi, vlerën dysheme të tij të përcaktuar në shtojcën I të këtij vendimi dhe paraqitja e shkresës që e konfirmon këtë është kusht detyrues për kalimin në fazën e vlerësimit të aplikimit dhe për (potencialisht) miratimin e financimit.



Financim nga donatorë (*)	Nëse ka financim nga donatorë, të jepet vlera e donacionit në monedhën lekë.
Financime të tjera	Nëse ka burime të tjera financimi, të jepet vlera e financimit në monedhën lekë.
Kostoja totale e projektit (*)	Kostoja totale e projektit të jepet me TVSH.
Projekti ka një analizë kosto-përfitim të cilësisë së mirë (opsionale)	☐ Po / ☐ Jo
Përmbledhje e analizës kosto-përfitim	Të paraqitet një përmbledhje e shkurtër e analizës kosto-përfitim, nëse ka një të tillë.
Projekti ka një vlerësim të ndikimit në mjedis të cilësisë së mirë (opsionale)	☐ Po / ☐ Jo
Përmbledhje e vlerësimit të ndikimit në mjedis	Të paraqitet një përmbledhje e shkurtër e vlerësimit të ndikimit në mjedis, nëse ka një të tillë.
Deklarime (*)	Aplikuesi deklaron se: i) Projekti është gati për zbatim (pra, nëse i disponon të gjitha dokumentet që nevojiten për zbatimin e tij) dhe koha kur mund të fillojë dhe të përfundojë procedura e prokurimit publik dhe kur mund të fillojë dhe të përfundojë zbatimin i punimeve. ii) Projekti është në listën e projekteve/e nevojave të parashikuara nga institucioni përkatës, është pjesë e planeve vendore të zhvillimit dhe/ose të prioritetëve. iii) Me miratimin e financimit, autoriteti kontraktues ka siguruar për pajisjen me të gjitha lejet e nevojshme për zbatimin e projektit, sipas legjislacionit të fuqi. iv) Janë zbatuar çmimet e referencës dhe legjislacioni në fuqi për përlogaritjen e koston dhe të vlerës financiare të projektit.
Dokumentet teknike (*)	Të sqarohet nëse dosja e aplikimit përmban: - Projektin teknik/projektin e zbatimit; - Preventivin; - Grafikun e prokurimit dhe grafikun e zbatimit të punimeve; - Relacionin teknik; - Specifikimet teknike; - CD; - Përlogaritjet/parashikimin e kostove të mirëmbajtjes së investimit.
Koordinatat e projektit (*)	Të hidhen koordinatat e vendndodhjes së projektit, sipas sistemit të gjeoreferencuar, WGS 84 UTM 34 N.
Foto - Gjendja ekzistuese (*)	Imazhe në formatin <i>jpeg</i> ose <i>pdf</i>
Pamje 3-dimensionale (*) i detyrueshëm	Imazhe në formatin <i>jpeg</i> ose <i>pdf</i>

(*) Fushat që kanë * janë të detyrueshme për t'u plotësuar.

Shënim. Dërgimi i aplikimeve, sipas afatit.

1. Aplikimet për projekte duhet të dërgohen:

a) Aplikimi *online* në faqen elektronike të *e-Albania*. Shërbimi. Aplikimi *online* për FZHR-në (<https://e-albania.al/sherbimi.aspx?kodi=7203>); ose

b) Me shkresë zyrtare (postë ose protokollim dorazi), së bashku me dosjen e plotë të aplikimit të hedhur në CD, pranë Sekretariatit Teknik në Ministrinë e Arsimit, Sportit dhe Rinisë.

2. Format i aplikimit duhet të dorëzohet i firmosur dhe i vulosur nga institucioni/subjekti aplikues.

3. Dokumentacioni teknik i dorëzuar duhet të jetë detyrueshëm i firmosur dhe i vulosur nga autorët përkatës.



SHTOJCA IV
KRITERET E VLERËSIMIT TË
PROJEKTEVE QË PROPOZOHEN PËR
FINANCIM

Këto kritere përdoren nga Sekretariati Teknik për të vlerësuar teknikisht projektin dhe në bazë të tyre kryhet vlerësimi, maksimalisht, me 100 pikë, i një projekti që propozohet për financim/miratim nga Komitetit për Zhvillimin e Rajoneve.

Kriteret detajohen në nënkriteret përkatëse, nga Sekretariati Teknik i ngritur pranë Ministrisë së Arsimit, Sportit dhe Rinisë, sipas aneksit 3, të ligjit nr. 109/2017, “Për buxhetin e vitit 2018”.

Kriteret e domosdoshme për të kualifikuar për vlerësim një projekt, i përcakton Sekretariati Teknik.

Kriteret për vlerësimin e projekteve janë si më poshtë vijon:

1. Shkalla e ndikimit në arritjen e objektivave të politikës dhe impakti në realizimin e masave, sipas drejtimeve të thirrjes dhe vendimeve të Komitetit për Zhvillimin e Rajoneve: Ky kriter vlerësohet me **0 deri në, maksimalisht, 20 pikë**.

2. Cilësia teknike dhe kostimi, vlerësimi financiar i projekteve të propozuara nga njësitë e qeverisjes vendore. Ky kriter nënkupton se projektet që teknikisht janë detajuar saktë dhe qartë me grafik punimesh të detajuar, si dhe ato projekte, ku kostimi i tyre dhe preventivi janë përpiluar e vlerësuar saktë nga aplikanti, me çmimet referencë sipas buletineve etj., do të vlerësohen si koherente për financim: Ky kriter vlerësohet me **0 deri në, maksimalisht, 25 pikë**.

3. Ndikimi i projekteve dhe i avantazhet në lehtësimin e aksesit në shërbimet arsimore, ndërveprimin midis zonave urbane e rurale duke rritur mbulimin në shërbime, zgjidhjen e nevojës emergjente për ndërhyrje, përmirësimin të cilësisë së shërbimit dhe jetës komunitare dhe më gjerë, zhvillimin ekonomiko-social, parë nga ana e përfituesit, qytetarit: Ky kriter vlerësohet me **0 deri në, maksimalisht, 25 pikë**.

4. Niveli i ulët i riskut për zbatimin e projektit, bazuar në elemente të përshkrimit të projektit që orientojnë mbi riskun e mundshëm në prokurimin publik, zbatimin me sukses të

projektit dhe përdorimin në kohë të fondeve publike: Ky kriter vlerësohet me **0 deri në, maksimalisht, 10 pikë**.

5. Numri i përfituesve në mënyrë të drejtpërdrejtë dhe/ose të tërthortë (nxënës/mësues/komunitet) nga projekti ose zona kryesore dhe dytësore e ndikimit/mbulimit të shërbimit prej tij. Vlerësimi sipas këtij kriteri kryhet në varësi të numrit të institucioneve/përdoruesve/shërbimeve që përfitojnë në mënyrë të drejtpërdrejtë dhe/ose të tërthortë: Ky kriter vlerësohet me **0 deri në, maksimalisht, 10 pikë**.

6. Niveli i bashkëfinancimit suplementarisht/përmbi vlerën dysHEME (minimale) të bashkëfinancimit, me fonde të tjera nga njësitë e qeverisjes vendore, IAL-të apo me fondet e donatorëve: Ky kriter vlerësohet me **0 deri në, maksimalisht, 10 pikë**.

Shënim

Nëse aplikuesi nuk merr përsipër vlerën dysHEME të bashkëfinancimit të përcaktuar sipas shtojcës I të këtij vendimi, atëherë aplikimi nuk kalon në fazën e vlerësimit.

VENDIM

Nr. 31, datë 4.4.2018

**PËR MIRATIMIN E RREGULLORES
“PËR PLANET E NDËRHJRJES SË
JASHTËZAKONSHME”**

Në bazë dhe për zbatim të nenit 12, shkronja “a”, dhe të nenit 43, shkronja “c”, të ligjit nr. 8269, datë 23.12.1997, “Për Bankën e Shqipërisë”, të ndryshuar, si dhe të nenit 12, pikat 1 dhe 9, nenit 13, nenit 15 dhe nenit 87 të ligjit nr. 133/2016, datë 22.12.2016, “Për rimëkëmbjen dhe ndërhyrjen e jashtëzakonshme në banka në Republikën e Shqipërisë”, me propozim të Departamentit për Ndërhyrjen e Jashtëzakonshme, Këshilli Mbikëqyrës i Bankës së Shqipërisë

VENDOSI:

1. Të miratojë rregulloren “Për planet e ndërhyrjes së jashtëzakonshme”, sipas tekstit bashkëlidhur këtij vendimi.

2. Ngarkohet Departamenti për Ndërhyrjen e Jashtëzakonshme në Bankën e Shqipërisë për ndjekjen e zbatimit të këtij vendimi.



3. Ngarkohet Kabineti i Guvernatorit dhe Departamenti i Kërkimeve me publikimin e këtij vendimi, përkatësisht në Fletoren Zyrtare të Republikës së Shqipërisë dhe në Buletinin Zyrtar të Bankës së Shqipërisë.

Ky vendim hyn në fuqi 15 (pesëmbëdhjetë) ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare të Republikës së Shqipërisë.

**KRYETARI
Gent Sejko**

KREU I TË PËRGJITHSHME

Neni 1 Objekti

Objekti i kësaj rregulloreje është të përcaktojë:

- a) përmbajtjen e planeve të ndërhyrjes së jashtëzakonshme;
- b) procedurat për hartimin e planeve të ndërhyrjes së jashtëzakonshme;
- c) procesin për vlerësimin e aftësisë për ndërhyrje të jashtëzakonshme.

Neni 2 Subjektet

Subjekte të kësaj rregulloreje janë bankat dhe degët e bankave të huaja, të licencuara nga Banka e Shqipërisë.

Neni 3 Baza juridike

Kjo rregullore nxirret në bazë dhe për zbatim të:

- a) nenit 12, shkronja “a” dhe nenit 43, shkronja “c” të ligjit nr. 8269, datë 23.12.1997, “Për Bankën e Shqipërisë”, të ndryshuar;
- b) nenit 12, pikat 1 dhe 9, nenit 13, nenit 15 dhe nenit 87 të ligjit nr. 133, datë 22.12.2016, “Për rimëkëmbjen dhe ndërhyrjen e jashtëzakonshme në banka, në Republikën e Shqipërisë” (më poshtë ligji “Për rimëkëmbjen dhe ndërhyrjen e jashtëzakonshme në banka”).

Neni 4 Përkufizime

1. Termat e përdorur në këtë rregullore kanë të njëjtin kuptim me termat e përkufizuar në nenin 4 të ligjit “Për bankat në Republikën e Shqipërisë”, në nenin 4 të ligjit “Për rimëkëmbjen dhe ndërhyrjen e jashtëzakonshme

në banka”, si dhe në nenin 4 të rregullores nr. 72, datë 6.12.2017, “Për planet e rimëkëmbjes së bankave”.

2. Përveç sa parashikohet në pikën 1 të këtij neni, për qëllim të zbatimit të kësaj rregulloreje, termat e mëposhtëm kanë këtë kuptim:

a) Strategji e ndërhyrjes së jashtëzakonshme është tërësia e veprimeve të ndërhyrjes së jashtëzakonshme të parashikuara në planin e ndërhyrjes së jashtëzakonshme;

b) Strategji e preferuar është strategjia e ndërhyrjes së jashtëzakonshme që mundëson në shkallën më të lartë të mundshme përmbushjen e objektivave të ndërhyrjes së jashtëzakonshme të përcaktuar në nenin 20 të ligjit “Për rimëkëmbjen dhe ndërhyrjen e jashtëzakonshme në banka”.

Neni 5 Kërkesa të përgjithshme

1. Autoriteti i Ndërhyrjes së Jashtëzakonshme harton planin e ndërhyrjes së jashtëzakonshme për çdo bankë dhe grup bankar, sipas dispozitave të kësaj rregulloreje.

2. Plani për ndërhyrjen e jashtëzakonshme parashikon veprimet e ndërhyrjes së jashtëzakonshme që ndërmerr Autoriteti i Ndërhyrjes së Jashtëzakonshme kur plotësohen kushtet për ndërhyrje të jashtëzakonshme.

KREU II PËRMBAJTJA E PLANIT TË NDËRHYRJES SË JASHTËZAKONSHME

Neni 6 Struktura e planit të ndërhyrjes së jashtëzakonshme

Plani i ndërhyrjes së jashtëzakonshme përmban të paktën elementet e mëposhtme:

- a) përmbledhjen ekzekutive të planit sipas nenit 7 të kësaj rregulloreje;
- b) analizën strategjike të bankës në përputhje me nenin 8 të kësaj rregulloreje;
- c) përshkrim të strategjisë së ndërhyrjes së jashtëzakonshme, sipas nenit 9 të kësaj rregulloreje;
- d) përshkrim të kërkesës minimale për instrumentet e kapitalit rregullator dhe detyrimet e pranuar, sipas nenit 10 të kësaj rregulloreje;
- e) kërkesën për financim dhe burimet e financimit për zbatimin e strategjisë së ndërhyrjes së jashtëzakonshme të parashikuar në plan, sipas nenit 11 të kësaj rregulloreje;



f) marrëveshjet për sigurimin e vazhdimësisë operacionale të funksioneve me rëndësi kritike gjatë ndërhyrjes së jashtëzakonshme, sipas nenit 12 të kësaj rregulloreje;

g) përshkrim të informacionit dhe marrëveshjeve të nevojshme për sigurimin e tij, për përzgjedhjen dhe zbatimin efektiv të strategjisë së ndërhyrjes së jashtëzakonshme, sipas nenit 13 të kësaj rregulloreje;

h) planin e komunikimit me grupet e interesit, sipas nenit 14 të kësaj rregulloreje;

i) përfundimet e vlerësimit të aftësisë për ndërhyrje të jashtëzakonshme ose të likuidimit të detyruar, sipas nenit 15 të kësaj rregulloreje;

j) opinionin e bankës mbi planin periodik të ndërhyrjes së jashtëzakonshme, sipas nenit 16 të kësaj rregulloreje.

Neni 7

Përmbledhja ekzekutive në planin e ndërhyrjes së jashtëzakonshme

1. Përmbledhja ekzekutive në planin e ndërhyrjes së jashtëzakonshme përfshin përshkrimin e bankës ose të grupit bankar dhe një përmbledhje të elementeve të parashikuara nga shkronja (b) deri në shkronjën (i), të nenit 6 të kësaj rregulloreje.

2. Kjo përmbledhje përmban, gjithashtu, edhe një përshkrim të çdo ndryshimi të rëndësishëm që ka ndodhur në bankë ose në grupin bankar që nga hera e fundit e hartimit të planit të ndërhyrjes së jashtëzakonshme.

Neni 8

Analiza strategjike

1. Analiza strategjike në planin e ndërhyrjes së jashtëzakonshme përfshin një përshkrim dhe përmbledhje të:

a) strukturës së bankës/grupit bankar, të pronësisë dhe të qeverisjes;

b) aktiveve, kapitalit, të ardhurave dhe strukturës së rreziqeve;

c) modelit të biznesit të bankës dhe linjave të biznesit;

d) funksioneve kritike, veprimtarive kryesore dhe shpërndarjes së tyre ndërmjet subjekteve të rëndësishme;

e) ndërvlerësive të brendshme dhe të jashtme, duke përfshirë ato ligjore, financiare dhe operacionale;

f) sistemeve kritike dhe infrastrukturës.

Neni 9

Strategjia e ndërhyrjes së jashtëzakonshme

1. Strategjia e ndërhyrjes së jashtëzakonshme përmban një përshkrim të vlerësimit nëse likuidimi i detyruar është i besueshëm dhe i zbatueshëm, të kryer sipas nenit 18 të kësaj rregulloreje. Nëse procedura e likuidimit të detyruar është e besueshme dhe e zbatueshme, strategjia e preferuar është likuidimi i detyruar.

2. Nëse procedura e likuidimit të detyruar nuk është e besueshme dhe e zbatueshme, strategjia e ndërhyrjes së jashtëzakonshme përmban elementet në vijim:

a) identifikimin e strategjisë së preferuar dhe të instrumenteve përkatëse, sipas nenit 17, pika 2, të kësaj rregulloreje;

b) identifikimin e funksioneve me rëndësi kritike dhe veprimtarive kryesore të bankës, përfshirë veçimin e funksioneve me rëndësi kritike dhe veprimtarive kryesore të bankës për të cilat do të sigurohet vazhdimësia e tyre, nga funksionet dhe veprimtaritë e tjera të bankës;

c) vlerësimin e afateve kohore për ekzekutimin e çdo veprimi me rëndësi të planit të ndërhyrjes së jashtëzakonshme;

d) përshkrim të secilit variant të strategjisë së preferuar të ndërhyrjes së jashtëzakonshme, duke identifikuar dhe adresuar rrethanat, në të cilat strategjia e preferuar nuk mund të zbatohet;

e) përshkrim të procesit të vendimmarrjes, duke përfshirë identifikimin e organeve vendimmarrëse të zbatimit të strategjisë së ndërhyrjes së jashtëzakonshme, së bashku me afatet e nevojshme kohore për marrjen e vendimeve.

f) për grupin bankar, marrëveshjet e bashkëpunimit dhe koordinimit midis Autoritetit të Ndërhyrjes së Jashtëzakonshme dhe autoriteteve kompetente të ndërhyrjes së jashtëzakonshme të një shteti tjetër ose me organizata ndërkombëtare, të cilat janë përgjegjëse për ndërhyrjen e jashtëzakonshme ndaj një institucioni që është pjesë e një grupi bankar, që vepron në Republikën e Shqipërisë ose anasjelltas, në përputhje me procedurat dhe marrëveshjet e shkruara, të parashikuara në nenin 70 të ligjit “Për rimëkëmbjen dhe ndërhyrjen e jashtëzakonshme në banka”.



Neni 10

Kërkesa minimale për instrumentet e kapitalit dhe detyrimeve të pranuar

Plani për ndërhyrjen e jashtëzakonshme përmban një përshkrim të kërkesës për nivelin minimal të instrumenteve të kapitalit rregullator dhe detyrimeve të pranuar, sipas pikës 1, të nenit 32, të ligjit “Për rimëkëmbjen dhe ndërhyrjen e jashtëzakonshme në banka”.

Neni 11

Kërkesat për financim dhe burimet e financimit për zbatimin e strategjisë së ndërhyrjes së jashtëzakonshme

Plani i ndërhyrjes së jashtëzakonshme përmban një përshkrim të shkurtër të kërkesës për financim për zbatimin e strategjisë së ndërhyrjes së jashtëzakonshme, të modelit të financimit të bankës dhe të planit të kontigjencës për likuiditet, sipas elementeve në vijim:

a) përshkrimin e kërkesës për financim, për fonde dhe për likuiditet, që parashikohet në strategjinë e ndërhyrjes së jashtëzakonshme;

b) përshkrimin e burimeve të mundshme të financimit të ndërhyrjes së jashtëzakonshme, duke përfshirë termat/kushtet e financimit, kriteret për përdorimin e tij, kohën në të cilën është i disponueshëm, subjektet nga të cilat mund të përfitohet financim, si dhe kërkesat përkatëse për kolateral;

c) aty ku është e përshtatshme, një përshkrim dhe analizë të procesit se si dhe kur banka mund të aplikojë për përdorimin e instrumenteve financiare të Bankës së Shqipërisë, në kushtet e trajtuara në planin e ndërhyrjes së jashtëzakonshme, duke përfshirë edhe identifikimin e kolateralit përkatës;

d) për grupet bankare, një përshkrim të parimeve të miratuara për ndarjen e përgjegjësisë së financimit ndërmjet burimeve të financimit në juridiksione të ndryshme.

Neni 12

Marrëveshjet për sigurimin e vazhdimësisë operacionale

Plani i ndërhyrjes së jashtëzakonshme përmban një përshkrim të marrëveshjeve për sigurimin e vazhdimësisë operacionale të funksioneve me rëndësi kritike gjatë ndërhyrjes së jashtëzakonshme në bankë. Ky përshkrim përfshin:

a) sistemet dhe operacionet kritike të përbashkëta, të cilat janë të nevojshme për ruajtjen e vazhdimësisë së funksioneve me rëndësi kritike, si dhe të marrëveshjeve përkatëse për sigurimin e vazhdimësisë kontraktuale dhe operacionale të tyre gjatë zbatimit të ndërhyrjes së jashtëzakonshme;

b) marrëveshjet për sigurimin e përdorimit të sistemeve të pagesave ose infrastrukturës së tregjeve financiare, të nevojshme për ruajtjen e vazhdimësisë së funksioneve me rëndësi kritike, përfshirë një vlerësim mbi sigurinë e të dhënave të sistemit të klerimit dhe mundësinë e transferimit të aktiveve dhe pozicioneve të klientëve në anëtarë të tjerë të sistemit.

Neni 13

Informacioni dhe marrëveshjet për ofrimin e tij

Plani i ndërhyrjes së jashtëzakonshme përmban një përshkrim të informacionit dhe marrëveshjeve për sigurimin e këtij informacioni, të nevojshme për përzgjedhjen dhe zbatimin efektiv të strategjisë së ndërhyrjes së jashtëzakonshme, duke përfshirë:

a) informacionin dhe proceset për marrjen në kohë të informacionit që nevojitet për vlerësimin për qëllime të ndërhyrjes së jashtëzakonshme në zbatim të nenit 24 dhe nenit 36 të ligjit “Për rimëkëmbjen dhe ndërhyrjen e jashtëzakonshme në banka”, si dhe për marketingun e të drejtave, detyrimeve, aksioneve ose instrumenteve të tjera të pronësisë së bankës, në rastin e instrumentit të shitjes së aktivitetit tregtar dhe instrumentit të bankës urë;

b) marrëveshjet për shkëmbimin e informacionit midis Autoritetit të Ndërhyrjes së Jashtëzakonshme me autoritete kompetente të ndërhyrjes së jashtëzakonshme të një shteti tjetër ose me organizata ndërkombëtare, të cilat janë përgjegjëse për ndërhyrjen e jashtëzakonshme ndaj një institucioni që është pjesë e një grupi bankar, që vepron në Republikën e Shqipërisë ose anasjelltas, sipas nenit 70 të ligjit “Për rimëkëmbjen dhe ndërhyrjen e jashtëzakonshme në banka”;

c) marrëveshjet për të siguruar që informacioni i kërkuar në zbatim të neneve 12 dhe 13 të ligjit “Për rimëkëmbjen dhe ndërhyrjen e jashtëzakonshme në banka” të sigurohet i përditësuar në kohën që kërkohet.



Neni 14

Plani i komunikimit

1. Plani i komunikimit për ndërhyrjen e jashtëzakonshme përfshin komunikimin me:

a) drejtuesit ekzekutivë, pronarët (aksionerët) dhe personelin e bankës, duke përfshirë procedurat për konsultimin me personelin dhe, sipas rastit, dialogun me partnerët socialë, të tillë si organizatat përfaqësuese të punëdhënësve dhe punonjësve, sindikatat dhe një vlerësim të ndikimit të planit mbi punonjësit;

b) klientët, median dhe publikun e gjerë;

c) depozituesit, zotëruesit e obligacioneve, kundërpalët, infrastrukturën e tregut financiar dhe pjesëmarrësit e tjerë të ndikuar të tregut;

d) çdo organ administrativ ose gjyqësor nga i cili kërkohet miratim ose autorizim për zbatimin e strategjisë së ndërhyrjes së jashtëzakonshme;

e) çdo këshilltar që kërkohet për zbatimin e strategjisë së ndërhyrjes së jashtëzakonshme.

2. Mënyra e komunikimit dhe përmbajtja e informacionit që komunikohet do të reflektojë rëndësinë që ka secili nga grupet e interesit për procesin e ndërhyrjes së jashtëzakonshme.

Neni 15

Përfundimet e vlerësimit të aftësisë për ndërhyrje të jashtëzakonshme

1. Plani i ndërhyrjes së jashtëzakonshme përmban përfundimet e vlerësimit të aftësisë për ndërhyrje të jashtëzakonshme dhe përfshin:

a) përshkrim të vlerësimit të aftësisë për ndërhyrje të jashtëzakonshme në kushtet aktuale, të kryer sipas nenit 17 të kësaj rregulloreje;

b) përmbledhje të vlerësimit nëse banka duhet t'i nënshtrohet procedurës së likuidimit të detyruar, të kryer sipas nenit 18 të kësaj rregulloreje;

c) përshkrim të çdo pengese të identifikuar ndaj aftësisë për ndërhyrje të jashtëzakonshme dhe masat e propozuara nga banka ose të kërkuara nga Autoriteti për Ndërhyrjen e Jashtëzakonshme për trajtimin ose heqjen e këtyre pengesave;

d) vlerësim sasior të çdo ndryshimi në nivelin minimal të instrumenteve të kapitalit rregullator dhe detyrimeve të pranuar ose evidentimin e saktë të detyrimeve të pranuar që kërkohen për trajtimin ose heqjen e pengesave për ndërhyrje të jashtëzakonshme, duke marrë parasysh kriteret e përcaktuara në aktet nënligjore të miratuara në

zbatim të pikës 5, të nenit 32, të ligjit “Për rimëkëmbjen dhe ndërhyrjen e jashtëzakonshme në banka”.

2. Për bankat, për të cilat Autoriteti për Ndërhyrjen e Jashtëzakonshme vlerëson se likuidimi i detyruar është i besueshëm dhe i zbatueshëm, plani i ndërhyrjes së jashtëzakonshme përmban përmbledhjen për këtë vlerësim. Për bankat e tjera, plani i ndërhyrjes së jashtëzakonshme përmban të gjitha elementet e specifikuar në nenin 6 të kësaj rregulloreje.

Neni 16

Opinionin mbi planin e ndërhyrjes së jashtëzakonshme

1. Plani i ndërhyrjes së jashtëzakonshme përmban opinionin e shprehur nga banka në lidhje me planin periodik të ndërhyrjes së jashtëzakonshme. Autoriteti i Ndërhyrjes së Jashtëzakonshme dërgon zyrtarisht një përmbledhje të elementeve kryesore të planit përkatës së ndërhyrjes së jashtëzakonshme pranë secilës bankë.

2. Banka dërgon opinionin e saj mbi planin e ndërhyrjes së jashtëzakonshme, jo më vonë se 30 ditë nga marrja e përmbledhjes së planit nga Autoriteti i Ndërhyrjes së Jashtëzakonshme.

KREU III

VLERËSIMI I AFTËSISË PËR NDËRHYRJE TË JASHTËZAKONSHME

Neni 17

Fazat e vlerësimit

1. Autoriteti i Ndërhyrjes së Jashtëzakonshme vlerëson aftësinë për ndërhyrje të jashtëzakonshme, sipas fazave të mëposhtme:

a) së pari, kryhet vlerësimi i besueshmërisë dhe zbatueshmërisë së likuidimit të detyruar të bankës, në përputhje me nenin 18 të kësaj rregulloreje;

b) së dyti, bëhet përzgjedhja e strategjisë së preferuar për ndërhyrje të jashtëzakonshme, në përputhje me nenin 19 të kësaj rregulloreje;

c) së treti, kryhet vlerësimi i besueshmërisë së strategjisë së preferuar për ndërhyrjen e jashtëzakonshme, në përputhje me nenin 20 të kësaj rregulloreje;

d) së katërti, kryhet vlerësimi i zbatueshmërisë së strategjisë së preferuar për ndërhyrjen e jashtëzakonshme në përputhje me nenin 21 deri në 26 të kësaj rregulloreje.



2. Nëse Autoriteti i Ndërhijres së Jashtëzakonshme arrin në përfundimin se likuidimi i detyruar i bankës nuk është besueshëm dhe i zbatueshëm dhe se vendosja e bankës në ndërhijrje të jashtëzakonshme është në interesin publik, ai identifikon strategjinë e preferuar për ndërhijrje të jashtëzakonshme që është e përshtatshme për bankën, në bazë të informacionit të dërguar nga banka, sipas pikës 5, të nenit 12, të ligjit “Për rimëkëmbjen dhe ndërhijrjen e jashtëzakonshme në banka” dhe kriterëve të përcaktuara në këtë rregullore. Në rast se është e nevojshme, Autoriteti i Ndërhijres së Jashtëzakonshme identifikon strategjitë alternative për të adresuar rrethanat në të cilat strategjia e preferuar nuk është e besueshme dhe e zbatueshme.

3. Vlerësimi i besueshmërisë dhe zbatueshmërisë së strategjisë së preferuar të ndërhijres së jashtëzakonshme përfshin dhe vlerësimin e strategjive alternative të propozuara si pjesë të saj.

4. Për vlerësimin e strategjisë së preferuar dhe strategjive alternative, Autoriteti i Ndërhijres së Jashtëzakonshme kërkon nga banka informacion shtesë në përputhje me nenin 12 të ligjit “Për rimëkëmbjen dhe ndërhijrjen e jashtëzakonshme në banka”. Aty ku është e përshtatshme, Autoriteti i Ndërhijres së Jashtëzakonshme rishikon strategjinë e preferuar ose konsideron strategji alternative në bazë të vlerësimit të plotë të besueshmërisë dhe zbatueshmërisë së strategjisë së preferuar, sipas pikës 2 të këtij neni.

5. Nëse Autoriteti i Ndërhijres së Jashtëzakonshme rishikon strategjinë e preferuar të ndërhijres së jashtëzakonshme, vlerëson besueshmërinë dhe zbatueshmërinë e strategjisë së rishikuar, përkatësisht sipas neneve 20 dhe 21 të kësaj rregulloreje.

Neni 18

Besueshmëria dhe zbatueshmëria e likuidimit të detyruar

1. Autoriteti i Ndërhijres së Jashtëzakonshme vlerëson besueshmërinë dhe zbatueshmërinë e likuidimit të detyruar të bankës, duke konsideruar nëse likuidimi i detyruar përmbush në të njëjtën shkallë objektivat e ndërhijres së jashtëzakonshme, si ndërhijrja e jashtëzakonshme.

2. Në vlerësimin e besueshmërisë së likuidimit të detyruar, Autoriteti i Ndërhijres së Jashtëzakonshme konsideron ndikimin e

mundshëm që mund të ketë likuidimi i detyruar i bankës në sistemin financiar, me synimin e ruajtjes së vazhdimësisë operationale të funksioneve me rëndësi kritike dhe përmbushjen e objektivave të ndërhijres së jashtëzakonshme sipas nenit 20 ligjit “Për rimëkëmbjen dhe ndërhijrjen e jashtëzakonshme në banka”. Për këtë qëllim, Autoriteti i Ndërhijres së Jashtëzakonshme mban në vëmendje funksionet e kryera nga banka dhe vlerëson nëse likuidimi ka efekt negativ në:

a) ekonominë reale dhe në veçanti funksionet kritike;

b) funksionimin e tregjeve financiare, infrastrukturën e tyre, si dhe, në veçanti, efektin zinxhir të drejtpërdrejtë dhe të tërthortë ndaj institucioneve të tjera financiare;

c) mbrojtjen e fondeve publike, fondeve të klientëve të bankës dhe aktiveve të klientëve të bankës.

3. Nëse Autoriteti i Ndërhijres së Jashtëzakonshme arrin në përfundimin se likuidimi i detyruar është i besueshëm, ai duhet të vlerësojë zbatueshmërinë e tij.

4. Për vlerësimin e zbatueshmërisë së likuidimit të detyruar, Autoriteti i Ndërhijres së Jashtëzakonshme vlerëson nëse sistemet e bankës mund të ofrojnë informacionin e kërkuar nga skema e sigurimit të depozitave me qëllim kryerjen e pagesave për depozitat e siguruar, në sasinë dhe afatet e përcaktuara në ligjin “Për rimëkëmbjen dhe ndërhijrjen e jashtëzakonshme në banka” dhe në ligjin nr. 53/2014, “Për sigurimin e depozitave”, të ndryshuar. Autoriteti i Ndërhijres së Jashtëzakonshme, gjithashtu, vlerëson nëse banka ka kapacitetin e nevojshëm për mbështetjen e veprimeve të skemës së sigurimit të depozitave, veçanërisht për veçimin e depozitave të siguruar nga ato të pasiguruar.

Neni 19

Identifikimi i strategjisë së ndërhijres së jashtëzakonshme

1. Në rastet kur në përputhje me pikën 4 të nenit 21 dhe nenin 65 ligjit “Për rimëkëmbjen dhe ndërhijrjen e jashtëzakonshme në banka”, ndërmarrja e veprimit për ndërhijrjen e jashtëzakonshme argumentohet me përmbushjen e interesit publik, Autoriteti i Ndërhijres së Jashtëzakonshme identifikon strategjinë e përshtatshme dhe instrumentet përkatëse për



përbushjen e objektivave të ndërhyrjes së jashtëzakonshme, duke marrë në konsideratë strukturën dhe modelin e biznesit të bankës.

2. Veprimi i ndërhyrjes së jashtëzakonshme ndërmerret në interes publik nëse ai është i domosdoshëm për përbushjen në mënyrë proporcionale të një ose më shumë objektivave të ndërhyrjes së jashtëzakonshme dhe kur likuidimi i detyruar i bankës nuk mund t'i përbushë në të njëjtën shkallë këta objektiva.

Neni 20

Vlerësimi i besueshmërisë së strategjisë së ndërhyrjes së jashtëzakonshme

1. Autoriteti i Ndërhyrjes së Jashtëzakonshme vlerëson besueshmërinë e strategjisë së ndërhyrjes së jashtëzakonshme duke marrë në konsideratë ndikimin që ka ndërhyrja e jashtëzakonshme në sistemin financiar dhe ekonominë reale, për sigurimin e vazhdimësisë së funksioneve me rëndësi kritike të bankës.

2. Për kryerjen e këtij vlerësimi, Autoriteti i Ndërhyrjes së Jashtëzakonshme konsideron çështjet e adresuara në pikën 20 deri 27 të aneksit 1.

Neni 21

Vlerësimi i zbatueshmërisë së strategjisë së ndërhyrjes së jashtëzakonshme

1. Autoriteti i Ndërhyrjes së Jashtëzakonshme vlerëson nëse strategjia e përzgjedhur e ndërhyrjes së jashtëzakonshme është efektive dhe zbatueshme në një afat kohor të përshtatshëm, si dhe identifikon pengesat e mundshme për zbatimin e saj.

2. Autoriteti i Ndërhyrjes së Jashtëzakonshme mban në vëmendje pengesat për rivendosjen e qëndrueshmërisë financiare të bankës në periudhën afatshkurtër. Gjithashtu, Autoriteti i Ndërhyrjes së Jashtëzakonshme konsideron pengesat e mundshme ndaj planit për riorganizimin e aktivitetit tregtar të bankës, në zbatim të nenit 39 të ligjit “Për rimëkëmbjen dhe ndërhyrjen e jashtëzakonshme në banka”, ose ato masa që mund të kërkojnë në rast se strategjia e ndërhyrjes së jashtëzakonshme parashikon rivendosjen e qëndrueshmërisë afatgjatë të bankës ose të një pjese të saj.

3. Autoriteti i Ndërhyrjes së Jashtëzakonshme identifikon pengesat e mundshme për zbatimin e strategjisë së ndërhyrjes së jashtëzakonshme për kategoritë e mëposhtme:

- a) struktura dhe operacionet;
- b) burimet financiare;
- c) informacioni;
- d) çështjet ndërkufitare;
- e) çështjet ligjore.

Neni 22

Vlerësimi i zbatueshmërisë: struktura dhe operacionet

Kur Autoriteti i Ndërhyrjes së Jashtëzakonshme vlerëson nëse ka pengesa potenciale për ndërhyrjen e jashtëzakonshme lidhur me strukturën dhe operacionet e bankës, konsideron:

a) çështjet e adresuara në pikat 1 deri në 7, pikat 16 dhe 18 të aneksit 1.

b) varësinë që kanë subjektet e rëndësishme dhe veprimtaritë kryesore ndaj infrastrukturës, teknologjisë së informacionit, funksioneve të financës apo thesarit, punonjësve apo shërbimeve të tjera të përbashkëta me rëndësi kritike;

c) nëse qeverisja/administrimi, kontrolli dhe marrëveshjet për menaxhimin e rrezikut janë në përputhje me ndryshimet e planifikuara në strukturën e bankës;

d) nëse struktura ligjore dhe e franshizës së bankës është në përputhje me ndryshimet e planifikuara në strukturën e biznesit të bankës;

e) nëse ekzistojnë instrumente të përshtatshme të ndërhyrjes së jashtëzakonshme për çdo subjekt të grupit bankar, me qëllim zbatimin e strategjisë së ndërhyrjes së jashtëzakonshme.

Neni 23

Vlerësimi i zbatueshmërisë: burimet financiare

Kur Autoriteti i Ndërhyrjes së Jashtëzakonshme vlerëson nëse ka pengesa potenciale për ndërhyrjen e jashtëzakonshme lidhur me burimet financiare, konsideron:

a) çështjet e adresuara në pikat 13, 14, 15 dhe 17 të aneksit 1;

b) identifikimin sasiar të detyrimeve, të cilat sipas strategjisë së preferuar për ndërhyrjen e jashtëzakonshme nuk kontribuojnë në përthithjen e humbjeve dhe rikapitalizimin e bankës, duke mbajtur në konsideratë minimalisht faktorët e mëposhtëm:

- i) afatin e maturimit;
- ii) radhitjen sipas hierarkisë së instrumenteve;
- iii) llojin e mbajtësve të instrumentit ose transferueshmërinë e instrumentit;



iv) pengesat ligjore për përthithjen e humbjeve, të tilla si mosnjohja e instrumenteve të ndërhyrjes së jashtëzakonshme sipas legjislacionit të huaj apo ekzistenca e të drejtës së kompensimit;

v) faktorë të tjerë që krijojnë rrezik që detyrimet të përjashtohen nga përthithja e humbjeve gjatë ndërhyrjes së jashtëzakonshme;

vi) personat juridikë që emetojnë detyrime të pranuar apo detyrime të tjera dhe vlera e këtyre emetimeve, të cilat do të përdoren për përthithjen e humbjeve;

c) nevojën për financim përpara dhe gjatë ndërhyrjes së jashtëzakonshme, disponibilitetin e burimeve të financimit dhe pengesat për transferimin e fondeve brenda bankës apo grupit bankar;

d) nëse ekzistojnë marrëveshje të përshtatshme për transferimin e humbjeve drejt subjekteve të grupit bankar mbi të cilat do të zbatohen instrumentet e ndërhyrjes së jashtëzakonshme nga subjektet e tjera të grupit, duke përfshirë atje ku është e mundur një vlerësim të shumës dhe kapacitetit përthithës të humbjeve nga financimi brenda grupit bankar.

Neni 24

Vlerësimi i zbatueshmërisë: Informacioni

Kur Autoriteti i Ndërhyrjes së Jashtëzakonshme vlerëson se ka pengesa potenciale për ndërhyrjen e jashtëzakonshme lidhur me marrjen e informacionit, konsideron:

a) çështjet e adresuara në pikat 8 deri në 12 të aneksit 1;

b) aftësinë e bankës për të ofruar informacion mbi shumën dhe vendndodhjen brenda grupit bankar të aktiveve, të cilat klasifikohen si kolateral për marrjen hua nga banka qendrore;

c) aftësinë e bankës për të dhënë informacion për realizimin e vlerësimit të shumës së nevojshme të zhvlerësimit ose të rikapitalizimit.

Neni 25

Vlerësimi i zbatueshmërisë: çështjet ndërkufitare

Kur Autoriteti i Ndërhyrjes së Jashtëzakonshme vlerëson nëse ka pengesa potenciale për ndërhyrjen e jashtëzakonshme lidhur me çështjet ndërkufitare, konsideron:

a) çështjet e adresuara në pikën 19 të aneksit 1;

b) ekzistencën e proceseve të përshtatshme për koordinim dhe komunikim, për të siguruar që veprimet e ndërmarra midis autoriteteve vendëse dhe të huaja mundësojnë zbatimin e strategjisë së ndërhyrjes së jashtëzakonshme;

c) mënyrën se si legjislacioni vendës dhe i huaj trajtojnë të drejtat kontraktuale të zgjidhjes së kontratave financiare, të cilat lidhen posaçërisht me paaftësinë paguese dhe ndërhyrjen e jashtëzakonshme.

Neni 26

Vlerësimi i zbatueshmërisë: Çështje ligjore

Për vlerësimin e pengesave potenciale për ndërhyrjen e jashtëzakonshme, Autoriteti i Ndërhyrjes së Jashtëzakonshme konsideron çështjet e mëposhtme ligjore që nuk janë përfshirë në kategoritë e tjera:

a) nëse plotësohen në kohë kërkesat për autorizime apo miratime të autoriteteve rregullatore, të nevojshme për zbatimin e strategjisë së ndërhyrjes së jashtëzakonshme;

b) nëse me fillimin e procesit të ndërhyrjes së jashtëzakonshme, dokumentacioni kontraktual lejon zgjidhjen e kontratave;

c) nëse detyrimet kontraktuale, të cilat nuk mund të shfuqizohen nga Autoriteti i Ndërhyrjes së Jashtëzakonshme ndalojnë transferimin e aktiveve dhe detyrimeve të përfshira në strategjinë e ndërhyrjes së jashtëzakonshme.

Neni 27

1. Nëse në përfundim të vlerësimit sipas këtij kreu, Autoriteti i Ndërhyrjes së Jashtëzakonshme vëren se ka pengesa thelbësore për kryerjen e procedurës së ndërhyrjes së jashtëzakonshme në një bankë, urdhëron marrjen e masave sipas nenit 15 të ligjit “Për rimëkëmbjen dhe ndërhyrjen e jashtëzakonshme në banka”.

2. Urdhri sipas pikës 1 të këtij nenit nxirret nga autoriteti i përcaktuar me një akt të veçantë të Këshillit Mbikëqyrës.



KREU IV KËRKESAT PËR RAPORTIM

Neni 28

Kategoritë e informacionit për hartimin e planeve të ndërhyrjes së jashtëzakonshme

1. Për hartimin e planeve të ndërhyrjes së jashtëzakonshme, Autoriteti i Ndërhyrjes së Jashtëzakonshme kërkon nga subjektet e kësaj rregulloreje çdo informacion të nevojshëm, në përputhje me pikën 5, të nenit 12, të ligjit “Për rimëkëmbjen dhe ndërhyrjen e jashtëzakonshme në banka”. Ky informacion përmban, por nuk kufizohet, në elementet e mëposhtme:

a) “Qeverisja dhe menaxhimi”, ku raportohet vendndodhja, juridiksioni, praktikat licencuese dhe të drejtimit për bankën dhe subjektet e grupit bankar.

b) “Veprimtaritë kryesore”, ku raportohet:

i) identifikimi i veprimtarive kryesore, që përfshin aktivet dhe detyrimet për secilën veprimtari kryesore, për bankën dhe subjektet e grupit bankar, për ekspozimet brenda dhe jashtë bilancit;

ii) personat përgjegjës për raportimin e informacionit të nevojshëm për hartimin e planeve të ndërhyrjes së jashtëzakonshme për bankën, si dhe (nëse janë të ndryshëm), për subjektet e tjera të grupit dhe veprimtaritë kryesore.

c) “Struktura e pasiveve”, ku raportohet:

i) struktura e pasiveve të bankës dhe e të gjitha subjekteve përbërëse të grupit bankar, duke detajuar së paku detyrimet afatshkurtra dhe ato afatgjata, detyrimet e siguruara dhe ato të pasiguruara, si dhe borxhin e varur;

ii) identifikimi i detyrimeve që i përkasin instrumenteve të kapitalit rregullator dhe detyrimeve të pranuar.

d) “Kolateralizimi”, ku identifikohen proceset e nevojshme për përcaktimin e palëve të treta ku banka ka vendosur kolaterale, mbajtësit e këtyre kolateraleve dhe juridiksioni i vendndodhjes së tyre.

e) “Sistemet e pagesave, klerimit dhe shlyerjeve”, ku raportohet:

i) të gjitha sistemet, nëpërmjet të cilave banka kryen një numër ose vlerë të konsiderueshme të operacioneve të saj të tregtimit, duke përfshirë lidhjet e bankës me personat juridikë, funksionet me rëndësi kritike dhe veprimtaritë kryesore;

ii) çdo sistem i pagesave, klerimit dhe shlyerjeve,

në të cilët banka është anëtare e drejtpërdrejtë ose jo e drejtpërdrejtë, duke përfshirë lidhjet e bankës me personat juridikë, funksionet me rëndësi kritike dhe veprimtaritë kryesore.

f) “Sistemet e informacionit”, ku raportohet:

i) inventari dhe përshkrimi i detajuar i sistemeve kryesore të administrimit të informacionit, të tillë si sistemi për administrimin e rreziqeve, kontabilitetin, financën dhe linjat e raportimit të rregullatorët, përfshirë dhe shpërndarjen e tyre sipas personave juridikë, funksioneve me rëndësi kritike dhe veprimtarive kryesore;

ii) identifikimin e zotëruesve/pronarëve të sistemeve të lidhura me marrëveshjet përkatëse të shërbimit, të licencave, të programeve dhe sistemeve, përfshirë shpërndarjen e tyre ndërmjet personave juridikë, funksioneve me rëndësi kritike dhe veprimtarive kryesore.

g) “Ndërlidhjet”, ku raportohet mbi identifikimin dhe shpërndarjen e personave juridikë dhe të ndërlidhjeve dhe ndërvarësive ndërmjet tyre për:

i) personelin e përbashkët, ndërtesat dhe sistemet;

ii) kapitalin, marrëveshjet për financim dhe likuiditetin;

iii) ekspozimet ekzistuese dhe ato të parashikuara të kredisë;

iv) marrëveshjet e garancive të kryqëzuara, të kolateraleve të kryqëzuara, provigjionet e paafësisë paguese të përbashkët dhe marrëveshjet e netimit mes filialeve;

v) transferimi i rrezikut dhe marrëveshjet e mbulimit tregtar (*back to back*); marrëveshjet e shërbimeve.

h) “Marrëveshjet kontraktuale”, ku raportohet mbi të gjitha marrëveshjet e nënshkruara nga banka dhe subjektet e tjera juridike, ndërprerja e të cilave mund të nxitet nga një vendim i autoriteteve për të ndërmarrë veprimet e ndërhyrjes së jashtëzakonshme, si dhe ndikimin e ndërprerjes së marrëveshjes/ve në zbatimin e instrumenteve të ndërhyrjes së jashtëzakonshme.

2. Për hartimin e planeve të ndërhyrjes së jashtëzakonshme, Autoriteti i Ndërhyrjes së Jashtëzakonshme përdor dhe informacionin e mbledhur në formularët standardë të planeve të rimëkëmbjes sipas rregullores nr. 72, datë 6.12.2017, “Për planet e rimëkëmbjes së bankave”, që përmban kategoritë e mëposhtme:



a) “Struktura organizative”, ku raportohet:
i) një përshkrim i detajuar i strukturës organizative të bankës/grupit bankar, duke listuar të gjitha subjektet juridike;

ii) identifikimi i zotëruesve të drejtpërdrejtë dhe përqindja e të drejtës së votës për çdo subjekt të grupit bankar.

b) “Funksionet me rëndësi kritike”, ku raportohet:

i) shpërndarja (*mapping*) e funksioneve me rëndësi kritike me veprimtaritë kryesore, që përfshin aktivet dhe pasivet për secilin funksion me rëndësi kritike, të çdo subjekti juridik, për ekspozimet brenda dhe jashtë bilancit;

ii) personat përgjegjës për raportimin e informacionit të nevojshëm për hartimin e planeve të ndërhyrjes së jashtëzakonshme për bankën, si dhe (nëse janë të ndryshëm), për subjektet e tjera të grupit dhe funksionet kritike.

c) “Subjekte të rëndësishme”, ku raportohet identifikimi i subjekteve të rëndësishme, si dhe analiza mbi ndikimin që sjell paaftësia paguese e tyre në pozicionin financiar të bankës.

Neni 29

Dispozitë e fundit

1. Për vitin 2018, bankat paraqesin informacionin e kërkuar në nenin 28 të kësaj rregulloreje jo më vonë se fundi i tremujorit të tretë të këtij viti.

2. Autoriteti i Ndërhyrjes së Jashtëzakonshme harton planet e ndërhyrjes së jashtëzakonshme, brenda 4 viteve nga hyrja në fuqi e kësaj rregulloreje.

ANEKS 1

Elementet që konsideron Autoriteti i Ndërhyrjes së Jashtëzakonshme për vlerësimin e aftësisë për ndërhyrje të jashtëzakonshme në një bankë apo grup bankar

Kur vlerëson aftësinë për ndërhyrje të jashtëzakonshme në një bankë apo grup bankar, Autoriteti i Ndërhyrjes së Jashtëzakonshme mban në konsideratë këto elemente:

1. aftësinë e bankës për shpërndarjen e veprimtarive kryesore dhe operacioneve me rëndësi kritike në personat juridikë;

2. shkallën e përputhshmërisë së strukturave ligjore dhe korporative me veprimtaritë kryesore dhe operacionet me rëndësi kritike;

Faqe | 3258

3. ekzistencën e marrëveshjeve për të siguruar personel bazë, infrastrukturë, financim, likuiditet dhe kapital për mbështetjen dhe ruajtjen e veprimtarive kryesore dhe operacioneve me rëndësi kritike;

4. shkallën e zbatueshmërisë së kontratave të shërbimit të bankës, në rast të ndërhyrjes së jashtëzakonshme në të;

5. shkallën e përshtatshmërisë së strukturës drejtuese të bankës për të menaxhuar dhe siguruar përputhshmëri me politikën e brendshme të bankës në lidhje me kontratat e shërbimit;

6. aftësinë e bankës për të transferuar, në rast të ndarjes së funksioneve me rëndësi kritike ose të veprimtarive kryesore, shërbimet e ofruara nëpërmjet kontratave të shërbimit te palët e treta;

7. aftësinë për të hartuar dhe parashikuar plane dhe masa që sigurojnë vazhdimësinë e sistemeve të pagesave dhe të shlyerjes;

8. përshtatshmërinë e sistemeve të menaxhimit të informacionit për të siguruar që Autoriteti i Ndërhyrjes së Jashtëzakonshme mbledh informacion të saktë dhe të plotë mbi veprimtaritë kryesore dhe shërbimet me rëndësi kritike për të lehtësuar procesin e vendimmarrjes;

9. kapacitetin e sistemeve të menaxhimit të informacionit për të ofruar informacionin thelbësor të nevojshëm për realizimin efektiv të ndërhyrjes së jashtëzakonshme të bankës, në çdo kohë e madje edhe në kushte të ndryshueshme;

10. shkallën në të cilën banka ka testuar sistemet e saj të menaxhimit të informacionit në skenarë stres, siç përcaktohet nga Autoriteti i Ndërhyrjes së Jashtëzakonshme;

11. shkallën në të cilën banka mund të sigurojë vazhdimësinë e sistemeve të saj të menaxhimit të informacionit si për bankën e prekur, ashtu edhe për institucionin e ri në rast se shërbimet me rëndësi kritike dhe veprimtaritë kryesore ndahen nga pjesa tjetër e shërbimeve dhe veprimtarive të bankës;

12. përcaktimin nga ana e bankës të proceseve të përshtatshme për t'i ofruar Bankës së Shqipërisë informacionin e nevojshëm në lidhje me depozituesit dhe depozitat e siguruar nga skema e sigurimit të depozitave;

13. në rastet e përdorimit të garancisë brenda grupit, shkallën me të cilën garancitë janë ofruar me kushtet e tregut dhe efikasiteti i sistemeve të menaxhimit të rrezikut lidhur me to;

14. nëse grupi angazhohet në transaksione reciproke (*back to back*), kryerja e transaksioneve me



vlerën e tregut dhe efikasiteti i sistemeve të menaxhimit të rrezikut lidhur me këto transaksione;

15. shkallën me të cilën përdorimi i garancive brenda grupit ose kontabilizimi i transaksioneve reciproke rrit përhapjen e rrezikut të efektit zinxhir në të gjithë grupin;

16. shkallën me të cilën struktura ligjore e grupit pengon zbatimin e instrumenteve të ndërhyrjes së jashtëzakonshme si rezultat i numrit të personave juridikë, kompleksitetit të strukturës së grupit ose vështirësisë në vlerësimin e shpërndarjes së linjave të biznesit me subjektet e grupit;

17. shumën dhe llojin e detyrimeve të pranuar të bankës;

18. ekzistencën dhe qëndrueshmërinë e kontratave të shërbimit;

19. nëse Autoriteti i Ndërhyrjes së Jashtëzakonshme ka instrumentet e nevojshme të ndërhyrjes së jashtëzakonshme për mbështetjen e veprimeve të ndërhyrjes së jashtëzakonshme të autoriteteve të huaja dhe fushëveprim për të koordinuar veprimet me autoritetet e huaja;

20. mundësinë e përdorimit të instrumenteve të ndërhyrjes së jashtëzakonshme në mënyrë të tillë që të përmbushen objektivat e ndërhyrjes së jashtëzakonshme, duke konsideruar instrumentet në dispozicion dhe strukturën e bankës;

21. shkallën me të cilën struktura e grupit lejon Bankën e Shqipërisë të kryejë ndërhyrjen e jashtëzakonshme në një apo më shumë subjekte të grupit pa shkaktuar ndikim negativ të drejtpërdrejtë apo të tërthortë në sistemin financiar, besimin e tregut ose në ekonomi, dhe me qëllim maksimizimin e vlerës së veprimtarisë bankare të grupit;

22. masat dhe mjetet përmes të cilave mund të lehtësohet ndërhyrja e jashtëzakonshme për grupet bankare që kanë filiale në juridiksione të ndryshme;

23. besueshmërinë e përdorimit të instrumenteve të ndërhyrjes së jashtëzakonshme në mënyrë të tillë që të përmbushen objektivat e ndërhyrjes së jashtëzakonshme, duke pasur parasysh ndikimet e mundshme të kreditorët, kundërpalët, konsumatorët dhe punonjësit, dhe veprimet e mundshme që mund të ndërmerren nga autoritetet përkatëse;

24. shkallën në të cilën mund të vlerësohet në mënyrë të përshtatshme ndikimi i ndërhyrjes së jashtëzakonshme të bankës në sistemin financiar dhe në besimin e tregut financiar;

25. shkallën në të cilën ndërhyrja e jashtëzakonshme në bankë do të ndikonte negativisht, drejtpërdrejt apo tërthorazi, në sistemin financiar, besimin e tregut apo në ekonomi;

26. mundësinë e frenimit të përhapjes së efektit zinxhir në banka të tjera apo në tregjet financiare, përmes zbatimit të instrumenteve dhe kompetencave të ndërhyrjes së jashtëzakonshme;

27. shkallën e ndikimit të ndërhyrjes së jashtëzakonshme në bankë në funksionimin e sistemeve të pagesave dhe shlyerjes.

VENDIM

Nr. 15, datë 10.1.2018

MBI MIRATIMIN E KUSHTEVE TË PËRGJITHSHME TË KONTRATËS SË SHËRBIMIT UNIVERSAL TË FURNIZIMIT ME ENERGJI ELEKTRIKE PËR KLIENTËT FUNDORË

Në mbështetje të nenit 16, germat “a” dhe “h”; të nenit 80, 81, 82, 83, 84, 85, 94 dhe 96 të ligjit nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike”, si dhe nenit 26 të “Rregullores për organizimin, funksionimin dhe procedurave të ERE-s”, miratuar me vendimin nr. 96, datë 17.6.2016, Bordi i Entit Rregullator të Energjisë (ERE), në mbledhjen e tij të datës 10.1.2018, mbasi shqyrtoi relacionin mbi miratimin e “Kushteve të përgjithshme të Kontratës së Shërbimit Universal të Furnizimit me Energji Elektrike për Klientët Fundorë”, të përgatitur nga drejtoritë teknike,

konstatoi se:

- Me vendimin nr. 59, datë 29.4.2016, bordi i ERE-s vendosi: fillimin e procedurave për miratimin e “Kushteve të përgjithshme të Kontratës së Shërbimit Universal të Furnizimit me Energji Elektrike për Klientët Fundorë”.

- Në shkresën nr. 351 prot., datë 4.5.2016, ERE u ka dërguar të gjitha palëve të treta dhe grupeve të interesit, draftkontratën mbi “Kushtet e Përgjithshme të Kontratës së Shërbimit Universal të Furnizimit me Energji Elektrike për Klientët Fundorë” për konsultim dhe për të marrë komente me qëllim përmirësimin e parashikimeve të propozuara nga grupi i punës.

- Në shkresën me nr. 351/8, datë 6.6.2017, dhe shkresën me nr. 195/3, datë 24.3.2017, Autoriteti i Konkurrencës ka dhënë komentet përkatëse.



- Në shkresën nr. 351/9 prot., datë 4.7.2016, Ministria e Energjisë dhe Industrisë ka shprehur dakordësinë e saj lidhur me draftkontratën.

- Në shkresën nr. 351/1, datë 17.5.2016, MZHE'TTS-i ka paraqitur komentet e tij lidhur me draftkontratën.

- Në shkresën me nr. 351/3 prot., datë 19.5.2016, subjekti Bashkimi i Sindikatave të Pavarura ka paraqitur sugjerimet e tij lidhur me draftkontratën.

- Në shkresën nr. 351/1 prot., datë 25.5.2016, Operatori i Sistemit të Transmetimit ka paraqitur komentet e tij.

- Në shkresën me nr. 351/2 prot., datë 17.5.2016, Shoqata e Konsumatorit Shqiptar ka paraqitur komentet e saj lidhur me draftkontratën.

- Në shkresën me nr. 429/1 prot., datë 6.6.2016, Operatori i Shpërndarjes së Energjisë Elektrike ka paraqitur 2 draftkontrata:

- “Kushtet e Përgjithshme të Shërbimit Universal të Furnizimit me Energji Elektrike për Klientët Familjarë”

- “Kushtet e Përgjithshme të Shërbimit Universal të Furnizimit me Energji Elektrike për Klientët Jofamiljarë”

- Në shkresën me nr. 508 prot., datë 4.7.2016, ERE ka njoftuar të gjitha palët që kanë dërguar komente për zhvillimin e një seance dëgjimore.

- Në shkresën me nr. 195 prot., datë 27.2.2017, ERE u ka dërguar të gjitha palëve të interesuar draftkontratën dhe komentet e OSHEE sh.a. lidhur me këtë draftkontratë të paraqitur pranë ERE-s, me shkresën nr. 5655 prot., datë 13.2.2017.

- Në shkresën me nr. 195/3 prot., datë 24.3.2017, Autoriteti i Konkurrencës konfirmon se draftkontrata mbi “Kushtet e përgjithshme të Kontratës së Shërbimit Universal të Furnizimit me Energji Elektrike për Klientët Familjarë” nuk bie në kundërshtim me ligjin nr. 9121, datë 28.7.2003, “Për mbrojtjen e konkurrencës”.

- Në shkresën me nr. 195/1 prot., datë 9.3.2017, subjekti Bashkimi i Sindikatave të Pavarura ka paraqitur të njëjtat sugjerime si në shkresën nr. 351/3 prot., datë 19.5.2016.

- Në shkresën me nr. 195/4 prot., datë 29.3.2017, Ministria e Zhvillimit Ekonomik, Turizmit, Tregtisë dhe Sipërmarrjes ka shprehur komentet e saj lidhur me propozimet e OSHEE sh.a. mbi ristrukturimin e draftkontratës.

- ERE ka analizuar të gjitha komentet e

dërguara nga palët dhe ka reflektuar në draftkontratë ato komente që i ka gjykuar të arsyeshme, në diskutim me palët, e që nuk bien ndesh me legjislacionin në fuqi.

Për gjithë sa më sipër cituar, bordi i ERE-s

VENDOSI:

1. Të miratojë “Kushtet e përgjithshme të Kontratës së Shërbimit Universal të Furnizimit me Energji Elektrike për Klientët Fundorë”.

2. Drejtoria Juridike dhe e Mbrojtjes së Konsumatorit do të njoftojë palët e interesuara për vendimin e bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim mund të ankimohet në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike, nga botimi në Fletoren Zyrtare.

ANËTAR I BORDIT TË ERE-S

Erjola Sadushi

KUSHTET E PËRGJITHSHME TË KONTRATËS SË SHËRBIMIT UNIVERSAL TË FURNIZIMIT ME ENERGJI ELEKTRIKE PËR KLIENTËT FUNDORË

⁴Kontratë nr. _____.

PJESA E PARË

E lidhur sot më datë _____, në

Nga palët në kontratë:

Furnizuesi i shërbimit universal _____, i regjistruar si person juridik sipas legjislacionit në fuqi, sipas vendimit nr. _____, datë _____ të QKR-së, pajisur me numër identifikimi pranë organeve tatimore _____ dhe me licencën për furnizimin me energji elektrike dhe i ngarkuar me detyrimin e shërbimit universal të furnizimit, të miratuar me vendimin e bordit të ERE-s nr. _____, datë _____, në adresën zyrtare: _____ Shqipëri, përfaqësuar nga personi i autorizuar z./znj. _____, identifikuar këtu e më poshtë si furnizuesi



dhe

Klienti fundor që përfiton nga shërbimi universal i furnizimit _____, përfaqësuar _____ (emri, atësia, dhe mbiemri i përfaqësuesit ligjor të klientit) në adresën: qytet/fshat _____, seksioni, _____, rruga _____, ndërtesa _____, ap. _____, tel nr. _____, identifikuar nëpërmjet dokumentit të identifikimit të tij: nr. i pasaportës/kartë identiteti _____

Pika e lëvrimit të energjisë.....

Adresa e klientit fundor për shërbimin e dërgimit të faturës.....

Nr. i tel adresa e e-mail (nëse ka).....

Palët bien dakord që pjesa e dytë “Termat dhe kushtet” është pjesë përbërëse dhe e pandashme e kësaj kontrate.

FURNIZUESI

KLIENTI

PJESA E DYTË TERMAT DHE KUSHTET

Neni 1

Qëllimi

Qëllimi i kësaj kontrate konsiston në ofrimin e shërbimit të furnizimit me energji elektrike si shërbim publik, në kuadër të aktivitetit të shërbimit universal të furnizimit me energji elektrike për klientët fundor.

Neni 2

Baza ligjore

Kjo kontratë hartohet në mbështet të neneve 80, 82, 83, 84, 85, 94, 96 të ligjit nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike”, gjithashtu dhe ligjit nr. 9902, datë 17.4.2008, “Për mbrojtjen e konsumatorëve”, të ndryshuar si dhe ligjit nr. 9887, datë 10.3.2008, “Për mbrojtjen e të dhënave personale”, të ndryshuar.

Neni 3

Objekti i kontratës

3.1 Objekti i kësaj kontrate është furnizimi i pandërprerë me energji elektrike nga ana e furnizuesit të ngarkuar me shërbimin universal të furnizimit dhe detyrimi i klientit fundor për të

paguar energjinë elektrike të konsumuar, në përputhje me termat dhe kushtet e kësaj kontrate.

3.2 Furnizimi me energji elektrike i klientëve fundorë nga furnizuesi i shërbimit universal në pikën e kërkuar nga klienti fundor ofrohet me këta parametra teknikë:

- me fuqi të kërkuar _____ kw ose/limitator _____ A,
- me tension _____ V
- sistem _____ fazor
- frekuencë 50 Hz

Neni 4

Dispozita të përgjithshme

4.1 Kushtet e përgjithshme të përcaktuara në këtë kontratë janë të vlefshme për të gjithë klientët që përfitojnë nga shërbimi universal i furnizimit. Klienti nuk mund t'i japë apo shesë energji elektrike klientëve të tjerë nga pika e tij e lidhjes dhe nga sistemi elektrik i brendshëm.

4.2 Furnizuesi është i detyruar të mbrojë dhe të mos nxjerrë të dhënat personale të klientit konform ligjit nr. 9887, datë 10.3.2008, “Për mbrojtjen e të dhënave personale”, të ndryshuar. Të dhënat personale të klientit mund të jepen nga furnizuesi në rastet e mëposhtme:

- Me pëlqimin e klientit;
- Në rast të respektimit të detyrimeve kontraktuale të furnizuesit në lidhje me përmbushjen e shërbimit të shpërndarjes së faturave të energjisë elektrike dhe/ose arkëtimin e detyrimeve.
- Në zbatim të legjislacionit në fuqi.

Neni 5

Lidhja e kontratës

5.1 Ka të drejtë të kërkojë lidhjen e kontratës për furnizimin me energji elektrike çdo person jo debitor ndaj furnizuesit universal, që ka një pikë lidhje të miratuar me rrjetin e shpërndarjes të energjisë elektrike dhe që plotëson kërkesat e përcaktuara në ligjin e sektorit të energjisë elektrike.

5.2 Të drejtën e furnizimit nga furnizuesi i shërbimit universal e ka edhe çdo klient i cili ka përfituar statusin e “klientit në nevojë”, sipas përcaktimeve të nenit 95 të ligjit nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike” dhe që është regjistruar pranë OSHEE-së si i tillë.



5.3 Klienti fundor që kërkon lidhjen e kontratës me furnizuesin e ngarkuar me shërbimin universal të furnizimit duhet të depozitojë një kërkesë me shkrim pranë çdo përfaqësie të furnizuesit nga i cili merr shërbimin e furnizimit, shoqëruar me dokumentacionin e përcaktuar në këtë kontratë.

5.4 Furnizuesi, pasi ka kontrolluar dhe verifikuar të gjithë dokumentacionin e kërkuar, nënshkruan kontratën me klientin brenda 15 ditëve kalendarike nga marrja e kërkesës së aplikuesit.

5.5 Nëse kërkesa e aplikuesit nuk është e shoqëruar me dokumentacionin e plotë, furnizuesi, brenda 7 ditësh kalendarike, do të njoftojë me shkrim aplikuesin për mangësitë e konstatuara. Aplikuesi duhet të paraqesë dokumentacionin e munguar brenda 7 ditësh kalendarike nga momenti i njoftimit. Kërkesa do të refuzohet në rast mosplotësimi të këtij dokumentacioni. Furnizuesi duhet të njoftojë me shkrim aplikuesin në adresën e përcaktuar nga aplikuesi, në kërkesën për furnizim, në çdo rast për pranimin ose jo të kërkesës së tij.

5.6 Për një objekt i cili është furnizuar më parë me energji elektrike, furnizuesi do të sigurojë lidhjen e kontratës së re brenda 7 ditëve kalendarike nga paraqitja e kërkesës dhe plotësimi i dokumentacionit përkatës nga ana e subjektit të interesuar.

Neni 6

Pezullimi dhe përfundimi i kontratës

6.1 Kontrata e furnizimit lidhet për një periudhë të pacaktuar dhe mund të ndërpritet vetëm në rastet e parashikuara si më poshtë:

6.1.1 Me kërkesë të klientit, pas ekzekutimit të të gjitha detyrimeve monetare, dhe në bazë të kushteve të përcaktuara në nenin 6.2.

6.1.2 Me iniciativën e furnizuesit, në rast të shkeljes nga ana e klientit të detyrimeve/kushteve thelbësore të kontratës, për të cilat njoftohet me parë me shkrim. Do të konsiderohen shkelje thelbësore të kushteve të kontratës nga ana e klientit rastet si më poshtë:

a) Nëse klienti nuk paguan detyrimet e energjisë elektrike duke përfshirë edhe kamatëvonesën brenda 1 muaji pas ndërprerjes së energjisë elektrike.

b) Nëse provohet nga furnizuesi që klienti merr energji elektrike në mënyrë të paligjshme.

c) Nëse klienti, në mënyrë të përsëritur, nuk i krijon akses furnizuesit për më shumë se 3 muaj për leximin e verifikimin e matësve dhe instalimeve, kur matësi apo sistemi i matjes është brenda kufijve të pronës të tij.

ç) Nëse klienti dhe pasi ka marrë njoftim me shkrim nga furnizuesi në afatet e parashikuara në ligj, për ndryshimin e kushteve të kontratës, të miratuara nga ERE, nuk merr masa për zbatimin e tyre.

6.1.3 Furnizimi me energji elektrike i klientëve që kanë përfituar statusin e “klientëve në nevojë” do të ndërpritet vetëm sipas kushteve të parashikuara në rregulloren e miratuar nga ERE, sipas nenit 95 të ligjit nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike”.

6.2 Nëse klienti kërkon të pezullojë/mbyllë kontratën e furnizimit me energji elektrike, ai do të njoftojë me shkrim furnizuesin 15 ditë kalendarike përpara dhe do të likuidojë të gjitha detyrimet përkundrejt furnizuesit jo më vonë se 30 ditë nga mbyllja apo pezullimi i kontratës. Klientit do t’i jepet konfirmimi për arkëtimin e tarifës së ndërprerjes së kontratës (mandati përkatës i arkëtimit nëse aplikohet nga furnizuesi). Klienti nuk është përgjegjës për asnjë detyrim që mund të rezultojë ndaj furnizuesit pas përfundimit të afatit 30-ditor pas depozitimit të kërkesës (kohë në të cilën janë shlyer të gjitha detyrimeve financiare).

6.3 Klienti mund të bëjë kërkesë për riaktivizimin e shërbimit të furnizimit me energji elektrike, pranë çdo përfaqësie të furnizuesit, i cili do të garantojë furnizimin me energji brenda 48 orëve, nga momenti i depozitimit të kërkesës.

6.4 Me ndërprerjen e kontratës së furnizimit me energji elektrike, furnizuesi do të ndërpresë menjëherë furnizimin e energjisë elektrike në pikën e lidhjes, nëpërmjet operatorit të shpërndarjes. Me ndërprerjen e lidhjes, furnizuesi do të bëjë leximin dhe do të llogarisë faturën e fundit, si edhe do të vuloset pika e lidhjes, duke u përdorur një vulë të ndryshme nga ajo e lidhjes, në përputhje me legjislacionin në fuqi.

6.5 Klienti është përgjegjës për ekzekutimin e detyrimeve që lidhen me konsumin e energjisë elektrike deri në momentin e përfundimit të kontratës. Në çdo rast, klienti nuk është përgjegjës për asnjë detyrim ndaj furnizuesit pas kalimit të afatit të parashikuar në nenin 5.2.



Neni 7

Detyrimet e furnizuesit

7.1. Furnizuesi, në zbatim të ligjit nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike” ka detyrimin të furnizojë klientët me energji elektrike, në përputhje me kontratën e nënshkruar, në mënyrë të sigurt, të besueshme dhe efikase.

7.2. Furnizuesi, përveç detyrimeve të përgjithshme të përcaktuara në kontratë, informon klientët, në faturat përkatëse, për:

a) Të drejtën e tyre për të zgjedhur dhe për të ndryshuar pa pagesë furnizuesin, pasi kanë ekzekutuar të gjitha detyrimet e mëparshme të energjisë elektrike.

b) Konsumin dhe kostot aktuale të energjisë elektrike, me qëllim mundësimin e menaxhimit të konsumit të energjisë nga ana e klientëve.

c) Mënyrat e ndryshme të pagesës, të cilat nuk duhet të jenë diskriminuese midis klientëve. Sistemet e parapagimit, nëse do të aplikohen, duhet të jenë të drejta dhe të reflektojnë konsumin e pritshëm.

ç) Procedurën e zgjidhjes së mosmarrë-veshjeve dhe ankesave mes furnizuesit dhe klientit.

d) Të bëj publike, duke reklamuar në zyrat e përfaqësive të tij, dhe faqen e internetit procedurat për pezullimin dhe ndërprerjen e kontratës së furnizimit me energji elektrike.

dh) Të njoftojë me shkrim klientin fundor në rast të mospagimit të energjisë, si dhe masat që do të marrë për arkëtimin e detyrimit sipas dispozitave të ligjit nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike” dhe ligjit nr. 8662, datë 18.9.2000, “Për trajtimin si titull ekzekutiv të faturës së konsumit të energjisë”, të ndryshuar.

e) Furnizuesi do të sigurojë aksesin *online* të faturës së konsumit për çdo klient fundor duke garantuar konfidencialitetin e të dhënave të klientit dhe faturimit.

Neni 8

Të drejtat e klientit fundor

8.1. Klienti fundor ka të drejtë:

a) Të furnizohet me energji elektrike në përputhje me kushtet e vendosura në këtë kontratë.

b) Të paraqesë ankesë pranë përfaqësive të furnizuesit dhe pranë ERE-s, nëse nuk furnizohet sipas kushteve të vendosura në kontratë.

c) Të përfitojë nga furnizuesi një trajtim jodiskriminues.

ç) Të marrë të gjitha informacionet e nevojshme nga furnizuesit në përputhje me nenin 6 të kësaj kontrate.

d) Të drejtën për të zgjedhur dhe ndryshuar pa pagesë furnizuesin, pasi ka ekzekutuar të gjitha detyrimet e mëparshme të energjisë elektrike.

dh) Të marrë informacion të plotë, me shkrim, për çmimet, tarifat, termat dhe kushtet standarde, në lidhje me aksesin dhe përdorimin e shërbimeve të energjisë elektrike.

e) Të përdorë mekanizma të ndryshëm të pagesës dhe të mbrohet prej metodave të padrejta të faturimit.

ë) Të mos paguajë asnjë kosto shtesë lidhur me ndryshimin e furnizuesit.

f) Të përfitojë nga procedura transparente e të thjeshta për trajtimin e ankesave të tyre, të cilat, kur është e mundur, parashikojnë një sistem rimbursimi dhe/ose kompensimi.

g) Të informohet, pa kosto shtesë, për konsumin e tij dhe kostot respektive të energjisë elektrike, në varësi të pajisjeve matëse me të cilat është i pajisur klienti.

gj) Klientët kanë të drejtë të instalojnë njësi matëse shtesë me kërkesën dhe shpenzimet e tyre.

Neni 9

Detyrimet e klienti fundor

9.1 Klienti fundor ka këto detyrime ndaj furnizuesit:

a) Të paguajë për energjinë elektrike në përputhje me kushtet e kontratës.

b) Të mundësojë Operatorit të Sistemit të Shpërndarjes ose Operatorit të Sistemit të Transmetimit instalimin, mirëmbajtjen dhe leximin e pajisjeve për matjen e konsumit të energjisë elektrike pasi është njoftuar me shkrim 48 orë më parë.

c) Të respektojë kushtet e kontratës së furnizimit.

ç) Klientët fundorë janë përgjegjës përballë furnizuesit për disbalancat e shkaktuara, në përputhje me vendimet e ERE-s, i cili vendos për përjashtimin nga përgjegjësia për disbalancat, për kategori të caktuara të klientëve fundorë, të cilët furnizohen mbi bazën e shërbimit universal të furnizimit, si detyrim i shërbimit publik.



Neni 10

Çmimi i energjisë elektrike

10.1 Në bazë të legjislacionit në fuqi që rregullon sektorin e energjisë elektrike, çmimi i energjisë elektrike përcaktohet nga Enti Rregullator i Energjisë (ERE). Çmimi, përbërësit e tij, struktura tarifore orare apo sipas nivelit të konsumit i bëhen të ditur klientit në faturën e konsumit të energjisë elektrike.

10.2 Ndryshimet e çmimit të energjisë elektrike bëhen me vendim të ERE-s. Palët në kontratë bien dakord që çdo ndryshim i çmimit i bërë me vendim të ERE-s do të aplikohet automatikisht në kontratë.

10.3 Furnizuesi e publikon vendimin për ndryshimin e çmimit nëpërmjet mjeteve të ndryshme të informimit të paktën 15 ditë kalendarike përpara aplikimit.

Neni 11

Leximi i matësit dhe faturimi i energjisë elektrike

11.1 Furnizuesi do të bëjë leximin periodik të matësit të energjisë elektrike të klientit konform parashikimeve të Kodit të Matjes, Kodit të Rrjetit si dhe legjislacionit në fuqi për Metrologjinë, për një periudhë kohore prej 30 ditësh kalendarike dhe do t'i dërgojë klientit fundor në adresën e dhënë, në kontratë, faturën “tip” të energjisë elektrike, brenda 10 ditëve nga data e leximit.

11.2 Çdo faturë e energjisë elektrike duhet të përmbajë minimalisht:

- Të dhënat teknike mbi pikën e lidhjes;
- Të dhëna identifikuese të klientit;
- Datën e leximit;
- Periudhën e faturuar;
- Leximin e matësit dhe konsumin përkatës për periudhën e faturuar;
- Çmimin për njësi sipas strukturës së tarifave dhe përbërësit e tij;
- Shumën në lekë që i korrespondon periudhës së faturimit;
- Shumat e taksave që i korrespondojnë sipas legjislacionit në fuqi;
- Datën limit të pagimit të faturës;
- Kamatëvonesa e aplikuar për çdo ditë vonese;
- Penalitetet e mundshme për pagesë të vonuar;
- Vlerën e detajuar e debisë së klientit;

- Informacionet e nevojshme për kujdesin ndaj klientit (përfshirë *website*-in e kompanisë, numrat e telefonit, *email*-in për ankesat, për defektet si të drejtën për të paraqitur ankesë pranë ERE-s).

Neni 12

Faturimi i energjisë elektrike gjatë mosfunksionimit të aparatit matës

12.1 Në rast se të dhënat e aparatit të matjes janë përkohësisht të padisponueshme ose të paarrtshme për një periudhë më të gjatë se 1 muaj, operatorët e rrjetit llogarisin vlera reference zëvendësuese, bazuar në metodologjinë e miratuar nga ERE. Periudha e zbatimit të vlerave referuese, nuk mund të zgjasë më shumë se 3 muaj.

12.2 Nëse furnizuesi nuk respekton afatin e përcaktuar në pikën 12.1 për vendosjen e matësit të rregullt, atëherë përgjegjësia është e furnizuesit dhe faturimi për ditët pa matje tej këtij afati do të jetë zero.

12.3 Në rast të konstatimit të pasaktësive në matje, palët do të rregullojnë efektet në zbatim të parashikimeve të Kodit të Matjes dhe akteve të tjera ligjore në fuqi.

Neni 13

Pagesa dhe afati për kryerjen e saj

13.1 Klienti do të paguajë detyrimin e përcaktuar në faturën mujore të konsumit të energjisë elektrike jo më vonë se 30 ditë nga data e lëshimit të faturës së fundit, si dhe, kur është rasti, kamatëvonesat përkatëse.

13.2 Klienti mund të zgjedhë mënyrën e pagesës së faturës mujore të energjisë elektrike me një nga mundësitë që furnizuesi ka ofruar (nëpërmjet pagesës së drejtpërdrejtë në zyrat e furnizuesit, bankave, zyrave postare apo nëpërmjet pagesave të drejtpërdrejta nga llogaritë bankare).

13.3 Të gjitha pagesat sipas kushteve të kësaj kontrate duhet të përmbajnë të dhënat siç janë numri i transfertës bankare, numri i llogarisë, dhe të gjitha të dhënat e përcaktuara në faturën e energjisë elektrike, në mënyrë të veçantë numrin e kontratës, numrin e faturës dhe emrin e klientit. Sipas marrëveshjes me klientin faturat mund të dërgohen:



- klientit në adresën e përcaktuar në kontratë;
- në adresë të një personi të tretë, i cili është përcaktuar si pagues nga klienti sipas pëlqimit të tij.

13.4 Në të gjitha rastet, klienti është përgjegjës për pagesën e plotë të të gjitha faturave sipas kushteve të kësaj kontrate. Në rast se klienti ndërmon vendbanim pa njoftuar, ai është përgjegjës për mospagesat e faturave të energjisë.

13.5 Palët bien dakord që në rast të pagesave të paidentifikuara të bëra nga klienti apo mbipagesave të tjera të faturës/ave, furnizuesi ka të drejtë të balancojë detyrimet aktuale apo të mbartura të Klientit, dhe shuma përkatëse të konsiderohet si parapagesë e detyrimeve të muajit pasardhës të klientit.

Neni 14

Kamatëvonesa për pagesë të vonuar

Pas kalimit të afatit të pagesës caktuar në nenin 13, klienti është i detyruar të paguajë një kamatë vonesa të barabartë me 0.1 % të vlerës së faturës për çdo ditë vonesa, por jo më shumë se vlera totale e vetë faturës.

Neni 15

Pasojat e mospagesës

15.1 Në mungesë të pagesës nga klienti të faturës brenda 30 ditëve nga kalimi i afatit të caktuar për pagesë sipas nenit 13.1, furnizuesit i lind e drejta që të bëjë ndërprerjen e furnizimit me energji elektrike të klientit, pasi e ka lajmëruar me shkrim këtë të fundit 48 orë përpara. Furnizuesi është i detyruar që të bëjë rilidhjen brenda 48 orësh nga kryerja e pagesës së detyrimit dhe me kërkesë të klientit.

15.2 Nëse klienti nuk paguan detyrimin që ka ndaj furnizuesit brenda 1 muaji nga data e ndërprerjes së furnizimit me energji elektrike sipas nenit 12, atëherë furnizuesi ka të drejtë të zgjidhë në mënyrë të njëanshme kontratën e furnizimit me energji elektrike sipas pikës 6.1.2, duke njoftuar me shkrim klientin.

Neni 16

Ankimi për faturimin dhe kushtet e furnizimit të energjisë elektrike

16.1 Klienti fundor ka të drejtë të paraqesë një ankim pranë furnizuesit për çdo veprim apo mosveprim të furnizuesit që lidhet me të drejtat e detyrimet e përcaktuara në këtë kontratë, me shkrim, me gojë, me telefon (*Call Center*) ose në rrugë elektronike.

16.2 Furnizuesi do të trajtojë çdo ankesë në përputhje me “Rregulloren e Trajtimit të Ankesave”, të hartuar nga furnizuesi dhe të miratuar nga ERE. Kjo Rregullore bëhet publike në zyrat ku bëhen pagesat e energjisë elektrike apo në Zyrat e Kujdesit ndaj Klientit dhe në faqet elektronike të furnizuesit apo të ERE-s.

16.3 Në rast se furnizuesi nuk i kthen përgjigje për ankesën klientit fundor brenda afatit të përcaktuar në Rregulloren e mësipërme apo nëse klienti fundor nuk është dakord me përgjigjen e dhënë prej furnizuesit, atëherë ai ka të drejtë të paraqesë një ankesë pranë ERE-s, sipas procedurave të përcaktuara në rregulloret përkatëse të ERE-s. Ankesa në ERE mund të paraqitet jo më vonë se 12 muaj **pas marrjes** dijeni nga klienti të përgjigjes së trajtimit të ankesës nga furnizuesi në adresën e përcaktuar në këtë kontratë.

16.4 Klienti fundor mund të kundërshtojë në çdo kohë faturën e lëshuar nga furnizuesi, por jo me vonë se 1 vit nga data e lëshimit të saj, si në rast kur dyshon në saktësinë e faturimit, gabime të tjera të konstatuara në faturë apo pasaktësi në sistemin e matjes.

16.5 Në rast se pas verifikimeve të furnizuesit rezulton se konsumatori është mbifaturuar, atëherë furnizuesi:

i) anulon faturën përkatëse dhe lëshon faturën e korrektuar,

ii) në rast se është kryer pagesa, realizon kompensimin përkatës në faturën e klientit brenda 3 muajve pasardhës.

Në rast të moskompensimit brenda afatit të përcaktuar me sipër, furnizuesi duhet të kompensojë klientin me një penaltet 0.1% në ditë, për çdo ditë vonesa, mbi vlerën e diferencës për t'u korrigjuar, e zbritshme në faturën pasardhëse.

16.6 Për faturat e kontestuara nga klienti që rezultojnë me faturime dukshëm më të mëdha se faturimet mesatare mujore të tij (të krahasueshme ose më shumë se dyfishi i faturimit mesatar mujor të së njëjtës periudhë), furnizuesi pezullon faturën dhe realizon me procedurë të përsheptuar verifikimin, anulimin dhe nxjerrjen e faturës së korrigjuar brenda 10 ditëve.

16.7 Për faturat e ankimuara nga klienti nuk do të ndërpritet furnizimi me energji elektrike deri në përfundimin e shqyrtimit të ankesës për këtë faturë nga furnizuesi.



Neni 17

Instalimi dhe pronësia

17.1 Operatori i Sistemit të Shpërndarjes instalon te klienti fundor, në përputhje me kërkesat e legjislacionit, sistemin e matjes së energjisë elektrike dhe e lidh atë me rrjetin e shpërndarjes në përputhje me “Rregulloren për Lidhjet e Reja”, matësi dhe/ose sistemi matës duhet të jenë në përputhje me kërkesat e legjislacionit për metrologjinë dhe pas instalimit duhet të bashkëvulosen nga operatori i sistemit dhe DPM-ja ose nga personi juridik i autorizuar prej saj.

17.2 Klasa e saktësisë së matësve të energjisë elektrike përcaktohet në Kodin e Matjes, të miratuar nga ERE.

17.3 Në veprimtarinë e matjes së energjisë elektrike mund të implementohen sisteme matëse inteligjente te klientët fundorë.

17.4 Klientët kanë të drejtë të instalojnë njësi matjeje shtesë me kërkesën dhe shpenzimet e tyre.

17.5 Klienti është përgjegjës për cilësinë, kushtet teknike dhe ato të sigurimit teknik që lidhen me kryerjen e instalimeve elektrike brenda objektit apo banesës së tij.

17.6 Klienti është përgjegjës për ruajtjen (mbrojtjen) e sistemit matës të energjisë elektrike të vendosur brenda kufijve të pronës së tij.

Neni 18

Kontrolli i sistemit matës

18.1 Aparatet matëse verifikohen përpara vënies në përdorim, nëpërmjet metodës së kampionit, në bazë të përzgjedhjes rastësore dhe në mënyrë periodike.

18.2 Verifikimi i matësve mund të realizohet me kërkesë të operatorit të sistemit ose me kërkesë të klientit. Verifikimi mund të realizohet në terren, aty ku matësi është i instaluar, pranë laboratorit të DPM-së apo subjektit të autorizuar. Periodiciteti i verifikimit të matësve të instaluar te klienti përcaktohet në “Kodin e Matjes”. Në çdo rast duhet të jetë i pranishëm edhe përfaqësuesi i operatorit të sistemit.

18.3 Kontrolli i sistemit të matjes bëhet në prezencë të klientit fundor, në përputhje me legjislacionin në fuqi që rregullon sektorin e energjisë elektrike.

18.4 Kur klienti dyshon në saktësinë e aparatit matës, paraqet një kërkesë me shkrim pranë operatorit të rrjetit, si dhe çdo institucioni tjetër përgjegjës për verifikimin e aparatit matës. Procedura për paraqitjen e një kërkesë, shqyrtimin e saj dhe afatet e njoftimit të kërkuarit miratohen me vendim të ERE-s. Kur verifikimi i matësit është bërë me kërkesë të klientit dhe gjatë verifikimit të matësit nuk konstatohen pasaktësi, shpenzimet e verifikimit paguhen nga klienti që ka paraqitur ankesën.

18.5 Në rast të ndërhyrjeve në sistemin e matjes nga klienti, me qëllim të manipulimit apo mosrregjistrimit të saktë të energjisë së konsumuar, ndaj tij do të procedohet sipas dispozitave ligjore në fuqi.

18.6 Kur pas verifikimit konstatohen pasaktësi në matës dhe nuk ka prova të dëmtimeve me dashje, të bëra nga klienti, bëhen përlllogaritjet përkatëse të sasisë së energjisë së faturuar më shumë ose më pak, si rezultat i pasaktësisë në matës dhe mënyra e rimbursimit, sipas rregullave dhe procedurave të parashikuara në “Kodin e Matjes”.

18.7 Kur pas verifikimit konstatohen pasaktësi në matës dhe nuk ka prova të dëmtimeve me dashje, të bëra nga klienti, nga ana e operatorit të rrjetit merren masa për zëvendësimin e sistemit të matjes, në përputhje me legjislacionin në fuqi.

Neni 19

Furnizimi dhe karakteristikat e energjisë elektrike

19.1 Furnizuesi do të sigurojë furnizimin të pandërprerë dhe me cilësi të energjisë elektrike. Furnizuesi mund të ndërpresë furnizimin e energjisë elektrike në rastet e mëposhtme:

a) Për shkaqe të forcës madhore - ndërprerje të shkaktuara nga ngjarje të jashtëzakonshme natyrore dhe përcaktimeve të tjera sipas ligjit.

b) Ndërprerje për shkak të urdhrave të Operatorit të Sistemit të Transmetimit;

c) Për efekt të garantimit të sigurisë së jetës, shëndetit dhe pasurisë së personave;

ç) Ndërprerje të planifikuara, për kryerjen e punimeve të mirëmbajtjes, remonteve të programuara të linjave dhe pajisjeve të Sistemit të Shpërndarjes, duke njoftuar paraprakisht sipas afateve të përcaktuara në Rregulloren e Cilësisë së Shërbimit;



d) Ndërprerje të paplanifikuara (të shkurtra apo të gjata) - për shkak të defekteve dhe dëmtimeve të linjave dhe pajisjeve të Sistemit të Shpërndarjes.

19.2 Furnizuesi nuk mban përgjegjësi për ndërprerjet parashikuara në germat “a”, “b”, “c”, të këtij neni. Për ndërprerjet e parashikuara në germat “d” dhe “e” të pikës 19.1, furnizuesi është i detyruar të respektojë normat dhe procedurat e përcaktuara në “Rregulloren për kriteret standarde të cilësisë së shërbimit të Furnizimit dhe performancës së sigurisë së rrjetit të shpërndarjes së energjisë elektrike”.

19.3 Në rast të mosrespektimit të normave dhe procedurave të përcaktuara në “Rregulloren për kriteret standarde të cilësisë së shërbimit të furnizimit dhe performancës së sigurisë së rrjetit të shpërndarjes së energjisë elektrike”, furnizuesi është përgjegjës për kompensimin e klientit, sipas kërkesës së këtij të fundit, në përputhje me procedurën dhe masën e kompensimit të përcaktuara në Rregulloren e mësipërme.

19.4 Në asnjë rast, përfitimi i kompensimit nga ana e klientit, kur plotësohen kushtet e nenit 16.5, nuk e përjashton të drejtën e klientit për të kërkuar në rrugë gjyqësore dëmin efektiv të shkaktuar.

19.5 Furnizuesi do të respektojë parametrat e cilësisë së tensionit, sipas “Kodit të Shpërndarjes së Energjisë Elektrike” dhe parametrat e vendosura në “Rregulloren për kriteret standarde të cilësisë së shërbimit të furnizimit dhe performancës së sigurisë së rrjetit të shpërndarjes së energjisë elektrike”.

19.6 Furnizuesi është përgjegjës për dëmet që mund t'i shkaktohen klientit për shkak të devijimeve të tensionit në kundërshtim me normat e furnizimit të përcaktuara në “Rregulloren për kriteret standarde të cilësisë së shërbimit të furnizimit dhe performancës së sigurisë së rrjetit të shpërndarjes së energjisë elektrike” dhe akteve të tjera në fuqi, në rast se këto dëme vijnë si rezultat i një veprimi apo mosveprimi të drejtpërdrejtë apo me faj të tij.

19.7 Përcaktimi i dëmit efektiv të shkaktuar klientit në rastet e pikës 19.6 bëhet me marrëveshje midis palëve ose në rrugë gjyqësore.

Neni 20

Detyrime të përbashkëta

20.1 Pasi të dyja palët sigurohen për funksionimin normal të skemës së furnizimit dhe të matjes, përfaqësuesi i furnizuesit, në përputhje me

legjislacionin në fuqi, në prezencë të klientit vulos kapakun e morseterisë së matësit dhe elemente të tjera të sistemit të matjes, si dhe regjistron në kontratë:

- Vulën e kapakut të morseterisë _____
- Vulën e boksit individual _____
- Vulën e limitatorit para matësit _____
- Numrin e serisë së matësit _____
- Leximin aktual të tregimit të matësit _____
- Numrin e fazave të matësit _____
- Emrin e kabinës elektrike nga ku furnizohet _____

- Si dhe një skemë të thjeshtë elektrike të furnizimit përfshirë matësin, ku të përcaktohen kufijtë e përgjegjësisë së furnizuesit, si dhe kufijtë e përgjegjësisë së klientit.

20.2 Çdo ndryshim i mëvonshëm i elementeve të përcaktuara në nenin 18 dhe 19 do reflektohen në kontratë.

Neni 21

Ndryshimet e kontratës

21.1 Kushtet e përgjithshme të “Kontratës së Shërbimit Universal të Furnizimit me Energji Elektrike” janë subjekt i ndryshimeve nga ana e ERE-s, sipas të njëjtës procedurë të miratimit të tyre.

21.2 Kjo kontratë hyn në fuqi në datën e përcaktuar nga ERE dhe kushtet e saj bëhen të aplikueshme automatikisht për të gjithë klientët fundorë që kanë të lidhur një kontratë furnizimi në momentin e hyrjes në fuqi të këtij vendimi.

21.3 Në rast të kontestimit të këtyre kushteve nga ana e klientit fundor, ai mund të heqë dorë nga kontrata pa asnjë penalitet, pasi ka ekzekutuar më parë të gjitha detyrimet.

Neni 22

Zgjidhja e mosmarrëveshjeve

Palët do t'i zgjidhin me mirëkuptim mosmarrëveshjet e tyre, në rast të kundërt do t'i drejtohen ERE-s, dhe me pas gjykatës kompetente për zgjidhjen e mosmarrëveshjes.

Neni 23

Legjislacioni i zbatueshëm

Për çështje të cilat nuk rregullohen shprehimisht nga kjo kontratë, do të zbatohen akte të tjera rregullatore që lidhen me furnizimin, si dhe dispozitat e Kodit Civil.



Neni 24
Hyrja në fuqi

Kjo kontratë hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

VENDIM
Nr. 79, datë 3.4.2018

AUTORIZIM I NDIHMËS
SHTETËRORE PËR PROJEKTIN “LINJA
E TRANSMETIMIT 400 KV SHQIPËRI–
MAQEDONI (FIER–ELBASAN–
QAFËTHANË”), I MIRATUAR ME
LIGJIN NR. 101, DATË 9.11.2017

Komisioni i Ndhmës Shtetërore me pjesëmarrjen e:

- Z. Arben Ahmetaj kryetar;
- Znj. Mimoza Dhëmbi anëtar;
- Z. Ahmet Mançellari anëtar;

Në mbledhjen e tij të radhës, të datës 3.4.2018, në Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë, në bazë të ligjit nr. 9374, datë 21.4.2005, “Për ndihmën shtetërore”, të ndryshuar, nenit 28/1, “Autorizimi ex-post i ndihmës” dhe vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 817, datë 28.12.2005, “Për miratimin e rregullores “Për procedurat dhe formën e njoftimit””, vlerësoi përputhjen me rregullat e ndihmës shtetërore të masës referuar ligjit nr. 101, datë 9.11.2017, “Për ratifikimin e Marrëveshjes së garancisë ndërmjet Republikës së Shqipërisë, të përfaqësuar nga Ministria e Financave dhe Ekonomisë, dhe KfW Frankfurt AM Main, në lidhje me Marrëveshjen e Huas ndërmjet Operatorit të Sistemit të Transmetimit, sh.a. (OST) dhe KfW Frankfurt AM Main, për projektin “Linja e transmetimit 400 kV Shqipëri-Maqedoni (Fier–Elbasan–Qafëthanë)”.

1. Procedura

Me shkresën datë 7.2.2018, Sekretariati i Komunitetit të Energjisë (“Sekretariati”) me seli në Vjenë, Austri, i kërkoi Komisionit të Ndhmës Shtetërore vlerësimin sipas rregullave të ndihmës shtetërore të masës referuar ligjit nr. 101, datë 9.11.2017, “Për ratifikimin e Marrëveshjes së garancisë ndërmjet Republikës së Shqipërisë, të përfaqësuar nga Ministria e Financave dhe Ekonomisë dhe KfW Frankfurt AM Main, në lidhje me Marrëveshjen e Huas ndërmjet

Operatorit të Sistemit të Transmetimit, sh.a. (OST) dhe KfW Frankfurt AM Main, për projektin “Linja e transmetimit 400 kV Shqipëri-Maqedoni (Fier–Elbasan–Qafëthanë)”.

2. Përfituesi dhe përshkrimi i masës

Përfituesi

Përfituesi i masës është Operatori i Sistemit të Transmetimit (OST sh.a.). Sistemi i transmetimit të energjisë elektrike në Shqipëri drejtohet nga OST sh.a., një shoqëri publike me 100% të aksioneve shtetërore. OST sh.a. është krijuar në datën 14.7.2004, si rezultat i reformimit dhe ndarjes së Korporatës Elektroenergjetike Shqiptare, nga një shoqëri e organizuar vertikalisht me funksione të gjenerimit, transmetimit dhe shpërndarjes së energjisë elektrike, në tri shoqëri të veçanta.

Objekti i aktivitetit të OST sh.a është⁵:

- Sistemi i transmetimit të energjisë.
 - Operimi i rrjetit të transmetimit të energjisë elektrike nga pikëpamja fizike.
 - Operimi i sistemit të transmetimit nga pikëpamja e dispencerimit.
 - Operimi i tregut të energjisë elektrike.
- OST sh.a. kryen funksionet e Operatorit të Rrjetit të Transmetimit, Operatorit të Sistemit të Dispeçerimit dhe Operatorit të Tregut.

OST garanton kapacitetet e nevojshme transmetuese për:

- furnizimin e pandërprerë me energji elektrike të nënstacioneve të sistemit të shpërndarjes (CEZ shpërndarje) dhe konsumatorëve të energjisë elektrike të lidhur direkt në rrjetin e transmetimit;
- transmetimin e energjisë elektrike të prodhuar nga burimet e vendit;
- si dhe për transitet dhe shkëmbimet e nevojshme me vendet e rajonit.

OST sh.a ka detyrimin të:

- zhvillojë sistemin e transmetimit në përputhje me kërkesat afatgjata të furnizimit të vendit me energji elektrike, me planet e zhvillimit të burimeve të reja të energjisë elektrike dhe koordinon zhvillimin e rrjetit të interkoneksionit me vendet fqinje, dhe
- të dispeçerojë sistemin elektroenergjetik

⁵ Ekstrakt historik i regjistrimit tregtar për të dhënat e subjektit “Shoqëri aksionare” gjendja e regjistrimit, Qendra Kombëtare e Biznesit.



nëpërmjet menaxhimit të flukseve të energjisë në sistem, duke marrë parasysh realizimin e të gjitha shërbimeve ndihmëse që lidhen me qëndrueshmërinë e sistemit, si dhe shkëmbimet me sistemet e tjera.

Përshkrimi i masës

Ligji nr. 101, datë 9.11.2017, “Për ratifikimin e Marrëveshjes së garancisë ndërmjet Republikës së Shqipërisë, të përfaqësuar nga Ministria e Financave dhe Ekonomisë, dhe KfW Frankfurt AM Main, në lidhje me Marrëveshjen e Huas ndërmjet OST sh.a. dhe KfW Frankfurt AM Main, për projektin “Linja e transmetimit 400 kV Shqipëri-Maqedoni (Fier–Elbasan–Qafëthanë)”, përfshin:

- Ndërtimin e linjës së re ajrore 400 kV, Elbasan 2 – Manastir afërsisht 151 km, 56 km në territorin shqiptar;

- Zgjerimin e nënstacionit 40 kV, me zbarre dyfishe 40 kV, dalje të re linje 400 kV dhe një shunt-reaktor 120 MVar;

- Ndërtimin e linjës së re ajrore 400 kV, Elbasan 2 – Fier, rreth 70 km, si dhe dy dalje linje 400 kV në nënstacionin Elbasan 2 dhe nënstacionin Fier;

- Zgjerimin e nënstacionit 220 kV Fier, 1x400 MVA dhe lidhjen me rrjetin e transmetimit.

Projekti përforcon lidhjet interkonjektive me rajonin, duke krijuar kushte për shkëmbime tregtare dhe tranzitime pa kufizim të energjisë elektrike në rajon; zhvillon rrjetin 400 kV në zonën jugore të Shqipërisë, ku parashikohen të zhvillohen burimet e ardhshme të prodhimit të energjisë elektrike dhe, si pjesë e infrastrukturës së Korridorit të Tetë Evropian, krijon mundësi të mira për lidhje nëpërmjet kabllor nënujorë me Italinë.

Projekti do të ketë impakt të rëndësishëm në:

- Krijimin e mundësive tregtare për shkëmbime ekonomike të energjisë elektrike ndërmjet vendeve të rajonit.

- Ndarjen e rezervës së kapaciteteve që do të kontribuojë në një siguri më të madhe të funksionimit të Sistemeve Elektroenergetike të Shqipërisë dhe Maqedonisë.

- Mbështetjen reciproke në raste urgjente.

- Shfrytëzimin optimal të burimeve të rajonit që rezultojnë me kosto më të ulët të energjisë elektrike.

- Përmirësimin e standardeve të përgjithshme, besueshmërisë, cilësisë dhe efikasitetit të sistemit të transmetimit në zonën jugore të Shqipërisë.

- Krijimin e kushteve për lidhje në rrjetin e transmetimit të burimeve të reja (TEC me gaz në zonën Fier-Vlorë me përfundimin e projektit TAP dhe burimeve të rinovueshme diellore dhe me erë).

- Inkurajimin e zhvillimit ekonomik të rajonit jugor të Shqipërisë për shkak të furnizimit më të mirë me energji elektrike.

- Reduktimin e humbjeve të energjisë elektrike në rrjetin e transmetimit.

- Krijimin e mundësive teknike për lidhjen me Italinë nëpërmjet kabllor nënujorë, çka do të rrisë shkëmbimet tregtare të energjisë elektrike ndërmjet Ballkanit dhe Italisë.

3. Objektivi dhe baza ligjore e njoftimit

Objektivi

Ligji nr. 101, datë 9.11.2017, ka si qëllim krijimin e mundësisë për OST sh.a. që të marrë hua me kushte të favorshme nga KfW me vlerë 50.000.000 euro. Huamarrësi do ta përdorë huan ekskluzivisht për investime në infrastrukturën e transmetimit të energjisë elektrike, veçanërisht në projektin “Linja e Transmetimit 400 kV Shqipëri-Maqedoni (Fier–Elbasan–Qafëthanë)”, nënstacionet përkatëse, si dhe për shërbimet e konsulencës për këtë projekt. Projekti, si pjesë e korridorit Lindje-Perëndim, do të mundësojë lidhjen e sistemit shqiptar të energjisë me rajonin.

Baza ligjore

Masa e ndihmës shtetërore jepet në bazë të ligjit nr. 101/2017, “Për ratifikimin e Marrëveshjes së garancisë ndërmjet Republikës së Shqipërisë, të përfaqësuar nga Ministria e Financave dhe Ekonomisë, dhe KfW Frankfurt AM Main, në lidhje me Marrëveshjen e Huas ndërmjet Operatorit të Sistemit të Transmetimit, sh.a. (OST) dhe KfW Frankfurt AM Main, për projektin “Linja e transmetimit 400 kV Shqipëri-Maqedoni (Fier–Elbasan–Qafëthanë)”, i miratuar, mbështetur në:

- Nenin 81, pika 1 dhe 100 e Kushtetutës;

- Nenin 26 dhe 27 të ligjit nr. 9665, datë 18.12.2006, “Për huamarrjen shtetërore, borxhin shtetëror dhe garancitë shtetërore të huas në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, dhe

- Nenin 17 i ligjit nr. 43/2016, “Për marrëveshjet ndërkombëtare në Republikën e Shqipërisë”.

4. Masa e njoftuar e financimit

Garancia shtetërore garanton 100% huan me termat si më poshtë:



- Shuma e huas: 50.000.000 euro e ndarë në dy këste (30.000.000 euro dhe 20.000.000 euro);

- Jetëgjatësia e kredisë: 12 vite, nga të cilat 3 vitet e para pa pagesë principali;

- Norma e interesit: 1,25%, fikse gjatë gjithë jetëgjatësisë së huas;

- Komisioni i angazhimit: 0,25% në vit mbi vlerën e padisbursuar të huas dhe do të jetë efektiv në datën e disbursimit të fundit të huas;

- Tarifë menaxhimi: 1% e shumës së huas (e pagueshme vetëm një herë, referuar nenit 3.2 të Marrëveshjes së Huas).

5. Vlerësimi i ekzistencës së ndihmës shtetërore

5.1 Kualifikimi i masës si ndihmë shtetërore

Në bazë të nenit 4, pika 1, të ligjit nr. 9374, datë 21.4.2005, “Për ndihmën shtetërore”, të ndryshuar, përcaktohet se:

“Përveç rasteve të parashikuara ndryshe në këtë ligj, ndalohet çdo ndihmë e dhënë nga burimet shtetërore, në çfarëdolloj forme e cila, në mënyrë të drejtpërdrejtë ose të tërthortë, shtrembëron ose kërcënon të shtrembërojë konkurrencën duke dhënë përparësi për një ose disa ndërmarrje të caktuara ose për prodhimin e produkteve të caktuara, për aq sa mund të ketë ndikim në plotësimin e detyrimeve të ndërmarrja nga Republika e Shqipërisë në marrëveshjet ndërkombëtare që përmbajnë dispozita të ndihmës shtetërore”.

Neni 18 i Traktatit themelues të Komunitetit të Energjisë në mënyrë të ngjashme parashikon që:

1. “Do të jenë të papajtueshme me funksionimin e duhur të Traktatit, për aq sa mund të ndikojë në tregtinë e energjisë mes palëve kontraktuese: [...]”

c) çdo ndihmë shtetërore që shtrembëron ose kërcënon të shtrembërojë konkurrencën duke favorizuar ndërmarrjet ose burimet e energjisë.

2. Çdo praktikë që bie në kundërshtim me këtë nen do të vlerësohet në bazë të kriterëve që rrjedhin nga zbatimi i neneve 81, 82 dhe 87 të Traktatit themelues të Komunitetit Europian (bashkëlidhur shtojcës III) [aktualisht neni 101, 102 dhe 107 të Traktatit për Funksionimin e Bashkimit Europian].”

Gjithashtu, neni 71 “Konkurrenca dhe dispozita të tjera ekonomike”, i Marrëveshjes së Stabilizim-Asociimit ndërmjet Komuniteteve

Evropiane e shteteve të tyre anëtare dhe Republikës së Shqipërisë⁶, përcakton se:

“Praktikat në kundërshtim me këtë nen vlerësohen në bazë të kriterëve që lindin nga zbatimi i rregullave të konkurrencës të aplikueshme në Komunitet, sidomos në nenet 81, 82, 86 dhe 87 të Traktatit themelues të Komunitetit Europian dhe instrumenteve interpretuese që përdoren nga institucionet e Komunitetit”.

Në përcaktimin nëse një masë përbën ndihmë shtetërore në kuptim të nenit 4 të ligjit të ndihmës shtetërore dhe të nenit 107 (1) të TFEU-së, Komisioni vlerëson plotësimin e kriterëve të mëposhtme:

- masa duhet të jepet nga shteti dhe të përfshijë burimet shtetërore,

- masa duhet të japë një avantazh ndaj ndërmarrjeve të caktuara ose sektorëve të caktuar, si edhe

- masa ndikon në konkurrencë dhe mund të ndikojë në tregtinë midis shteteve anëtare.

Në rastin konkret, ndihma shtetërore e dhënë për OST sh.a. nuk lidhet drejtpërdrejt me shpërbimin për ofrimin e shërbimit publik, por me dhënien e një garancie shtetërore, e cila i mundëson OST sh.a. kryerjen e investimeve të domosdoshme për përmbushjen e detyrimit të OST sh.a.

Komisioni Evropian ka miratuar udhëzimin për zbatimin e rregullave të ndihmës shtetërore të Traktatit për garancitë shtetërore⁷ (në vazhdim: “Njoftimi për garancinë shtetërore”), duke përcaktuar se kriteret e përgjithshme të nenit 107 (1) të TFEU-së zbatohen në mënyrë të barabartë edhe për garancitë shtetërore. Neni 107 (1) i TFEU-së është i transpozuar në nenin 4, pika e ligjit nr. 9374, datë 21.4.2005, “Për ndihmën shtetërore”, të ndryshuar. Në “Njoftimin e garancisë shtetërore” parashikohet se përfitimi për ndërmarrjen nga një garanci shtetërore përbëhet nga fakti se rreziku për ekzekutimin e garancisë shtetërore merret nga shteti.

⁶ Ligji nr. 9590, datë 27.7.2006, “Për ratifikimin e “Marrëveshjes së Stabilizim-Asociimit ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe komuniteteve evropiane e shteteve të tyre anëtare”.

⁷ Commission Notice on the application of Articles 87 and 88 of the EC Treaty to State aid in the form of guarantees, OJ C 155, 20.6.2008, p. 10.



Për të përcaktuar nëse garancia përbën ndihmë shtetërore në kuptim të nenit 4 (1), pika 1 e ligjit nr. 9374, datë 21.4.2005, “Për ndihmën shtetërore”, të ndryshuar, Komisioni vlerëson nëse garancia shtetërore i ofron një avantazh OST sh.a. Siç përcaktohet në “Njoftimin e garancisë shtetërore”, një masë e garancisë shtetërore është ndihmë shtetërore nëse plotësohen të gjitha kushtet për ekzistencën e ndihmës shtetërore dhe nëse do t'i siguronte përfituesit një avantazh që nuk do të ishte marrë në kushtet e tregut.

Për të përcaktuar nëse garancia shtetërore jep një avantazh, Komisioni krahason sjelljen e shtetit me atë të një operatori ekonomik në kushtet e tregut⁸, pra vlerëson “Parimin e Investitorit në ekonominë e tregut”, i cili lidhet me mundësinë e sigurimit të burimeve financiare ekuivalente nga ndërmarrja në tregun financiar.

5.2 Vlerësimi i Garancisë shtetërore

5.2.1 Burimet Shtetërore

Masa aktivizon burime shtetërore, sepse Marrëveshja e Garancisë e lidhur mes Qeverisë Shqiptare (përfaqësuar nga Ministria e Financave dhe Ekonomisë) dhe KfW-së, për të mundësuar financimin e projektit “Linja e transmetimit 400 kV Shqipëri-Maqedoni” i mundëson ndërmarrjes OST sh.a. lidhjen e marrëveshjes së huas me KfW-në për huan në vlerën 50 milionë euro me kushte të favorshme.

Në rast aktivizimi të mundshëm të Garancisë shtetërore, Huamarrësi/OST sh.a., në zbatim të Marrëveshjes së Mirëkuptimit është i detyruar që t'i kthejë Garantuesit (Ministritë së Financave dhe Ekonomisë) të gjitha shumat dhe kostot shtesë që kjo e fundit do t'i ketë paguar Huadhënësit (KfW) në zbatim të Marrëveshjes së Garancisë.

5.2.2 Avantazhi ekonomik

Një avantazh është çdo përfitim ekonomik që një ndërmarrje nuk do të mund ta fitonte në kushte normale të tregut, pra në mungesë të ndërhyrjes së shtetit⁹. Si çdo transaksion tjetër, garancia shtetërore e dhënë nga organet shtetërore për një ndërmarrje të caktuar mund të

përbëjë ndihmë shtetërore, në qoftë se ajo nuk është dhënë me termat e tregut. Nëse Garancia shtetërore është dhënë me terma më të favorshëm se tregu, si dhe duke marrë parasysh edhe gjendjen ekonomike të huamarrësit, atëherë mbështetja shtetërore i jep një përparësi ndërmarrjes. Pra i jepet mundësi huamarrësit të përfitojë hua me një normë interesi të favorshme, e cila nuk do të mund të sigurohej në treg pa një Garanci shtetërore.

Në bazë të “Njoftimit të Garancisë shtetërore”, përfitimi nga një garanci shtetërore është mbulimi nga shteti i riskut të ekzekutimit të garancisë. Risku duhet mbuluar me një prim të arsyeshëm. Kur shteti heq dorë nga e gjitha ose një pjesë e këtij primi, jepet një përfitim për ndërmarrjen, e shoqëruar me një shpenzim/pakësim të burimeve shtetërore¹⁰. Ndihma jepet në momentin kur nënshkruhet garancia shtetërore dhe jo kur kryhen pagesat sipas kushteve të garancisë shtetërore.

Sa më lart, për të përcaktuar nëse një garanci shtetërore ofron një avantazh, Gjykata Evropiane e Drejtësisë ka konfirmuar se Komisioni Evropian duhet të vlerësojë garancinë shtetërore sipas “Parimit të Investitorit në ekonominë e tregut”¹¹.

Për vlerësimin e “Parimit të Investitorit në ekonominë e tregut”, pra që garancia shtetërore të mos përbëjë një ndihmë shtetërore, duhet të përmbushen në mënyrë kumulative kushtet e mëposhtme:

- Një ndërmarrje nuk është në vështirësi;
- Garancia lidhet me një transaksion të veçantë financiar, për një sasi fikse dhe një periudhë kohore fikse;
- Garancia nuk mbulon më shumë se 80% të huas së papërcaktuar ose detyrimit financiar të përfituesit;
- Për garancinë paguhet një çmim i orientuar nga tregu, d.m.th. çmimi i paguar për garancinë është të paktën aq sa niveli përkatës i premiumit të garancisë, që mund të gjendet në tregjet financiare.

⁸ European Court of Justice's case law, Court's judgment in joined cases C-278-280/92, Spain v. Commission.

⁹ Commission Notice on the notion of State aid (2016/C 262/1).

¹⁰ Commission Notice on the application of Articles 87 and 88 of the EC Treaty to State aid in the form of guarantees, pika 2.1. General remarks.

¹¹ Case C-482/99, France v Commission (Stardust), ECLI:EU:C:2002:294.



Nëse garancia shtetërore nuk i plotëson të gjitha kushtet e mësipërme, atëherë masa jep një avantazh siç përcaktohet ligjin nr. 9374, datë 21.4.2005, “Për ndihmën shtetërore”, të ndryshuar.

Ndërmarrja OST sh.a. nuk paguan asnjë prim për garancinë shtetërore (nuk paguan një çmim të orientuar drejt tregut), pra në këtë rast nuk zbatohet “Parimi i Investitorit në ekonominë e tregut”.

Përcaktimi i përparësisë

a) Çmimi i tregut për garancinë shtetërore

Elementi i ndihmës shtetërore do të konsiderohet të jetë diferenca e çmimit të tregut të huas me çmimin aktual të huas së garantuar me Garanci shtetërore¹². Ekuivalenti gjithsej i grantit/ndihmës shtetërore do të skontohej në vlerën aktuale “ekuivalenti cash i grantit për çdo vit” me normën e skontimit referencë 5%¹³.

Komisioni i Ndhmës Shtetërore identifikon:

Çmimin/primin aktual të paguar për Garancinë shtetërore të Huas, çmimin indikativ të tregut për huan, dhe Përfitimin nga Garancia shtetërore e Huas.

i) Lidhur me çmimin/primin aktual të paguar për garancinë shtetërore të huas:

Në bazë të Marrëveshjes së Huas, çmimi aktual i paguar për huan e garantuar me Garanci shtetërore nga OST sh.a. është norma fikse e interesit 1.25%.

ii) Lidhur me çmimin indikativ të tregut për huan e garantuar me Garanci shtetërore:

Çmimi i tregut për huan e garantuar me Garanci shtetërore është llogaritur duke marrë si referencë çmimin indikativ që ofron tregu financiar i Shqipërisë për një hua me terma të ngjashëm. Për të pasur një bazë krahasimi, Komisioni i Ndhmës Shtetërore ka pasur parasysh disa faktorë, si p.sh.: lloji i ndërmarrjes që aplikon për hua në tregun financiar (fushën e veprimtarisë, madhësinë dhe kohëzgjatjen e investimit), transaksionin që kryhet, kushtet e tregut financiar, si dhe kohën kur është kryer transaksioni.

- Çmimi indikativ i tregut për huan e garantuar me Garanci shtetërore

Referencat për çmimin indikativ të tregut janë marrë nga Banka e Shqipërisë¹⁴, duke iu referuar transaksioneve të krahasueshme të tregut për hua me terma të ngjashëm, për investime afatgjata dhe të destinuara për biznesin e madh.

Duke qenë se huaja e garantuar është akorduar me normë interesi fikse për të gjithë jetëgjatësinë e huas, ndërkohë që tregu financiar shqiptar nuk e ofron një mundësi të tillë, çmimi indikativ i tregut është përllogaritur si shuma e normës mesatare të Euriborit 6-mujor me marzhin mesatar të aplikuar nga sektori bankar.

Tabela nr. 1 paraqet normat historike të Euriborit 6 mujor, nga të cilat është përllogaritur norma mesatare prej 2.1%.

Tabela nr. 1: Norma mesatare e Euriborit 6-mujor

Euribor 6m Historical	
2017	-0.259%
2016	-0.165%
2015	0.053%
2014	0.308%
2013	0.336%
2012	0.824%
2011	1.638%
2010	1.083%
2009	1.429%
2008	4.727%
2007	4.349%
2006	3.238%
2005	2.236%
2004	2.149%
2003	2.304%
2002	3.353%
2001	4.159%
2000	4.556%
1999	3.055%
19 Years Average	
	2.1%

¹² 4.2. Aid element in individual guarantees, Commission Notice on the application of Articles 87 and 88 of the EC Treaty to State aid in the form of guarantees.

¹³ I referohet normës së unifikuar e skontimit të përdorur nga Fondi Monetar Ndërkombëtar për llogaritjen e elementit të grantit.

¹⁴bankofalbania.org/web/Normat_nominale_dhe_NEI_per_bizneset_ne_6333_1.php?evn=mon_sel&evb=normat_nominale_biznes&ipb_mon=2&ipb_norma=2



Tabela nr. 2 paraqet marzhet e aplikuar nga sistemi bankar për hua të akorduara ndaj biznesit të madh (marzhet e aplikuar për huat me jetëgjatësi të krahasueshme me huan e garantuar me garanci shtetërore)

Tabela nr. 2: Normat nominale dhe NEI për bizneset

Muaj	BA	BAI	BC	BKSH	BPI	BIS	BKT	BKG	BNT	BPC	BR	BSG	BT	BU	VB
0-12	7	6.35	7.1			6.5		0.07						4	7
13-24	7	6.35				6.5		0.07						4	7
25-36	7	6.35	7.85			6.5		0.07			4.92		2.83	4	7
37-48	7	6.35				6.5		0.07		4.87	5.06			4	7
49-60	7	6.35	6.91			6.5		0.07		4.87	5.03			4	7
61-72	7	6.35				6.5		0.07		4.87	4.95			4	7
73-84	7	6.35	7.2		7.5	6.5	6	0.07		4.87	3.52			4	7
85-96		6.35	7.53		7.5	6.5	4			4.87	6.74			4	7
97-108		6.35			7.5	6.5	5.5			4.87				4	7
109-120		6.35	7.68		7.5	6.5				4.87	3.68			4	7
121-180			5.38							4.5	3.2				
181-240															
241-360															

Marzhi i aplikuar nga 3 banka të nivelit të dytë për hua me qëllime investimi dhe me kohëzgjatje të ngjashme me atë të huas së garantuar me Garanci shtetërore është respektivisht: 5.38% (BC), 4.5% (BPC) dhe 3.2% (BR) ose mesatarisht 4.36%.

Tabela nr. 3 paraqet llogaritjen e marzhit mesatar të aplikuar nga bankat e lartpërmendura, si edhe çmimin indikativ të tregut të përlllogaritur si shuma e marzhit mesatar të aplikuar me normën mesatare të Euriborit 6-mujor.

Për sa më sipër, çmimi indikativ i tregut për hua të ngjashme me huan e garantuar me garanci shtetërore rezulton në vlerën 6,43% (4.36% (marzhi mesatar i aplikuar) + 2,07% (Euribor 6-mujor mesatar)).

Tabela nr. 3 Çmimi indikativ i tregut

Çmimi Indikativ i Tregut		
Çmimi i Tregut	Marzhi i Aplikuar nga Sektori Bankar	Euribor 6m (mesatare historike)
	5.38%	
	4.50%	
	3.20%	
6.43%	4.36%	2.07%

I. Përfitimi nga Garancia shtetërore bazuar në tregun financiar

Komisioni i Ndihmës Shtetërore llogarit përfitimin nga garancia shtetërore e huas për projektin “Linja e Transmetimit 400 kV Shqipëri-Maqedoni” në monedhën euro.

Përfitimi nga Garancia shtetërore e huas përlllogaritet si diferencë e vlerës së skontuar të interesave (vlera aktuale/present value) të gjeneruar me normën e tregut (6.43%) me atë të interesave të gjeneruar me normën aktuale të huas së garantuar (1.25%).

Nga përlllogaritjet rezulton se përfitimi nga garancia shtetërore e huas në terma aktualë është rreth 15,74 milionë euro (referencë tabela nr. 4).



Tabela nr. 4: Përfitimi nga Garancia shtetërore e huas

Përfitimi nga Garancia Shtetërore e Huasë për Projektin "Linja e Transmetimit 400 kV Shqipëri-Maqedoni"					
Periudha	Amortizimi i Huasë	Ripagesat FV	Interesat FV	Çmimi Indikativ i Tregut - Normën Aktuale	Përfitimi në Vlerë Aktuale
0	50,000,000	-	-	5.18%	-
0.5	50,000,000	-	1,295,000.00	5.18%	1,263,790.594
1	50,000,000	-	1,295,000.00	5.18%	1,233,333.333
1.5	50,000,000	-	1,295,000.00	5.18%	1,203,610.090
2	50,000,000	-	1,295,000.00	5.18%	1,174,603.175
2.5	50,000,000	-	1,295,000.00	5.18%	1,146,295.324
3	47,368,421	2,631,578.95	1,295,000.00	5.18%	1,118,669.690
3.5	44,736,842	2,631,578.95	1,226,842.11	5.18%	1,034,251.420
4	42,105,263	2,631,578.95	1,158,684.21	5.18%	953,252.368
4.5	39,473,684	2,631,578.95	1,090,526.32	5.18%	875,556.758
5	36,842,105	2,631,578.95	1,022,368.42	5.18%	801,052.410
5.5	34,210,526	2,631,578.95	954,210.53	5.18%	729,630.631
6	31,578,947	2,631,578.95	886,052.63	5.18%	661,186.116
6.5	28,947,368	2,631,578.95	817,894.74	5.18%	595,616.842
7	26,315,789	2,631,578.95	749,736.84	5.18%	532,823.976
7.5	23,684,211	2,631,578.95	681,578.95	5.18%	472,711.779
8	21,052,632	2,631,578.95	613,421.05	5.18%	415,187.514
8.5	18,421,053	2,631,578.95	545,263.16	5.18%	360,161.356
9	15,789,474	2,631,578.95	477,105.26	5.18%	307,546.307
9.5	13,157,895	2,631,578.95	408,947.37	5.18%	257,258.111
10	10,526,316	2,631,578.95	340,789.47	5.18%	209,215.175
10.5	7,894,737	2,631,578.95	272,631.58	5.18%	163,338.483
11	5,263,158	2,631,578.95	204,473.68	5.18%	119,551.528
11.5	2,631,579	2,631,578.95	136,315.79	5.18%	77,780.230
12	0	2,631,578.95	68,157.89	5.18%	37,952.866
Total	50,000,000.00	50,000,000.00	19,425,000.00		15,744,376.08

Shënim: Norma e aplikuar për skontimin e interesave është marrë 5%¹⁵.

Mbështetur në tabelën nr. 4, Komisioni i Ndihmës Shtetërore shprehet se çmimi inidikativ i ofruar nga bankat e nivelit të dytë në Shqipëri përbën një bazë të arsyeshme për vlerësimin e huas pa garanci shtetërore në kushtet e tregut.

Siç vërehet nga tabela nr. 4, bankat e nivelit të dytë për hua me kohëzgjatje deri në 12 vite ofrojnë një normë mesatare vjetore 6.43%, pra një normë aktuale tregu më të lartë se norma fikse e interesit të huas së garantuar me garanci shtetërore prej 1.25%.

Për sa më lart, çmimi i tregut 6.43% i kredisë i jep përfituesit një avantazh ekonomik në vlerën 15,74 milion euro.

Lidhur me kolateralin e huas, Ministria e Financave dhe Ekonomisë ka bërë një angazhim për të siguruar kolateral të plotë për çdo kësht të lëvrimit të huas (garanci sovranë).

Për sa më lart, Komisioni shprehet se çmimi për huan e garantuar me garanci shtetërore është më i ulët se çmimi inidikativ i tregut (Euribor 6-mujor + marzh) për një hua me karakteristika të ngjashme jo të garantuar, duke konkluduar që garancia shtetërore përbën ndihmë shtetërore.

II. Përfitimi nga garancia shtetërore bazuar në standardin e Fondit Monetar Ndërkombëtar

Metodologjia e Fondit Monetar Ndërkombëtar përcakton një normë të vetme dhe të unifikuar të skontimit (5%) për të llogaritur elementin e grantit të kredive individuale. Sipas saj, elementi i grantit (në përqindje) - mat nivelin e koncesionit, të "butësisë" të një kredie, që pasqyron dobinë për huamarrësin krahasuar me një hua me normë tregu.

Elementi i grantit është diferenca midis vlerës nominale dhe shumës së pagesave të skontuara të shërbimit të borxhit (vlera aktuale neto) që do të bëhen nga huamarrësi, të shprehura si përqindje e vlerës nominale të huas. Kur norma e interesit për një hua është më e ulët se norma e skontimit, vlera aktuale e huas rezulton më e vogël se vlera e tij nominale, me diferencën që pasqyron elementin e grantit të huas.

Mbështetur në marrëveshjen e huas me garanci shtetërore, të dhënat për elementin e grantit janë si më poshtë:

- Norma e skontimit = 5%
- Profili i ripagesave = kësht të barabarta vjetore
- Vlera e huas = 50 000 000 euro
- Tarifë menaxhimi = 1.0%
- Norma e interesit = 1.25%
- Jetëgjatësia = 12 vite
- Numri i pagesave vjetore = 2 pagesa
- Periudha pa pagesë principali = 3 vite

¹⁵ Referuar normës së unifikuar të skontimit të përdorur nga FMN-ja për përllogaritjen e elementit grant.



Në aneks të këtij vendimi, tabela nr. 1 llogarit elementin e grantit (në përqindje). Mbështetur në të dhënat e huas, elementi i grantit rezulton të jetë 17.25%. Kjo do të thotë se OST sh.a. në vlerë aktuale do t'i paguaj kreditorit (KfW) 17.25% më pak se vlera e huas së marrë.

Në përfundim, Komisioni i Ndhmës Shtetërore shprehet se garancia shtetërore përbën ndihmë shtetërore, sepse pika d) e “Parimit të Investitorit në ekonominë e tregut”¹⁶ nuk plotësohet.

Selektiviteti

Masa është selektive, duke qenë se përparësia i jepet vetëm një ndërmarrjeje të veçantë, OST sh.a.

Efekti në konkurrencë dhe ndikimi në tregti:

Komisioni vlerëson se projekti mundëson krijimin e infrastrukturës së nevojshme, e cila do të kontribuojë në ndërlidhjen midis vendeve të rajonit, gjithashtu i ofron akses palëve të treta sipas rregullave të aksesit në rrjet të miratuara nga ERE, dhe në këtë mënyrë rrit indirekt konkurrencën në tregun e furnizimit me energji elektrike. Si një projekt infrastrukturor në rajonin perëndimor të Ballkanit, linja do të lehtësojë ndërlidhjen me sistemet e energjisë elektrike të vendeve fqinje dhe përfundimisht do të kontribuojë në rritjen e tregtisë së energjisë elektrike në rajon. Komisioni i Ndhmës Shtetërore shprehet se efektet e mundshme të konkurrencës dhe efektet në tregti që rezultojnë nga masa e ndihmës janë të kufizuara dhe tejkalohen nga dobia/përmirësimet në rrjetin e transmetimit të energjisë elektrike dhe rritjen e konkurrencës ndërmjet furnizuesve të energjisë elektrike në nivel ndërkombëtar.

6. Vlerësimi i përputhshmërisë së ndihmës shtetërore në bazë të nenit 13, pika 3 e ligjit nr. 9374, datë 21.4.2005 “Për ndihmën shtetërore”

Objekti kryesor i ndihmës shtetërore është zhvillimi i rrjetit të transmetimit të energjisë elektrike/sistemit të transmisionit dhe përmirësimit të ndërlidhjes së saj me Maqedoninë, duke kontribuar në përmirësimin e infrastrukturës ekzistuese për funksionimin e tregut të brendshëm të energjisë elektrike në rajon.

Komisioni i Ndhmës Shtetërore vlerëson përputhshmërinë e masës me tregun e brendshëm, duke u mbështetur në kontributin që

jep në zhvillimin e tregut të energjisë elektrike në vend dhe rajon, mbështetur në nenin 13, pika 3 të ligjit nr. 9374, datë 21.5.2005, “Për ndihmën shtetërore”, të ndryshuar, i cili parashikon se ndihma shtetërore lejohet nëse:

“lehtëson zhvillimin e veprimtarive të caktuara ekonomike ose zhvillimin e zonave të caktuara ekonomike, deri në atë masë sa kjo ndihmë nuk është në kundërshtim me detyrimet e marrëveshjeve ndërkombëtare të ratifikuara nga Republika e Shqipërisë”.

Masa e ndihmës shtetërore vlerësohet se është në përputhje me nenin 13, pika 3 të ligjit nr. 9374, datë 21.5.2005, “Për ndihmën shtetërore”, të ndryshuar, nëse është e nevojshme, proporcionale dhe nëse efektet pozitive për objektivin e saj janë më të mëdha se efektet negative që lidhen me pasojat në konkurrencë dhe tregti. Komisioni i Ndhmës Shtetërore në përputhje udhëzimin “Për ndihmën shtetërore për mbrojtjen e mjedisit dhe të energjisë 2014-2020 të Komisionit Evropian”¹⁷, vlerëson nëse:

- Masa e ndihmës synon në arritjen e një qëllimi të përcaktuar mirë dhe me interes të përbashkët:

- masa e ndihmës ka qëllim me interes të përbashkët;

- ka nevojë për ndërhyrje shtetërore.

- Ndhma jepet për të arritur një objektiv me interes të përbashkët, pra ndihma është një instrument i përshtatshëm dhe i domosdoshëm:

- ka efekt nxitës;

- masa është proporcionale;

- Efektet në konkurrencë dhe tregti janë të kufizuara;

- Ndhma është transparente.

- Objektivi me interes të përbashkët

Në përputhje me nenin 71 të MSA-së, “Praktikat në kundërshtim me këtë nen vlerësohen në bazë të kriterëve që lindin nga zbatimi i rregullave të konkurrencës të aplikueshme në Komunitet, sidomos në nenet 81, 82, 86 dhe 87 të Traktatit themelues të Komunitetit Europian dhe instrumenteve interpretuese që përdoren nga institucionet e Komunitetit. Më konkretisht, neni

¹⁶ d) “Një çmim i orientuar nga tregu paguhet për garancinë, d.m.th. çmimi i paguar për garancinë është të paktën aq sa niveli përkatës i premiumit të garancisë që mund të gjendet në tregjet financiare”.

¹⁷ Community framework for state aid for research and development and innovation (OJ C 323, 30.12.2006, p. 1), point 1.3; Community guidelines on State aid for environmental protection (OJ C 82, 1.4.2008, p. 1), point 1.3.



194 i TFEU-së¹⁸, kapitulli 21, parashikon se në kuadrin e krijimit dhe funksionimit të tregut të brendshëm dhe nisur nga nevoja për ruajtjen dhe përmirësimin e mjedisit, politika e BE-së për energjinë synon në frymën e solidaritetit midis shteteve anëtare:

a) të sigurojë funksionimin e tregut të energjisë;

b) të sigurojë sigurinë e furnizimit me energji në Bashkimin Evropian;

c) të nxisin efikasitetin e energjisë, kursimin e energjisë dhe zhvillimin e formave të reja dhe të rinovueshme të energjisë; dhe

d) të nxisin ndërlidhjen e rrjeteve energjetike.

Neni 2 i Traktatit për themelimin e Komunitetit të Energjisë parashikon se ka për qëllim të:

a) të krijojë një kornizë të qëndrueshme rregullore për tregun me qëllim tërheqjen e investimeve në rrjetet e gazit, prodhimin e energjisë dhe rrjetet e transmetimit dhe të shpërndarjes, në mënyrë që të gjitha palët të kenë akses në furnizimin e qëndrueshëm dhe të vazhdueshëm të energjisë, që është kushti kryesor për zhvillimin ekonomik dhe stabilitetin e shoqërisë;

b) të krijojë një hapësirë të vetme rregullative për tregtinë në Rrjetin e Energjisë që është e nevojshme për të lidhur tregjet e produkteve;

c) të rrisë sigurinë e furnizimit të hapësirës së vetme rregullore, duke siguruar një klimë të qëndrueshme investimi në të cilën mund të zhvillohen lidhjet me rezervat e gazit në Kaspik, Afrikën e Veriut dhe Lindjen e Mesme, në mënyrë që të shfrytëzohen burimet indigjene të energjisë si gazi natyror, qymyri dhe hidrocentralet;

d) të përmirësojë situatën mjedisore në rrjetin energjik dhe eficiencën e energjisë, të nxisë përdorimin e energjisë së rinovueshme dhe të përcaktojë kushtet për tregtinë e energjisë në hapësirën e vetme rregullore;

e) të zhvillojë konkurrencën e tregut në rrjetin energjik në një shkallë sa më të gjerë gjeografike dhe të shfrytëzojë ekonomitë e shkallës.

Duke qenë se objektivi kryesor i ndihmës shtetërore të dhënë për OST sh.a. është zhvillimi i rrjetit të transmetimit të energjisë elektrike

(sistemit të transicionit) dhe përmirësimi i ndërlidhjes së saj, pra përmirësimin e infrastrukturës ekzistuese për funksionimin e tregut të brendshëm të energjisë elektrike në rajon, Komisioni vlerëson se masa e ndihmës shtetërore ka qëllim të përcaktuar mirë, që respekton rregullat e krijuara dhe të pranuar nga BE-ja.

Sipas udhëzimit për Ndhimën Shtetërore për Mbrojtjen e Mjedisit dhe Energjisë 2014-2020, të cilat janë gjithashtu të zbatueshme për këtë rast, në bazë të miratimit të saj nga Komuniteti i Energjisë¹⁹, paragrafi 202 thekson qartë se “Ndhima për infrastrukturën e energjisë forcon tregun e brendshëm të energjisë. Ai rrit qëndrueshmërinë e sistemit, mjaftueshmërinë e gjenerimit, integrimin e burimeve të ndryshme të energjisë dhe furnizimin me energji në rrjetet e pazhvilluara [...] është e dobishme për tregun e brendshëm dhe kështu kontribuon në një objektiv me interes të përbashkët”.

- Nevoja për ndërhyrjen e shtetit

Investimet në infrastrukturën e energjisë si ky projekt karakterizohen nga dështimet e tregut, të cilat lidhen me problemet e koordinimit. Kjo do të thotë që nga njëra anë interesat e ndryshëm mes investitorëve, pasiguria në lidhje me rezultatin final dhe efektet në rrjetin e energjisë mund të pengojnë zhvillimin e një projekti; dhe nga ana tjetër, ky projekt mund të gjenerojë eksternalitete pozitive, nga ku kostot dhe përfitimet e infrastrukturës mund të gjenerohen në mënyrë asimetrike midis aktorëve të ndryshëm të tregut dhe vendeve të përfshira²⁰. Probleme të tilla nuk mund të korrigjohen nëpërmjet financimit të projektit vetëm me anë të vendosjes së tarifave. Prandaj, ndihma shtetërore është e nevojshme për të përballuar këto dështime në treg.

- Instrumenti i duhur

Në këtë rast, tregu financiar nuk ofron të njëjtën mbështetje nëse ndërmarrja do kishte aplikuar direkt në treg për të gjetur burime financiare për projektin (duke pasur parasysh qëllimin e saj në sigurimin e një mbështetje të

¹⁹ Policy Guidelines on the Applicability of the Guidelines on State Aid for Environmental Protection and Energy 2014-2020 PG 04/2015 / 24 November 2015.

²⁰ Guidelines on State aid for environmental protection and energy 2014-2020, para. 203.

¹⁸ eur-lex.europa.eu/legal-content/EN/TXT/

?uri=celex%3A12012E%2FTXT



fortë financiare për kryerjen e investimeve të mëdha dhe sigurimin e furnizimit me energji elektrike në rajon). Përfituesi është i vetmi operator i sistemit të transmetimit të energjisë elektrike në Shqipëri, që do të thotë se asnjë operator tjetër nuk mund të sigurojë ofrimin e shërbimit të transmetimit të energjisë me cilësi dhe në kohë në të gjithë Republikën e Shqipërisë. Për më tepër, masa ka të bëjë me ndërtimin e kapacitetit rezervë për një rrjet ri, i cili do të jetë i integruar me atë të vendeve të tjera të rajonit. Ndihma shtetërore me garanci shtetërore është një instrument i përshtatshëm për të mundësuar ndërtimin e një rrjeti të ri të transmetimit të energjisë elektrike, pra për të arritur efektet e dëshiruara në kushtet e rezervës së energjisë elektrike dhe sigurisë së furnizimit me energji elektrike në vend.

- Efekti nxitës

Përfituesi është i detyruar në bazë ligjit të energjisë elektrike dhe të modelit të tregut²¹ të sigurojë transmetimin e energjisë elektrike me çmim të rregulluar nga Enti Rregullator i Energjisë (ERE), për të siguruar furnizimin në rrjet me energji elektrike. Masa e ndihmës siguron efektin e nevojshëm nxitës, sepse projekti nuk do të realizohej pa garanci shtetërore të huas. Garancia ishte një parakusht për dhënien e huas, prandaj projekti nuk do të realizohej pa të.

- Proporcionaliteti

Një masë e ndihmës shtetërore është proporcionale nëse masa kërkon ndihmë shtetërore në vlerë të limituar. Komisioni konsideron se e gjithë kostoja e investimit konsiderohet e pranueshme dhe se asnjë investim tjetër i ngjashëm/i këtij lloji nuk do të realizohej pa ndihmë shtetërore për një ndërmarrje të vetme, pra ndihma shtetërore është e kufizuar në minimum.

- Efekti në konkurrencë

Një masë e ndihmës shtetërore është e pajtueshme me tregun e brendshëm nëse rezulton se efektet janë të limituara në funksion të arritjes së interesit të përbashkët. OST sh.a., në bazë të modelit të tregut, është operatori i vetëm

i rrjetit të transmetimit të energjisë elektrike dhe se nuk konkurron me ndërmarrje të tjera në këtë treg. Infrastruktura e re që do të ndërtohet do të funksionojë duke i ofruar akses palëve të treta sipas rregullave të aksesit në rrjet të miratuara nga ERE, pra duke siguruar përfitime në të ardhmen nga shfrytëzimi i saj edhe nga klientët e ardhshëm. Efekti në konkurrencë është i kufizuar duke pasur parasysh edhe se projekti synon krijimin e mundësive tregtare për shkëmbime të energjisë elektrike nëpërmjet vendeve të rajonit, me qëllim sigurimin e furnizimit me energji elektrike.

Sa më lart, Komisioni i Ndhmës Shtetërore shprehet se ndihma shtetërore për realizimin e projektit “Linja e transmetimit 400 kV Shqipëri-Maqedoni (Fier–Elbasan–Qafëthanë)”, është e nevojshme, proporcionale dhe se efektet pozitive të realizimit të saj janë më të mëdha se efektet negative.

- Transparenca

Publiku dhe operatorët ekonomikë duhet të kenë akses në informacion për ndihmën shtetërore. Meqenëse garancia shtetërore është miratuar nga parlamenti dhe është e botuar në Fletoren Zyrtare, kjo kërkesë është respektuar.

Konkluzion

Sa më lart, Komisioni arrin në përfundimin se masa e njoftuar është ndihmë shtetërore, por është në përputhje me ligjin nr. 9374, datë 21.4.2005, “Për ndihmën shtetërore”, të ndryshuar, neni 13, pika 3 “Ndhma shtetërore që mund të lejohet”, sepse lehtëson zhvillimin e veprimtarive të caktuara ekonomike ose zhvillimin e zonave të caktuara ekonomike, deri në atë masë sa kjo ndihmë nuk është në kundërshtim me detyrimet e marrëveshjeve ndërkombëtare të ratifikuara nga Republika e Shqipërisë.

PËR KËTO ARSYE:

Komisioni i Ndhmës Shtetërore, në bazë të nenit 4, 17, 20, 22, dhe 31 të ligjit nr. 9374, datë 21.4.2005, “Për ndihmën shtetërore”, të ndryshuar,

VENDOSI:

1. Të autorizojë ndihmën shtetërore për zbatimin e projektit “Linja e Transmetimit 400 kV Shqipëri-Maqedoni”, të parashikuar në ligjin nr. 101/2017, “Për ratifikimin e Marrëveshjes së Garancisë ndërmjet Republikës së Shqipërisë, të

²¹ VKM nr. 519, datë 13.7.2016, “Për miratimin e modelit të tregut të energjisë elektrike”, pika 3. “Rolet e modelit të tregut”, nën-pika 3.1, “Operatori i Sistemit të Transmetimit (OST)”.



përfaqësuar nga Ministria e Financave dhe Ekonomisë, dhe KfW Frankfurt AM Main, në lidhje me Marrëveshjen e Huas ndërmjet Operatorit të Sistemit të Transmetimit, sh.a. (OST) dhe KfW Frankfurt AM Main, për projektin “Linja e transmetimit 400 kV Shqipëri-Maqedoni (Fier–Elbasan–Qafëthanë)”, mbështetur në nenin 13, pika 3 e ligjit nr. 9374, datë 21.4.2005, “Për ndihmën shtetërore”, të ndryshuar, sepse lehtëson zhvillimin e veprimtarive të caktuara ekonomike ose zhvillimin e zonave të caktuara ekonomike, deri në atë masë sa kjo ndihmë nuk është në kundërshtim me detyrimet e marrëveshjeve ndërkombëtare të ratifikuara nga Republika e Shqipërisë.

2. Ministria e Financave dhe Ekonomisë brenda datës 31 mars të çdo viti të paraqesë raport për

impaktin e ndihmës shtetërore gjatë vitit paraardhës financiar, si edhe të japë çdo informacion që do të kërkohej për monitorimin dhe kontrollin e ndihmës së dhënë. Të gjitha të dhënat për zbatimin e skemës të ruhen deri në dhjetë vjet, pasi ndihma e fundit individuale të jetë dhënë në kuadër të kësaj skeme.

3. Ministria e Financave dhe Ekonomisë bazuar në nenin 20, pika 1 të ligjit nr. 9374, datë 21.4.2005, “Për ndihmën shtetërore”, duhet të marrë miratimin paraprak të KNSH-së në rastin eventual të çdo ndryshimi të skemës së njoftuar.

4. Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETAR
Arben Ahmetaj

ANKESË

Tabela nr. 1: Elementi i grantit (në përqindje)

Discount Rate (in percent)	Unified discount rate (5%)
Discount Rate (in percent)	Unified discount rate (5%) ▼
Repayment profile	Equal principal payment ▼
Face value of loan	50,000,000
Grant (as part of financing package)	0
Upfront commission (in percent)	0 %
Management fees	Amount in percent of outstanding loan ▼
	1 %
Interest rate (in percent)	1.25 %
Maturity (in years)	12
Payments per annum	2 ▼
Grace period (in years)	3

Elementi i grantit (në përqindje)	17.25 %
-----------------------------------	---------

**VENDIM****Nr. 4, datë 23.3.2018**

Bazuar në ligjin nr. 8457, datë 11.2.1999, “Për informacionin e klasifikuar “Sekret shtetëror””, të ndryshuar, si dhe vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 662, datë 15.11.2017, “Për miratimin e rregullores për deklasifikimin dhe zhvlerësimin e informacionit të klasifikuar “Sekret shtetëror”, KDZH, i ngritur me urdhër nr. 389, datë 20.11.2017, të Drejtorit të Përgjithshëm të Arkivave, u mblodh me datë 23.3.2018 dhe, pasi shqyrtoi relacionin e paraqitur nga Sektori i Dokumentacionit pas viteve 1944,

VENDOSI:

1 - Deklasifikimin plotësisht të informacioneve (dosjeve) të klasifikuara “Sekret shtetëror”, si më poshtë:

- Fondi nr. 511 (Ministria e Arsimit dhe Kulturës), viti 1974

Dosjet nr. 1,2,3,4,5,6,7,8,9,10,11,12,13,14,15,16,17,18,19,20,21,22,23,24,25,26,27,28,29,30,31,32,33,34,35,36,37,38,39,40,41,42,43,44,45,46,47,48,49,50,51,52,53,54,54/1,55,56,57,58,59,60,61,62,63,64,65,66,67,68,69,70,72,73,74,75,76,77,78,79,80,81,82,83,84,85,86,7,88,89,90,91,92,93,94,95,96,97,98,99,100,101,102,103,104,105,106,107,108,109,110,111,112,113,114,115,116,117,118,119,120,121,122,123,124,125,126,127,128,129,130,131,132,133,134,135,136,137,138,139,140,141,142,143,144,145,146,147,148,149,150,151,152,153,154,155,156,157,158,159,160,161,162,163,164,165,166,167,168,169,170,171,172,173,174,175,176,177,178,179,180,181,182,183,184,185,186,187,188,189,189/1,190,191,192,193,194,195,196,197,198,199,200,201,202,203,204,205,206,207,208,209,210,211,212,213,214,215,216,217,218,219,220,221,222,223,224,225,226,226/1,227,228,229,230,231,232,233,234,235,236,237,238,238/1,239,246(7),250(11),257(18),261(22),264(25).

Niveli i klasifikimit, “Sekret”.

- Fondi nr. 511 (Ministria e Arsimit dhe Kulturës), viti 1975.

Dosjet nr. 1,2,3,4,5,6,7,8,9,10,14,15,16,17,18,19,20,21,22,23,24,25,26,27,28,29,30,31,32,33,34,35,36,37,38,39,40,41,42,43,44,45,46,47,48,49,50,51,52,53,54,55,56,57,58,59,60,61,62,63,64,65,66,67,68,69,70,71,72,77,78,79,80,81,82,83,84,85,86,87,88,89,90,91,92,93,94,95,96,97,98,99,100,101,115,1

16,119,120,121,122,123,123/1,124,125,126,127,128,129,130,131,131/1,132,132/1,133,134,135,136,137,138,138/1,138/2,138/3,139,140,141,142,143,144,145,146,147,148,149,150,151,152,153,154,155,156,157,158,159,160,161,162,163,164,165,166,167,168,169,169/1,169/2,170,170,170/1,171,172,173,174,175,176,177,178,179,180,181,182,183,184,184/1,185,186,187,188,189,190,191,192,193,194,195,196,197,198,199,200,201,201/1,202,203,204,205,206,209,210,211,212,213,214,215,216,217,218,219,220,221,222,223,224,225,226,227,229,230,231,232,233,234,239,240,240/1.

Niveli i klasifikimit, “Sekret”.

- Fondi nr. 511 (Ministria e Arsimit dhe Kulturës), viti 1976.

Dosjet nr. 1,2,3,4,5,6,7,8,9,10,11,112,13,14,15,16,17,18,19,20,21,22,23,24,25,26,27,28,29,30,31,32,33,34,35,36,37,38,39,40,41,42,43,44,45,46,47,48,49,50,51,52,53,54,55,56,57,58,59,60,61,62,63,64,65,66,67,68,69,70,71,72,73,74,75,76,77,78,79,80,81,82,83,84,85,86,87,88,89,90,91,92,93,94,95,96,97,98,99,100,101,102,103,104,105,106,107,108,109,110,111,112,113,114,115,116,117,118,119,120,121,122,123,124,125,126,127,128,129,130,131,132,133,134,135,136,137,138,138/1,139,140,141,142,143,144,145,146,147,148,149,150,151,152,153,154,155,156,157,158,159,160,161,162,163,164,165,166,167,168,169,169/1,169/2,170,171,172,173,174,175,175/1,176,177,178,178/1,179,180,181,182,183,184,184/1,185,186,187,188,189,190,191,192,193,194,195,196,197,198,199,200,201,202,203,204,205,206,207,208,209,210,211,212,213,214,215,216,217,217/1,217/2,218,218/1,219,220,221,222,223,224,225,226,227,228,229,230,231,232,233,234,235,236,237,238,239,240,241,242,243,244,245,246,247,248,249,20,251,252,253,254.

Niveli i klasifikimit, “Sekret”.

- Fondi nr. 511 (Ministria e Arsimit dhe Kulturës), viti 1977.

Dosjet nr. 1,2,3,4,5,6,7,8,9,10,11,12,13,14,15,16,17,18,19,20,21,22,23,24,25,26,27,28,29,30,31,32,33,34,35,36,37,38,39,40,41,42,43,44,45,46,47,48,49,50,51,52,53,54,55,56,57,58,59,60,61,62,63,64,64/1,65,66,69,72,73,77,78,79,80,84,85,92,93,95,96,100,102,103,104,105,106,109,110,112,113,116,118,119,125,127,128,129,130,131,132,139,140,141,142,145,146,147,148,153,154,156,157,158,159,160,161,162,168,171,172,173,174,175,176,177,178,179,180,181,182,184,185,187,188,189,190,191,192,193,194,195,196,197,198,199,200,201,202,203,204,205,206,207,207/1,207/2,208,208/1,208/2,209,211,211/1,211/2,213,21



4,225,225/1,226,226/1,228,228/1,230,233,234,236, 237,237/1,237/2,238,239,240,241,242,243,244,245, 246,247,248,249,250,251,254,255,259,263,272,273, 274,274/1,276,277,278,279,280,281,282,283,284.

Niveli i klasifikimit, “Sekret”.

- Fondi nr. 511 (Ministria e Arsimit dhe Kulturës), viti 1978.

Dosjet nr. 1,2,3,4,5,6,7,8,9,10,11,12,13,14,15,16, 16,17,18,19,20,21,22,27,28,29,30,31,32,40,41,42,43, 44,53,77,81,88,89,90,98,98/1,99,100,101,102,103,1 04,105,106,133,143,144,152,153,154,155,156,157,1 58,159,160,161,162,168,169,178,178/1,178/2,179,1 780,180/1,181,182,183,187,188,189,190,191,191/1, 192,193,194,195,196,197,198,199,200,201,202,202/ 1,203,204,205,206,207,208,209,210,211,212,213,21 4,215,216,217,218,219,220,221,222,223,224,225,22 5/1,226,230,232,235,236,237,238,239,241,242,242/ 1,243,244,245,246,251.

Niveli i klasifikimit, “Sekret”.

- Fondi nr. 511 (Ministria e Arsimit dhe Kulturës), viti 1979.

Dosjet nr. 1,2,3,4,5,6,7,8,9,10,11,12,13,14,15,16, 17,18,19,20,21,22,23,24,25,26,27,29,30,31,32,35,41, 42,43,44,45,48,49,50,51,52,59,60,63,65,67,71,75,76, 77,78,79,81,82,85,86,87,89,92,93,99,100,101,102,10 3,104,105,106,107,108,109,110,113,117,128,129,13 0,132,133,134,135,140,142,,145,149,150,151,153,15 4,155,156,157,159,163,170,170/1,170/2,170/3,170 /4,171,179,180,183,185,188,189,190,191,193,196,1 97,199,200,201,201/1,202,203,204,205,205/1,206,2 07,208,209,210,211,212,213,214,215,216,217,217/1 ,218,219,220,221,223,224,225,226,227,228,229,230, 231,232,233,234,235,236,237,238,239,240,241,242, 243,244,245,246,247,248,249,250,251,252,253,254, 254/1,255,256,257,258,259,260,261,262,263,264,26 5,266,267,268,269,270,271,272,273,274,275,276,27 7,278,279,279/1,279/2,279/3,280,281,282,287,288, 290,293.

Niveli i klasifikimit, “Sekret”.

- Fondi nr. 511 (Ministria e Arsimit dhe Kulturës), viti 1980.

Dosjet nr. 1,2,3,4,5,6,7,8,9,10,11,12,13,14,15,16, 17,18,19,20,21,22,23,24,25,26,27,28,29,30,31,32,33, 34,35,36,37,38,39,40,41,42,43,44,45,46,47,48,48/1,4 9,50,51,52,53,54,55,56,57,58,59,60,61,62,63,64,65,6 6,67,68,69,70,71,72,73,74,75,76,77,78,79,80,81,82,8 3,84,85,86,87,88,89,90,91,92,93,99,100,100/1,101,1 02,103,105,106,107,108,109,110,111,112,114,115,1 16,117,118,167,168,169,170,171,172,173,174,175,1 76,179,180,181,182,183,184,185,186,186/1,187,188

,189,190,191,192,193,194,195,196,202,203,203/1,2 04,205,206,207,208,210,210/1,211,213,215,216,218 ,219,220,221,222,223,224,225,226,227,228,229,230, 231,232,233,234,235,235/1,236,237,238,239,240,24 1,242,243,244,246,247,248,249,250,251,252,253,25 4,255,256,257,258,259,260,261,262,263,264,265,26 7,268,269,270,271,272,273,274,275,276,278,279,28 0,281,282,283,284,285,286,287,288,289,290,291,29 2,293,294,295,296,297,298,299,300,300/1,300/2,30 0/3,300/4,301,301/1,302,303,304,305,306,307,309, 310,311,312,313,314,315,316,317,318,319,320,321, 322,323,324,325,326,327,328,329,330,331,332,333, 334,335,336,337,338,339,340,341,342,343,345,346, 347,348,349,352,353,354.

Niveli i klasifikimit, “Sekret”.

- Fondi nr. 511 (Ministria e Arsimit dhe Kulturës), viti 1981.

Dosjet nr. 1,2,3,4,5,6,7,8,9,10,11,12,13,14, 15,16,17,18,19,20,21,23,24,25,26,27,28,29,30,31,32, 33,34,35,36,37,38,38/1,39,40,41,42,43,44,45,46,7,48 ,49,50,51,53,55,56,57,58,59,60,61,62,63,64,65,65/1, 66,6,68,69,69/1,70,74,76,77,78,79,80,81,85,86,87,88 ,94,95,96,97,98,99,100,101,102,103,104,105,106,107 ,108,109,110,111,112,113,114,115,116,118,119,120, 121,122,123,124,125,126,127,128,129,130,131,132, 133,134,135,136,136/1,137,137/1,138,139,140,141, 142,143,144,145,146,147,148,149,150,151,152,153, 154,155,155/1,156,157,158,159,159/1,160,162,163, 164,165,166,167,168,169,170,171,172,173,174,175, 176,177,178,179,180,181,182,183,184,185,186,187, 188,189,190,191,192,193,193/1,193/2,194,195,195 /1,196,197,197/1,197/2,198,199,199/1,199/2,200, 201,205,206,207,208,209,210,211,212,213,214,215, 216,217,218,219,219/1,220,221,221/1,222,222/1,2 22/2,223,223/1,224,225,226,227,228,229,231,232,2 34,235,236,237,238,239,240,241,242,243,244,245,2 46,247,248,249,250,251,252,253,254,255,256,257,2 58,259,260,261,262,263,264,265,266,267,268,269,2 70,271,272,273,274,275,276,277,278,279,280,281,2 82,283,284,285,286,287,288,289,290,291,292,293,2 94,295,296,297,298,299,300,301,302,303,304,309,3 09/2,309/3,309/4,311,315,316,317,319,319/1,319 /2,320,321,327,327/1,328,331,332,333,338,339,340 ,341,342,345,346,347,349,354,362,363,371,374,30,3 83,396,397.

Niveli i klasifikimit, “Sekret”.

- Fondi nr. 511 (Ministria e Arsimit dhe Kulturës), viti 1982.



Dosjet nr. 1,2,3,4,5,6,7,8,9,10,11,12,16,20,37,39, 40,42,43,47,49,51,52,54,65,70,70/1,70/2,71,72,73,7 5,75/1,75/2,78,80,80/1,81,82,82/1,83/1,83/2,83/ 3,84,85,87,88,89,90,92,94,95,97,98,98/1,99,103,111, 112,113,117,118,121,125,138,140,141,141/1,142,14 3,144,145,146,147,148,149,150,151,152,153,154,15 5,156,157,158,159,160,161,162,163,164,165,165/1, 166,167,168,173,174,175,176,177,178,179,180,181,1 82,183,184,185,186,187,188,189,190,191,192,193,1 94,195,196,197,198,199,200,201,202,203,204,205,2 06,207,208,209,210,211,212,213,214,222,223,224,2 25,228,230,234,235,239,240,241,242,244,246,248,2 51,252,253,254,258,259,260,261,262,263,264,265,2 66,267,268,269,270,271,272,273,274,274/1,275,276 ,277,278,279,280,281,282,283,284,285,286,287,289, 290,291,292,293,294,295,296,297,298,299,300,301, 302,303,304,311,317,320,322.

Niveli i klasifikimit, “Sekret”.

- Fondi nr. 511 (Ministria e Arsimit dhe Kulturës), viti 1983.

Dosjet nr. 1,2,3,4,4/1,5,6,7,8,9,10,11,12,13,16, 31,58,59,65,71,72,75,79,83,84,85/1,85/2,85/3,86,8 6/1,88,91,92,101,107,108/1,108/2,108/3,108/4,10 9,109/1,110,122,123,133,133/1,134,135,136,137,13 8,145,146,147,148,149,149/1,150,152,154,155,156, 157,158,159,160,161,162,163,164,165,166,167,168,1 69,170,171,172,173,174,175,176,177,178,179,180,1 81,182,183,184,185,186,187,188,189,190,191,192,1 93,194,195,196,197,198,199,200,201,202,203,204,2 05,206,207,208,209,210,211,212,213,213/1,214,215 ,216,217,218,219,220,221,247,248,249,250,251,252, 253,254,255,256,257,259,260,273,274,275,294,298, 299,300,314,315,316,317,318,319,320,321,322,323, 324,325,326,327,328,329,330,338,344,349,351.

Niveli i klasifikimit, “Sekret”.

- Fondi nr. 511 (Ministria e Arsimit dhe Kulturës), viti 1984.

Dosjet nr. 87,88,89,90,91,92,93,97,98,99,124/ 1125,125/1,126,127,128,129,131,132,133,134,144,1 45, 146,147,148,148/1,149,150,150/1,150/2,150/3,151 ,152,153,154,155,156,157,158,159,160,163,163/1,1 64,165,166,167,168,169,170,171,172,173,174,175,1 76,176/1,177,181,182,183,184,185,186,187,188,189 ,190,191,192,193,194,195,196,197,198,199,200,201, 202,203,204,205,206,207,208,209,210,211,211/1,21 2,221,222,223,223/1,224,225,226,227,235,240,241, 243,244,245,249,250,251,252,259,260,263,279.

Niveli i klasifikimit, “Sekret”.

- Fondi nr. 511 (Ministria e Arsimit dhe

Kulturës), viti 1985.

Dosja nr. 34. Niveli i klasifikimit, “Sekret”

- Fondi nr. 511 (Ministria e Arsimit dhe Kulturës), viti 1986.

Dosjet nr. 14,22,24,26,30,34,36,44,47,56, 94,95,96,96/1,96/2,98,99,100,101,102,103,103/1,1 04,105,105/1,106,128,139,140,141,142,143,144,145 ,146,174,175,177,181,182,184,185.

Niveli i klasifikimit, “Sekret”.

- Fondi 511 (Ministria e Arsimit dhe Kulturës), viti 1987.

Dosjet nr. 1,2,3,4,5,6,7,8,9,10,11,12,13,104,105, 105/1,106,107,108,109,109/1,110,219,220,221,222, 223,224,225,226,227,229.

Niveli i klasifikimit, “Sekret”.

- Fondi nr. 511 (Ministria e Arsimit dhe Kulturës), viti 1988.

Dosjet nr. 1,2,5,7,9,15,23,32,70,78,79,134,136, 137,138,155,156,157,158,159,160,161,162,163,165,1 66,167,168,169,170,171,172,173,174,175,176,177,18 4,185,185/1,186,187,187/1,187/2,188,189,190,191,1 91/1,192,195,200,204,223,224,226,227,228,244,245.

Niveli i klasifikimit, “Sekret”.

- Fondi nr. 511 (Ministria e Arsimit dhe Kulturës), viti 1989.

Dosjet nr. 23,45,48,85,108,108/1,109,110,111, 111/1,112,112/1,113,114,115,116,117,146,147,148, 165, 166,167,168,169,170,171.

Niveli i klasifikimit “Sekret”.

- Fondi nr. 511 (Ministria e Arsimit dhe Kulturës), viti 1990.

Dosjet nr.19,76,76/1,77,77/1,81,81/1,81/2,96, 97,98,104,118,119,120,121,122,131,140,141,142.

Niveli i klasifikimit, “Sekret”.

- Fondi nr. 511 (Ministria e Arsimit dhe Kulturës), viti 1991.

Dosjet nr. 54,60,61,62,63,64,65,92,93.

Niveli i klasifikimit, “Sekret”.

- Fondi nr. 497 (Ministria e Industrisë së Lehtë dhe Ushqimore), viti 1973.

Dosjet nr. 5,6,7,41,55,60,89,170,171,172,173, 174,178,215,219,225,261,265,268,269,277,289,290, 291,293,296,297,298,299,300,301,302,326,330,362, 387,397,398,399,429,430,434,445,446,453,454,457, 458,459,461,462,463,464,466,488,489,506,507,508, 509,510.

Niveli i klasifikimit, “Sekret”.

- Fondi nr. 497 (Ministria e Industrisë së Lehtë dhe Ushqimore), viti 1974.



Dosjet nr. 31,33,54,57,64,68,70,80,86,88,97,98, 124,131,132,133,145,147,148,175,181,182,183,184, 192,200,223,224,227,235,236,237,238,239,240,241, 248,264,273,284,306,317,318,323,327,328,329,330, 333,335,341,342,348,349,354,355,356,363,370,371, 378,379.

Niveli i klasifikimit “Sekret”

Dosjet nr. 29,34,382.

Niveli i klasifikimit, “Tepër sekret”.

- Fondi nr. 497 (Ministria e Industrisë së Lehtë dhe Ushqimore), viti 1975.

Dosjet nr. 29,32,34,35,36,44,45,46,47,50,51,52,55, 66,86,102,106,114,115,128,150,161,163,176,187,191, 196,197,201,208,214,234,252,253,254,255,256,260,2 71,274,275,276,321,322,323,324,325,326,327,328,36 5,370,391,392,393,394,395,396,397,398,399,400,401, 402,403,404,405,406,408,413,416,426,429,436,461,4 68,469,470,474,480,481,482,483,484,485,486,493,49 8,506,552,553,554,554/1,555,556,557,558,559,560,5 61,562,563,564,565,566,567,568,569,570,571,572,57 3,574,574/1,574/2,574/3,574/4,574/5,574/6,574/7 ,574/8,575,576,577,583,596,600,618,619,620,621,63 1,632,633,636,637,638,639,645,646,647,648,649,650, 651,655,663,664,665.

Niveli i klasifikimit, “Sekret”.

Dosjet nr. 25,194,361,666.

Niveli i klasifikimit, “Tepër sekret”.

- Fondi 497 (Ministria e Industrisë së Lehtë dhe Ushqimore), viti 1976.

Dosjet nr. 6,10,15,28,31,33,36,38,48,50,52,53,54, 117,131,143,144,145,146,147,148,149,150,151,152, 153,154,155,167,177,203,209,234,238,241,242,243, 244,245,246,248,250,253,254,258,282,284,296,297, 298,299,300,301,302,303,308,309,323,332,364,380, 381,382,383,384,385,386,387,389,390,391,400,407, 421,422,423,424,433,441,442,443,444,445,446,447, 448,449,451,451/1,453,455,456,457,459,460,461,46 2,463,464,465,466,467,468,469,470,471,472,473,47 4,475,476,477,478,479,480,481,482,483,484,485,48 6,487,488,489,490,492,493,495,497,497/1,504,506, 512,515,517,517/1,521,526,527,528,529,530,537,54 0,557,588,589,590,591,592,593,594,595,596,597,59 8,599,600,601,602,603,604,605,620,633,642,672,67 2/1,672/2,673,673/1,674,675,676,677,678,679,680, 681,682,683,684,685,686,687,688,688/1,689,689/1, 690,690/1,690/2,691,692,693,694,694/1,695,695/1 ,696,697,698,699,701,704,705,706,707,708,709,710, 711,712,713,714,715,716,717,717/1,719,720,721,72 2,723,724,725,725/1,727,728,729,730,731,732,733, 734,735,736,737,738,739,740,741,742,743,744,745,

746,749,750,751,752,753,754,755,756,759,760,764, 768,770,786,811,813,817,821,829,831,832,839,845, 847,854,856.

Niveli i klasifikimit, “Sekret”.

Dosjet nr. 30,51,414.

Niveli i klasifikimit, “Tepër sekret”

- Fondi nr. 497 (Ministria e Industrisë së Lehtë dhe Ushqimore), viti 1977.

Dosjet nr. 64,71,72,73,216,243,346,347,348,349, 350,351,352,353,354,355,356,357,358,359,360,369, 387,388,389,390,391,392,393,394,395,396,397,398, 399,400,401,402,403,444,465,466,467,468,469,470, 471,472,473,474,475,477,478,478/1,478/2,479,480, 481,483,484,485,486,486/1,487,487/1,488,489,490, 491,492,493,494,495,496,497,498,499,500,501,502, 503,504,511,512,513,514,515,516,517,519,520,521, 522,523,524,525,525/1,525/2,526,527,528,530,533, 534,588,589,590,595,607,624,630,631,637,693,703, 704,706,707,710,711,712,713.

Niveli i klasifikimit, “Sekret”.

Dosja nr. 265.

Niveli i klasifikimit, “Tepër sekret”.

- Fondi nr. 497 (Ministria e Industrisë së Lehtë dhe Ushqimore), viti 1978.

Dosjet nr. 18,67,71,73,88,99,106,114,125,129, 133,142,145,173,178,193,195,196,197,199,212,213, 214,216,218,233,273,298,317,318,319,320,321,341, 352,354,354/1,355,356,357,358,359,360,361,362,36 3,364,374,410,426,427,431,443,444,445,446,447,44 8,449,450,451,452,453,454,456,457,458,459,460,46 1,462,463,464,465,479,487,489,516,517,518,519,52 0,521,522,523,524,525,526,527,528,529,530,531,53 2,533,534,535,536,537,538,539,540,541,542,543,54 4,545,546,547,548,549,550,551,552,553,554,555,55 6,557,558,559,560,561,562,563,564,565,567,568,56 9,570,571,572,573,574,575,576,577,578,579,580,58 1,582,583,584,587,588,589,590,591,592,593,594,59 5,596,597,604,605/1,605/2,605/3,605/4,606,607,6 08,609,610,611,612,613,613/1,614,615,616,617,618 ,619,620,643,650,651,655,670,680,681,682,683,684, 709,724,725,726,728,729,730, 732,735,752,753,754,785.

Niveli i klasifikimit, “Sekret”.

- Fondi nr. 495 (Komisioni i Planit të Shtetit), viti 1980.

Dosjet nr. 26,27,28,72,73,82,82/1,82/2.

Niveli i klasifikimit, “Sekret”

- Fondi nr. 495 (Komisioni i Planit të Shtetit), viti 1981



Dosjet nr. 35,36,37,38,39,41,42,43,44,45,46,47, 48,49,50,51,52,53,54,55,56,57,58,59,60,61,62,63,61,6 2,63,64,65,67,68,69,70,71,72,73,74,75,76,77,78,79,80, 81,82,83,84,85,86,87,88,89,90,91,92,93,94,95,96,97,9 8,99,100,101,102,103,104,105,106,117,118,119,120,1 21,122,123,136,137,138,139,140,141,142,143,144,14 5,148,149,150,151,160,172,173,181,182,183,227.

Niveli i klasifikimit, “Sekret”.

- Fondi nr. 495 (Komisioni i Planit të Shtetit), viti 1982.

Dosjet nr. 1,2,3,4,5,6,7,8,9,10,11,12,13,14,15,16, 17,18,19,20,21,25,26,27,28,29,30,31,32,33,34,36,37, 40,43,45,46,50,53,54,56,57,59,63,66,67,68,k72,74,75 ,78,85,86,89,91,92,96.

Niveli i klasifikimit, “Sekret”.

- Fondi nr. 495 (Komisioni i Planit të Shtetit), viti 1983.

Dosjet nr. 1,2,3,15,21,22,23,24,25,26,27,28,29, 34,37,39,40,48,49,51,53,56,57,58,64,76,87,93,94,112 ,113,115,117,126,132,133,147,152,156,171,182,184, 187,188,190,192.

Niveli i klasifikimit, “Sekret”.

Dosja nr. 10.

Niveli i klasifikimit, “Tepër sekret”.

- Fondi nr. 495 (Komisioni i Planit të Shtetit), viti 1984.

Dosjet nr. 1,3,4,11,19,20,21,22,23,24,26,28,30, 32,35,36,37,38,39,40,43,44,45,46,63,64,72,91,94,97,9 9,104,105,108,109,110,112,120,128,131,135,136,137, 138,139,140,141,168,170,181,187,194,198,199,207.

Niveli i klasifikimit, “Sekret”.

- Fondi nr. 495 (Komisioni i Planit të Shtetit), viti 1985

Dosjet nr. 3,5,13,15,16,17,19,21,22,23,24,25,33, 35,39,49,61,66,79,80,85,86,91,95,96,97,98,100,106,1 08, 111,112,114,115,116,161,170,187,195.

Niveli i klasifikimit, “Sekret”.

- Fondi nr. 495 (Komisionin i Planit të Shtetit), viti 1986.

Dosjet nr. 2,4,6,7,8,9,10,10/1,11,12,12/1,13, 14,15,16,17,18,19,20,21,22,23,24,25,26,27,28,29,30, 31,32,33,34,35,36,37,38,39,40,41,42,43,44,45,46,47, 48,49,50,51,52,53,54,55,56,57,58,59,60,61,62,63,64, 65,66,67,68,69,70,71,72,73,74,75,76,77,78,79,80,81, 82,83,84,85,86,87,89,90,90/1,91,92,93,94,95,96,97,9

8,99,101,109,113,123,125,142,148,149,150,151,166, 167,171,172,179,186, 208.

Niveli i klasifikimit, “Sekret”.

- Fondi nr. 495 (Komisioni i Planit të Shtetit), viti 1987.

Dosja nr. 6.

Niveli i klasifikimit, “Sekret”.

- Informacionet deklasifikohen pasi kanë humbur vlerën dhe qëllimin për të cilin janë klasifikuar, si dhe një pjesë e madhe e tyre janë shërbyer dhe publikuar.

2 - Ngarkohet sekretari i KDZH-së për zbatimin e këtij vendimi.

3 - Një kopje e bibliografisë t’i dërgohet DSIK-ut, si dhe për botim në Fletoren Zyrtare.

4 - Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARI

Ardit Bido

KËRKESË

Nr. 3656/1, datë 6.4.2018

PËR SHPRONËSIM PUBLIK

Ministria e Arsimit, Sportit dhe Rinisë shpall kërkesën për shpronësim, për interes publik, të pasurive të paluajtshme, pronë private, që preken nga “Ndërtim i ri i shkollës Tip 2 + Tip 4 në Njësinë Administrative nr. 11, Sheshi 11/1”. Subjekti kërkues i këtij objekti është Bashkia Tiranë. Me anë të këtij publikimi në shtyp kërkojmë të vëmë në dijeni personat të cilët preken nga ky shpronësim. Vënia në dijeni konsiston në masën e vlerësimit të llogaritur nga Komisioni i Posaçëm i Shpronësimit pranë Ministrisë së Arsimit, Sportit dhe Rinisë, për pronarët sipas listës emërore më poshtë. Pronarët që kanë emrat në listën emërore dhe personat e tretë, brenda 15 ditëve nga plotësimi i këtij afati për publikim, kanë të drejtë të paraqesin pretendimet e tyre të shoqëruara me dokumentet përkatëse në Ministrinë kompetente (Ministria e Arsimit, Sportit dhe Rinisë), me adresë: “Rruga e Durrësit”, nr. 23, Tiranë.



LISTA E PASURIVE PRIVATE
ZËRI KADASTRAL AKTIVITET PRIVAT, SHTËPI BANIMI ETJ., QË PREKEN NGA
REALIZIMI I PROJEKTTIT “NDËRTIM I RI I SHKOLLËS TIP 2 + TIP 4 NË NJËSINË
ADMINISTRATIVE NR. 11, SHESHI 11/1”, TIRANË

Nr.	Z K	Nr. i pasurisë	Adr:	Pronari	Sipërf. truall	Sipërf. ndërt.	Çmimi i truallit lekë/m²	Çmimi i ndërtimit lekë/m²	Vlera e truallit lekë	Vlera e ndërtimit lekë	Vlera e truallit dhe ndërtesë	Shënime
1	8320	1/621		Diana Aleksandër Hoxha, Robert Aleksandër Dako, Viktoria Aleksandër Ruli	8.963	0	22,985	0	206,014,556	0	206,014,556	

VENDIM

(i shkurtuar)

Gjykata e Rrethit Gjyqësor Durrës, me vendimin nr. (11-2017-1061) 364, datë 6.3.2018, vendos shpalljen të vdekur të shtetasit Afrim Sinan Buçeza, i datëlindjes 23.8.1991, më datë 23.11.1991.

	Formati 61x86/8
--	-----------------

Shtypshkronja e Qendrës së Botimeve Zyrtare
Tiranë, 2018

Adresa: Rr. "Nikolla Jorga", Tiranë
Tel./fax: +355 4 24 27 004 Tel.: +355 4 24 27 006

Çmimi 392 lekë